AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 30 SHTATOR 2014

TABELAT E RAPORTEVE FINANCIARE

Raportet sipas nenit 20 të ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 20: Raportet, buxheti dhe llogaritë

Neni 20.1.1.2. pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim

31 TETOR 2014

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 30 SHTATOR 2014

TABELAT E RAPORTEVE FINANCIARE

Raportet sipas nenit 20 të ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 20: Raportet, buxheti dhe llogaritë

Neni 20.1.1.2. pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim

TABELA E PËRMBAJTJES

Nr.	Emri i raportit	Faqe
1.	Deklarata për Prezentimin e Pasqyrave Financiare	
2.	Raporti i aktiviteteve të Agjencisë Kosovare të Privatimit	1-63
3.	Pasqyra e gjendjes së llogarive bankare në BQK sipas llojit të fondeve në mirëbesim	1
4.	Pasqyra e gjendjes së llogarive dhe përmbledhja e rrjedhës së parasë së gatshme	2
5.	Pasqyra e Rrjedhës së Parasë së Gatshme për periudhën Korrik 2003 – Shtator 2014	3-8
6.	Pasqyra e Rrjedhës së Parasë së Gatshme për periudhën Janar – Shtator 2014	9-12
7.	Përmbledhje e hyrjeve dhe daljeve nga privatizimi	13
8.	Raporti i shitjeve sipas regjioneve	14
9.	Përmbledhje dhe detajet e hyrjeve dhe daljeve nga likuidimi sipas regjioneve	15-18
10.	Përmbledhje e pagesave për 20%-in e punëtorëve të Ndërmarrjeve Shoqërore	19
11.	Raporti i interesit të fituar në llogaritë bankare dhe numri i llogarive bankare	20

Nr.	Emri i raportit	Faqe
12.	Numri i transaksioneve për vitet e ndryshme fiskale	21
13.	Pasqyra financiare e llogarive të privatizimit	23
14.	Pasqyra financiare e llogarive të likuidimit	25
15.	Pasqyra financiare e llogarive të parave në mirëbesim të NSH-ve	28
16.	Pasqyra financiare e llogarive të komercializimit	30
17.	Pasqyra financiare e llogarive të parave në mirëbesim për 20% e punëtorëve	31
18.	Pasqyra financiare e llogarisë së depozitave (ofertuesit) të privatizimit	32
19.	Pasqyra financiare e llogarisë së tarifave (ofertuesit) të privatizimit	34
20.	Pasqyra financiare e llogarisë së depozitave (ofertuesit) të likuidimit	36
21.	Pasqyra financiare e llogarisë së tarifave (ofertuesit) të likuidimit	38
22.	Pasqyra financiare e llogarisë së ankesave në likuidim	40
23.	Pasqyra financiare e llogarisë së Kapitalit Themeltar të Agjencisë	41
24.	Pasqyra financiare e llogarisë së Fondit Rezervë të Agjencisë	42
25.	Pasqyra financiare e llogarisë së donatorit	44
26.	Pasqyra financiare e llogarisë së tarifës administrative të Agjencisë	45
27.	Pasqyra financiare e llogarive të depozitimeve kohore	46
28.	Raporti i detyrimeve	47-67
1.	Raporti i detyrimeve kontigjente	68
2.	Raporti i llogarive të arkëtueshme	69
3.	Shënimet Shpjeguese të pasqyrave financiare	1-19
4.	Plani i zbatimit të rekomandimeve lidhur me Raportin e Auditimit të ZAP-së për Pasqyrat Financiare të Fondeve në Mirëbesim dhe AKP-së për Janar–Shtator 2014	1-6

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Fatmir PLAKIQI
Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit, Ministria e Financave

DEKLARATË PËR PREZENTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

I nderuari z. Plakiqi,

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë edhe shënimet shpjeguese për këto pasqyra, për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2014 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme" dhe i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMPFP) nr.03/L-48, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe ligjin nr. 04/L-194 dhe janë bazuar në shënimet financiare të mbajtura në menyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezentimin e pasqyrave financiare të Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës për organizatën buxhetore **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)** për vitin që përfundon më 30 Shtator 2014.

Ne konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqjen apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare;
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhur me Buxhetin e Kosovës, (fondi i përgjithshëm Qeveritar, të hyrat e dedikuara dhe donatorët) janë të plota dhe të sakta;
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta;
- Nuk ka llogari bankare që ndërlidhen me Buxhetin e Republikës së Kosovës, përveç llogarive bankare të fondeve në mirëbesim të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si më datën 30 Shtator 2014;
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare në rast se do të shkeleshin;
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare;
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur; dhe
- Të gjitha huatë për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave.
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës raportuese i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara që janë të bashkangjitura paraqesin një prezentim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe të transaksioneve financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2014 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Avni J. JASHARI, MSc, CA, CFE, IS
u.d. Zëvendës Drejtor Menaxhues
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Adem Selishta
u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Datë: 31 Tetor 2014

RAPORT

Janar - Shtator 2014

RAPORT I AKTIVITETEVE TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

PËRMBAJTJA

I. HYRJE 3
II. NDËRMARRJET SHOQËRORE 5
III. TAKIMET E BORDIT TË DREJTORËVE....6
IV. DIVIZIONI I SHITJES....11
IV.1.1 DEPARTAMENTI I SHITJES 11
STATUSI I PAGESAVE 12
NËNSHKRIMI I KONTRATAVE ME BLERËSIT....13
SHITJET QË KANË NDALESA NGA DHOMA E VEÇANTË E GJYKATËS SUPREME 13
IV.2. NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE ME INVESTITOR 13
IV.3. NJËSIA PËR KONTROLLË DHE MBIKQYRJE....16
IV.4. NJËSIA E ADMINISTRIMIT DIREKT 25
V. DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUDIMIT....28
NJËSIA E MONITORIMIT TË LIKUIDIMIT DHE FONDEVE TË MBETURA....28
NJËSIA E LIKUIDIMEVE NGA AKP 29
NJËSIA PËR LISTAT E PUNËTORËVE PËR 20% 30
VI. NJËSIA E RIORGANIZIMIT DHE ADMINISTRIMI I NSH-VE 32
VII. DEPARTAMENTI I KOORDIMINIT RAJONAL....37
VIII. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT....39
IX. DEPARTAMENTI LIGJOR....49
X. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS 53
XI. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT....59
XII. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM....61
XIII. STRUKTRURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT....63

I. HYRJE

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 1 Korrik 2008 e ndryshuar me ligjin nr.04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011 (këtej e tutje "Ligji"). Ky ligj zbaton dispozitat përkatëse të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 Mars 2007 (Shtojca VII, Neni 2 prej saj), që është një pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar si pasardhës e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) të themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 "Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit" me ndryshime nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18 dhe parasheh që të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit për Ndërmarrjet Shoqërore transferohen tek Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit si një organ i pavarur publik kryen funksionet dhe përgjegjësitë e saj me autonomi të plotë. Agjencia posedon individualitet të plotë juridik dhe në veçanti kapacitet për të hyrë në kontrata, të siguroj, të mbaj dhe të rregulloj pronën si dhe të ketë të gjitha kompetencat e përfshira për të shkarkuar plotësisht detyrat dhe kompetencat që i janë dhënë me ligjin aktual, të padit dhe të paditet në emrin e vet.

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve të AKP-së takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas ligjit. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë prej të cilëve pesë (5) anëtarë vendor janë emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe tre (3) anëtarë ndërkombëtarë emërohen nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë në përputhje me Ligjin për Themelimin e Agjencisë.

Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues[1], Zëvendës Drejtori Menaxhues i Divizionit për Shitjet dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues i Divizionit të Likuidimit. Agjencia ka departamentet në vijim:

- Departamenti i Shitjes;
- Departmanenti për Koordinim të Likuidimit;
- Departamenti i Koordinimit Rajonal;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit;
- Departamenti i Administratës; dhe
- Departamentin e Prokurimit.

[1] Mandati i Sh.Ll si Drejtor Menaxhues ka përfunduar më 26 Janar 2014. Funksioni i tij gjatë kësaj periudhe është mbuluar nga dy Zëvendës Drejtorët Menaxhues.

Agjencia e ka të themeluar edhe Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe Sekretarinë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve. Agjencia ka zyrën qendrore në Prishtinë. Ka pesë (5) zyra rajonale (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan) dhe tre (3) zyra satelitore (Graçanicë, Shtërpce dhe Leposaviq).

Struktura organizative e Agjencisë është paraqitur në fund të raportit të aktiviteteve.

II. NDËRMARRJET SHOQËRORE

Rreth 604 kompani në Kosovë janë të identifikuara nga ish- AKM si Ndërmarrje Shoqërore apo njësi punuese (NSH).

Sektori i NSH-ve ka punësuar 20,000 punëtorë, përderisa numri i njerëzve në listat e punëtorëve arrin 60.000 (40.000 janë në pushim pa pagesë). NSH-të kanë funksionuar në sektorë të ndryshme duke përfshirë përpunimin e metalit, plastikës, letrës, hotele, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, material ndërtimor, ndërtimtari, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me shumicë dhe pakicë.

Është vlerësuar që NSH-të zënë rreth 90% të industrisë dhe minierave në Kosovës, 50% të hapësirës për shitje komerciale me pakicë dhe më pak se 20% të tokës bujqësore duke përfshirë tërë tokën komerciale bujqësore dhe shumicën e pjesës malore të Kosovës.

Shumica e pronës industriale të Kosovës, tokës bujqësore, pyjet, tokës urbane komerciale dhe pronës komerciale janë pronë e NSH-së. Privatizimi i këtyre aseteve dhe tërheqjen e investitorëve të huaj dhe atyre nga Diaspora dhe rajoni, Kosova pritet që të kenë ndikim pozitiv në ekonominë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Nga 604 janë **86 NSh jashtë mandatit të Agjencisë duke llogaritur edhe Trepçën**, të cilat janë si më poshtë:

1.	Trepça	19
2.	Ekonomija e Pyjeve	24
3.	Kosovatrans dhe Zyrat koordinuese të Kosovatrans	13
3a	Hequr me ligj nga kometencat e AKP-së	30

Pra numri i NSh-ve nën mandatin e Agjencisë është gjithsej 518 prej të cilave në procesin e likuidimit kanë hyrë gjithsej 461.

Janë edhe 57 NSh që ende nuk janë vendosur në likuidim duke përshirë edhe Ndërmarrjen e Re Grand Hotel (deri në emërimin e Bordit të ri).

AKP-ja vazhdon me privatizimin e NSh-ve nëpërmjet dy metodave:

1. **“Spin-Of” -** Asetet dhe numri i kufizuar i përgjegjësive të NSH-së barten tek shoqëritë e porsaformuara aksionare (“Ndër.e Re”) me aksionet e ndërmarrjeve të reja të tenderuara për shitje investitorëve privat. Detyrimet e mbetura dhe punëtorët mbesin me NSH; dhe
2. **Likuidimi Vullnetar -** Asetet e NSH-ve do të likuidohen sipas ligjit dhe politikave operacionale të Agjencisë.

III. TAKIMET E BORDIT TË DREJTORËVE

Në vitin 2008 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjashtë (6) takime.

Në vitin 2009 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) takime.

Në vitin 2010 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur dymbëdhjetë (12) takime.

Në vitin 2011 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) takime.

Në vitin 2012 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur tetë (8) takime.

Në vitin 2013 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) takime.

Në vitin 2014 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur nëntë (9) takime.

Në muajin Mars 2014 AKP-ja ka dorëzuar në Kuvendin e Kosovës Raportin Vjetor për vitin 2013 të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve dhe e ka vendosur në faqen e saj elektronike.

Takimi i gjashtëdhjetë e një (61) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 31 Janar 2014. Gjatë kësaj mbledhje Bordi ka miratuar Planin e Prokurimit për vitin 2014 për ndërmarrjen Trepça dhe poashtu ma emëruar Menaxher të ndërmarrjes Trepca z. Ahmet Tmava. Në këtë takim janë aprovuar: a) transakcionet e Shitjes së Aseteve përmes Likuidimit (SHAL) 23, b) depozitat për SHAL 24 dhe c) shpallja e Valës 60 të privatizimit. Bordi ka vendosur që disa asete që janë nën administrim të Agjencisë të lëshohen me qira dhe poashtu të ndryshohet buxheti i ndërmarrjes EUP Engenering që është në procedurë të likuidimit. Bordi gjithashtu morri vendim për shpërndarjen e parakohshme të 20% për punëtorët me të drejtë legjitime të N.SH.-së, si në vijim: NSH "Emin Duraku'' – Gjakovë/Pejë. Bordi nuk ka pas konsensus që të zgjedh Drejtorin Menaxhues në këtë mbledhje.

Takimi i gjashtëdhjetë e dytë (62) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 27 Shkurt 2014. Gjatë këtij takimi Bordi ka aprovuar për qiradhënie disa asete të ndërmarrjes Trepca. Në këtë takim janë azhurnuar dy akte nënligjore të Agjencisë, si në vijim: a) Rregullat e Tenderit në Likudim, dhe b) Procedurat Bankare të Agjencisë. Ndërmarrja shoqërore Genci në Prishtinë është futur në Administrim direkt të Agjencisë, ndërsa ndërmarrja e re Rilindja Zona Industriale është liruar nga kushtet ë Marëveshjes së Zotimeve. Poashtu si pjesë e këtij takimi ishin Raportet e Komisioneve, si në vijim: a) Raporti i Komisionit për SDR (3 lëndë), dhe b) raporti i Komisionit për shitjen e banesave të NSH-ve (28 lëndë). Bordi poashtu ka miratuar propozimet për ndryshim të buxhetit për 3 ndërmarrje që janë në likuidim.

Në periudhën ndërmjet mbledhjes së 27 Shkurtit 2014 dhe mbledhjes së 26 Marsit 2014 nëpërmes formës së votimit me shkrim Bordi me datë 11 Mars 2014 ka vendos që të miratoj propozimin për shpërndarjen e parakohshme e fondeve të 20% në pajtim me Strategjinë e re të 29 Gushtit 2013 për shpërndarjen e fondeve të 20% - në këtë rast për 195 ndërmarrje.

Takimi i gjashtëdhjetë e tretë (63) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 26 Mars 2014. Gjatë këtij takimi Bordi ka vendos që të vazhdoj mandatin e Komisioneve në vjim: a) Komisionit për Pranimin e Ofertave dhe Komisionit për Hapjen e Ofertave, dhe b) Vazhdimi i mandatit të Komisionit për Shitjen e Banesave në Pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore. Në këtë takim poashtu është aprovuar Raporti Vjetor i AKP-së për vitin 2013 i cili pastaj është dërguar në Kuvend të Kosovës me datë 31 Mars 2014. Në këtë takim janë aprovuar transakcionet e Shitjes së Aseteve përmes Likuidimit (SHAL) 24. Në këtë takim është vendosur që 11 asete të miratohen për qiradhënie dhe 45 NSH të fillojnë procedurën e likuidimit. Bordi poashtu ka aprovuar Memorandumin e Mirëkuptimit me Policinë e Kosovës me qëllim të sigurimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në procesin e verifikimit të të dhënave përkatëse, nga policia, për ofertuesit fitues në shitjet e organizuara nga AKP-ja të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe aseteve të tyre. Bordi gjithashtu morri vendim për shpërndarjen e parakohshme të 20% për punëtorët me të drejtë legjitime të N.SH.-së, si në vijim: NSH "Lavërtari-Blegtori", Arbanë (Dushanovë) – Prizren. Në këtë takim gjithashtu është vendosur që për një asset të NSH Aromatiku të hjekët dorë pas shqyrtimit të rrethanave të prezentuara, kurse për një asset tjetër, atë të NSH Zdrukthtaria është vendosur që të shkohet me n egociata direkte

Takimi i gjashtëdhjetë e katërtë (64) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 26 Prill 2014. Sa i përket ndërmarrjes Trepca, Bordi në këtë takim vendosi që të aprovoj shitjen e koncentratit të prodhurar gjatë vitit 2014 dhe poashtu vendosi që të aprovoj propozimin për risistematizim dhe organizim në Njësitë e Trepcës. Sa i përket privatizimit, Bordi ka vendosur që të aprovoj listën e azhurnuar për shpalljen e Valës 60 të privatizimit, ndërsa ka aprovuar edhe listën e aseteve për t'u shpallur si SHAL 26. Gjatë këtij takimi është themeluar Bordi i përkohshëm menxhues për NSH Genci, ndërsa personi juridik Instituti për Hidroekonomi është liruar nga kompetencat e AKP-së. Sa i përket Komisioneve: a) Komisionit Vlerësues për Regjistrimin e Ofertuesve të Kualifikuar i është vazhduar mandati për një (1) vit, b) është aprovuar Raporti i Komisionit për SDR (3 lëndë); dhe c) është aprovuar Raporti i Komisionit për shitjen e banesave të NSH-ve (50 lëndë). Bordi poashtu ka vendosur që 27 asete të shpallen për qiradhënie fillestare. Sa i përket listave të punëtorëve është miratuar shpërndarja e parakohshme të fondeve të 20% në pajtim me vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 29.08.2013 për listën e punëtorëve të NSH Fabrika e Baterive Industriale FBI "Trepça" në Peje.

Takimi i gjashtëdhjetë e pestë (65) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 07 Maj 2014. Pas situatës së krijuar (hetimeve), më datë 30 Prill 2014 të disa zyrtarëve dhe ish-zërtarëve lidhur me rastin me Spin Off Special Fabrika e Armatures Fan Podujevë, Bordi ka mbajtur mbledhje urgjente dhe ka vendosur që: i) Zëvendës Drejtor Menaxhues, Divizioni i Likuidimit të largohet përkohësisht nga puna në afat deri në 6 muaj me pagesë 50% duke filluar nga data 30 prill 2014; dhe ii) Z. Avni J. Jashari, Drejtor i Financave dhe Buxhetit emërohet ushtrues detyre i Zëvendës Drejtorit Menaxhues, Divizioni i Likuidimit,

në periudhë prej 6 muajsh nga data e marrjes së këtij vendimi. Poashtu pas propozimit Bordi në këtë takim vendosi që të amandamentoj vendimin e Bordit te Drejtorëve të datës 26 Mars 2014 për inicimin e likuidimit për 45 ndërmarrje, rrjedhimisht vetëm shtyerja e afatit për fillim të likudimit të 3 grupeve të ndërmarrjeve të lartëpërmendura.

Takimi i gjashtëdhjetë e gjashtë (66) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 30 Maj 2014. Sa i përket gjendjes së Menaxhmentit, gjatë këtij vendosi që të themeloj Komisionin për vlerësimin e performacës së Menaxhmentit dhe poashtu të anuloj konkursin e pezulluar për Drejtor Menaxhues të Agjencisë. Sa i përket privatizimit, Bordi ka vendosur që të aprovoj transakcionet e SHAL 25. Sa i përket Komisioneve është aprovuar Raporti i Komisionit për SDR (5 lëndë). Sa i përket listave të punëtorëve është miratuar shpërndarja e parakohshme të fondeve të 20% në pajtim me vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 29.08.2013 për listat e punëtorëve të: a) NSH "Vreshtaria", Landovice/ZR Prizren; dhe b) NSH "Zadruga", Shterrpce/ZR Gjilan.

Në periudhën ndërmjet mbledhjes së 30 Maj 2014 dhe mbledhjes së 27 Qershor 2014 nëpërmes formës së votimit me shkrim Bordi me datë 16 Qershor 2014 ka vendos që të miratoj propozimin për shkarkim të dy anëtarve të Komisionit për ndërtime llegale dhe emërimin e dy anëtarve të rinj.

Takimi i gjashtëdhjetë e shtatë (67) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 27 Qershor 2014. Gjatë këtij Bordi pas vlerësimit të punës vendosi që të vazhdoj mandatin e Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv edhe për një mandat. Sa i përket Trepcës, Bordi vendosi që: a) të autorizoj Menaxhmentin e AKP-së për parashtrim të kërkesës në DhPGjSK për shtyrjen e afatit për dorëzimin e Planit të Riorganizimit të Ndërmarrjes Trepça; dhe b) të miratoj kërkesën e Menaxhmentit të Trepcës për lejim të mjeteve financiare për riaktivizim të prodhimit në fabrikën e Zink Oksidit . Pas një incidenti që ndodhi në ditën e shitjes/hapjes së ofertave për Valën 60 dhe SHAL 26 dhe pas propozimit nga Menaxhmenti, Bordi ri-aprovoi/konfirmoi vendimin e Menaxhmentit për të anululuar ditën e hapjes së ofertave për SHAL 26 dhe Valën 60. Sa i përket likuidimit Bordi në këtë takim vendosi që të aprovoj propozimin për fillimin e likuidimit të 11 NSH-ve. Gjatë këtij takimi Bordi aprovoi aktet nënligjore si në vijim: a) Rregulloren e Pagave për nëpunësit e Agjencisë, b) Rregulloren e Personelit për nëpunësit e Agjencisë (azhurnim), c) Rregulloren për Përdorimin e Veturave zyrtare të Agjencisë. Sa i përket Komisioneve: a) është aprovuar Raporti i Komisionit për SDR (8 lëndë), b) (raporti i datës 16.06.2014 i Komisionit për Banesa të NSH-ve (50 lëndë), dhe c) Raporti i KSHALP-së për NSH "Prizren-Trans" në Prizren. Si pasojë e mospërmbushjes së obligimeve, Bordi vendosi që të aprovoj propozimin për ndëshkime për blerësin e asetit Llamkos, pra për Coresteel në Kosovë dhe atë në Dubai.

Në periudhën ndërmjet mbledhjes së 27 Qershorit 2014 dhe mbledhjes së 23 Korrikut 2014 nëpërmes formës së votimit me shkrim Bordi me datë 18 Korrik 2014 ka vendos që të miratoj propozimin për anulim i Vales 60 të privatizimit, pasi që si pasojë e fillimit të likuidimit të shumë ndërmarrje, për valën 60 kishte mbetur vetëm një Ndër e Re dhe se nuk shihej e përshtatshme që të vazhdohet me një Valë privatizimi me vetëm një Ndër të re.

Takimi i gjashtëdhjetë e tetë (68) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 23 Korrik 2014. Ndër vendimet më të rëndësishme që u morr në këtë takim ishtë aprovimi i Buxhetit të Agjencisë për vitin

2015. Sa i përket privatizimit, Bordi vendosi që të aprovoj shpalljen e listës për SHAL 27. Sa i përket kërkesave të ndryshme, Bordi vendosi që të aprovoj kërkesën e blerësit të Jugotermit për zgjatje të afatit për investime dhe poashtu vendosi që të aprovoj kërkesën e Menaxhmentit të Grandit për rritje pagash për punonjësit e hotelit. Sa i përket Komisioneve: a) është aprovuar Raporti i Komisionit për SDR (2 lëndë), b) Raporti i Komisionit për Banesa të NSH-ve (60 lëndë) dhe ndryshimi i përbërjes së Komisionit, dhe c) Raporti i KSHALP-së për NSH – Kosovarja – Artizanati Prishtinë. Gjatë këtij takimi Bordi aprovoi propozimin për azhurnim të të Rregullores për kompenzim të anëtarve të Bordit.

Në periudhën ndërmjet mbledhjes së 22 Korrikut 2014 dhe mbledhjes së 26/31 Gushtit 2014 nëpërmes formës së votimit me shkrim Bordi me datë 21 Gusht 2014 ka vendos që të miratoj propozimet në vijim: a) Propozimi per largimin e Hotel Grand nga Administrimi Direkt i AKP-së, b) Propozimi per largimin e NSH Fapol nga Administrimi Direkt i AKP-se, c) Raporti i Komisionit për shitjen e banesave të NSH-ve i dates 08 Gusht 2014 (xx lëndë), d) Lista e punetoreve dhe shperndarja e parakoshme per NSH Barnatoret e Prishtines, dhe e) Trepca Zvecan - Keërkesë per miratim të aneks kontratës të shitjes së koncentratit të Zinkut.

Takimi gjashtëdhjetë e nëntë (69) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur dy ditë, me 26 dhe 31 Gusht 14. Gjatë këtij takimi Bordi ka vendos që të mbaj të pezulluar nga puna z. N. A dhe z. Avni J. Jashari të vazhdoj të mbaj pozitën e UD ZDM Likuidim deri në vendimin e radhës nga Bordi. Poashtu duke pas parasysh që Bordi pas datës 31 Gusht 2014 do të mbetej pa kuorum për mbledhje, Bordi vendosi që të marr vendim se si do të vazhdoj funksionimi i Agjencisë pas datës 31 Gusht 2014 - Mbikqyrja ndaj Menaxhmentit, koordinimi dhe raportimi në periudhën kur Bordi i Drejtorëve nuk është funksional. Sa I përket Trepcës, Bordi vendosi që pas periudhës provuese 6 muajshe të vazhdoj emërimin e Menaxherit të Trepcës dhe poashtu vendosi që të ri- shpallet një tender i ri për procedurën e angazhmit të një Ofruesi të Shërbimeve Profesionale. Sa i përket privatizimit, u vendos që të aprovohen transakcionet e SHAL 26 dhe është aprovuar për shpallje Lista e aseteve për SHAL 28. Sa i përket punës së Komisioneve, Bordi vendosi si në vijim: a) është aprovuar Raporti i Komisionit për SDR (3 lëndë), b) është aprovuar Plani i punës dhe janë azhurnuar Rregullat e Punës të Komisionit për ndërtimeve jo ligjore në pronat e NSH-ve, c) Themelohet Komisioni për shqyrtimin e listave fillestare) dhe aprovohen Rregullat e Procedurës të Komisionit, d) është aprovuar Raporti i Komisionit për shitjen e banesave të NSH-ve i dates 22Gusht 2014 (27 lëndë), dhe e) u vendos për shpërndarjen e parakohshme të 20% për punëtorët me të drejtë legjitime të N.SH.-së, si në vijim: NSH KB Zhegra ne Zhegër – Gjilan. Në këtë takim Bordi vendosi që të aprovoj Rregulloren e AKP-së për qiradhënie dhe poahstu morri vendim për qiradhënien e disa tokave bujqësore. Sa i përket likuidimit Bordi në këtë takim vendosi që të aprovoj propozimin për fillimin e likuidimit të XX NSH-ve, ndërsa sa i përket menaxhimit të kontratës me AL-në janë bërë disa ndryshime në emërimet e përgjegjëesve për implementimin e kësaj kontrate. Gjatë këtij takimi poashtu është marr vendim për rritjen e buxhetit ekzistues për NSH-të në likuidim në përgjithësi. Poashtu janë marr edhe disa vendime tjera sa i përket likuidimit, sin ë vijim: a) për rritjen e buxhetit fillestar për dy ndërmarrje në likuidim, b) një ricaktim i datës së fillimit të likuidimit, c) është miratuar ndarja e fondeve të shitjes së Hotel Palas ndërmjet Trepca Hotel dhe Lux, d) NSH Zdrukthëtaria është aprovuar rezultati i negociatave të drejtpërdrejta, e) janë ndryshuar disa të dhëna për fillimin e likuidimit të NSH Tregu. Sa i përket ndërmarrjeve me Spin Off Special janë marr këto vendime: a) MIM Golesh – është miratuar ekzekutimi i vendimit te datës 16 dhjetor 2011 për tërheqje të aksioneve dhe ndërmarrja futet në administrim direkt te AKP-së, dhe b) Agrokosova Holding - është

vazhduar afati për investime deri me 31.12.2014 dhe është vendosur që pastaj të bëhet auditim i gjithë periudhës që nga fillimi i kontratës deri me 31.12.2014. Gjatë këtij takimi Bordi aprovoi Memorandumin e Mirëkuptimit në mes të AKP-së dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës për aprovim në Bordin e Drejtorëve të AKP-së dhe poashtu morri vendim që të aprovoj transferit e parcelave të KBI Kosova Export NSH Bujqësia në emër të Kompanisë Ujësjellësi Rajonal Prishtina për ndërtimin e Fabrikës se Ujit në Shkabaj.

Informatë

- Që nga 01 Shtatori 2014 Bordi i Drejtorëve tani për tani nuk ka kuorum për të mbajtur mbledhje.

- Anëtarëve ndërkombëtar të Bordit z. Hubert VVarsmann dhe z. Mohammed Omran iu ka skaduar mandati me 31 Gusht 2014 në mesnatë.

- Anëtarët vendor të Bordit Zëvendës Kryesuesi z. Skender Komoni dhe anëtarët znj. Maja Milanovic dhe z. Haxhi Arifi kanë mandat deri me 21 Shkurt 2015.

IV. DIVIZIONI I SHITJES

Aktivitetet e Divizionit të Shitjes shtrihen në fushën e organizimit siç janë:

1. valëve të privatizimit, shitjen e aseteve me likuidim;
2. realizimin e administrimit direkt, vendosja nën kontrollë dhe mbikqyrje të ndërmarrjeve të komercializuara apo me kushte; dhe
3. organizimi i publikimeve, marketingut dhe vendosja e marrëdhënieve të mira me investitorë.

Rrjedhimisht Departamenti i Shitjes, Njësia e Administrimit Direkt, Njësia për Kontrollë dhe Mbikqyrje dhe Njësia për Marrëdhënie me Investitorë i raportojnë drejtpërdrejt Zëvendës Drejtoreshës Menaxhuese të AKP-së e cila është përgjegjëse për menaxhimin e ndërmarrjeve nën autoritetin administrativ të Agjencisë.

IV.1. DEPARTAMENTI I SHITJES

Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) do të ketë ndikim të madh pozitiv në komunat e Kosovës nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë duke mundësuar rritjen dhe zhvillimin e sektorit privat. E rëndësishme është që ky proces të kryhet sa më shpejtë në mënyrë të drejtë dhe transparente dhe në përputhje me ligjin.

Departamenti i Shitjes përbëhet nga:

1. Njësia për Përgatitjen dhe Përmbylljen e Shitjes;
2. Njësia e Shqyrtimit të Dokumenteve të Shitjes; dhe
3. Njësia e Kadastrit.

Qëllimi i Agjencisë është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore. Departamenti i Shitjes është përgjegjës për procesin e privatizimit dhe atë sipas menyra të cekura më poshtë:

“Spin-Of” - Asetet dhe një numër i kufizuar i detyrimeve të NSH-së barten tek shoqëritë e porsaformuara aksionare (Ndërmarrja e Re) me aksionet e Ndërmarrjes së Re dhe më pas tenderohen për shitje investitorëve privat. Detyrimet ndaj kreditorëve potencial mbesin obligime të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe këto çështje zgjidhen përmes procesit të likuidimit. Pasiqë shumica e Ndërmarrjeve Shoqërore tashmë kanë hyrë në procesin e likuidimit, nuk pritet që të ketë shitje me Spin Of të rregullt.

“Likuidimi Vullnetar” do të mundësoj:

a) shitjen e aseteve që nuk janë shitur nëpërmjet privatizimit; dhe
b) shqyrtimin e ankesave të kreditorëve dhe shpërndarjen e fondeve të realizuara në përputhje me prioritetet e parapara me ligj.

Asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore do të likuidohen nëpërmjet procesit transparent të likuidimit.

Gjatë periudhës raportuese janë publikuar Shitjet e Aseteve nëpërmjet Likuidimit 24, 25 dhe 26

Shitjet nëpërmjet likuidimit gjatë periudhës Janar – Shtator 2014 janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Shitja përmes Likuidimit	Data e Shitjes	Nr i Aseteve	Nr. i Ofertave të Pranuara	Gjithsej Vlera e Ofertave EUR	Tërheqjet, Anulimet EUR	Gjithsej Vlera EUR	Nr. i Aseteve të anuluara nga BiD, tërheqjet	Shitjet e realizuara	Shitjet e pareализuara – në proces
24	19 Mars 2014	50	130	9,870,871	8,465,030	1,405,841	29	20	1*
25	23 Prill 2014	62	100	4,707,403	1,793,695	2,913,708	41	21	-
26	20 Gusht 2014	54	95	8,212,876	5,234,810	2,978,066	33	21	-
Total	**3 shitje**	**166**	**325**	**22,791,150**	**15,493,535**	**7,297,615**	**103**	**62**	**1***

STATUSI I PAGESAVE

Shitja e Aseteve 24:

- Ka përfunduar verifikimi i historikut për të gjithë blerësit.
- Kanë përfunduar të gjitha pagesat.
- Kanë përfunduar të gjitha kontratat me përjashtim të Njësisë 25: Tokë dhe Objekt në Qendër (parcela 1451-1) Mitrovicë, për shkak të problemeve kadastrale*.

Shitja e Aseteve 25:

- Ka përfunduar verifikimi i historikut për të gjithë blerësit.
- Kanë përfunduar të gjitha pagesat.
- Kanë përfunduar të gjitha kontratat.

Shitja e Aseteve 26:

- Ka përfunduar verifikimi i historikut për të gjithë blerësit.

- Kanë përfunduar të gjitha pagesat e pjesës 25 % të çmimit të shitjes
- Pagesa e pjesës 75 % të çmimit të shitjes është deri më 28 tetor 2014.

NËNSHKRIMI I KONTRATAVE ME BLERËSIT

- Gjatë periudhës Janar – Shtator 2014 janë nënshkruar dhe dorëzuar tek blerësit gjithsej 126 Kontrata (Likuidim 102, Spin-Off 24). Disa nga këto kontrata janë nga shitjet që janë kryer në fund të vitit 2013.

SHITJET QË KANË NDALESA NGA DHOMA E VEÇANTË E GJYKATËS SUPREME

Për gjashtë (6) shitje kemi ndalesa nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme dhe derisa nuk hiqen këto ndalesa nuk mund të vazhdohet me shitjen. Ndalesat vlejnë për ndërmarrjet/asetet në vijim:

1. Ndërmarrja e Re "AGROKOSOVA – Zyret Sh.P.K." – Vala 37;
2. Ndërmarrja e Re "KB Shtime Zyra Administrative Sh.P.K." – Vala 42; dhe
3. Ndërmarrja se Re "Punëtoria Iliria Sh.P.K." – Vala 43.
4. Shitja e Aseteve 20, Njësia 12: "Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme I"
5. Ndërmarrja se Re "Jugobanka Zyra në Skenderaj" – Vala 58
6. Ndërmarrja se Re " Ereniku Industria Depo në Zonën Industriale Prishtinë" – Vala 59

IV.2. NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE ME INVESTITOR

Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor ka vazhduar të siguroj përkrahje të plotë për të gjitha shitjet e realizuara nga AKP-ja si dhe promovimin dhe ruajtjen e raporteve të mira me investitorët. Në aspektin e realizimit të shpalljes së shitjeve janë zhvilluar dhe zbatuar plane multi-mediale marketingu, përfshirë përdorimin e mjeteve të duhura mediale, në përputhje me strategjinë për marketing masiv. Janë ndërmarrë aktivitete operacionale që përfshinë lansimin e shitjeve, realizimin e materialeve të duhura promovuese si dhe janë ofruar shërbime këshilluese për të gjithë investitorët e interesuar të marrin pjesë në procesin e Privatizimit të tilla si informimin e tyre, parakualifikimin, koordinimin e hulumtimit paraprak etj.

Me qëllim të ngritjes së vizibilitetit dhe shpërndarjes së informatës tek publiku i gjerë apo palët e interesit si dhe promovimin e procesit të privatizimit tek investitorët potencial lokal dhe ndërkombëtar, Njësia e Marketingut ka përfaqësuar AKP-në në ngjarje dhe aktivitete relevante si dhe ka hulumtuar dhe identifikuar mundësitë e reja alternative për promovimin e punës së Agjencisë.

Aktivitete marketingu dhe aktivitete promovuese

Iniciativat e Reja të Marketingut

- Hulumtim mbi ofertat e bëra nga disa radio nacionale dhe radiot lokale në mënyrë që të shfrytëzohet edhe ky medium për reklamim, për herë të parë është shfrytëzuar mediumi i radios për reklamim të shitjeve të aseteve. Radio reklamat janë transmetuar në 3 radio stacionet nacionale dhe në 5 radio stacione lokale, në rajonet ku ka pasur më shumë prona të përfshira në shitje. Radio reklama e njëjtë është transmetuar në gjuhën serbe, përmes një radiostacioni në veri të Mitrovicës.
- Është nënshkruar marrëveshja për partneritet medial me E.E.L. Events Limited, me rastin e organizimit të Forumit "Invest in Kosovo 2014", që është mbajtur në Prishtinë, me 28-29 Maj 2014. Qëllimi i kësaj ngjarje ka qenë ngritja e vetëdijes për mundësitë e investimeve në Kosovë. Marrëveshja nuk ka përfshirë shpenzim monetar, por është bazuar në përfitim të dyanshëm përmes aktiviteteve të marketingut.
- Me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve të ofruara për investitorët potencial, është ndërmarrë një hulumtim rreth vlerësimit të cilësisë së shërbimeve në AKP, me ç'rast pyetësori iu është shpërndarë ofertuesve me rastin e dorëzimit të ofertave.
- Bazuar në kërkesën për mbështetje që është bërë tek Autoriteti i Likuidimit nga organizatorët e Dokufestit dhe Ngomfestit për shfrytëzimin e asetit të NSH Kino Lumbardhi, si kontribut në mall (in-kind contribution), është arritur marrëveshja që llogoja e AKP-së do të paraqitet në materialet promovuese të festivaleve, që konsiderohet si mënyrë e mirë e rritjes së vizibilitetit dhe ngritjes së imazhit të AKP-së.

Aktivitete tjera marketingu

Në mbështetje të strategjisë për promovimin dhe tërheqjen e investitorëve njësia e Marketingut ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme marketingu:

- Realizimi i materialeve të shtypura promovuese - përfshirë konceptimin, dizajnin dhe mbikëqyrjen e shtypit, si dhe ka bërë koordinimin dhe mbikëqyrjen e punës së operatorit ekonomik në lidhje me materiale të realizuara jashtë Agjencisë. Disa nga materialet e realizuara përfshinë:
    - Dizajni i kopertinës dhe mbikëqyrja e realizimit të raportit vjetor të Agjencisë
    - Dizajni i të gjitha shpalljeve për gazetat lokale
    - Dizajni dhe realizimi i broshurës së përgjithshme të privatizimit
    - Dizajnimi i posterëve atraktiv me porosi pozitive rreth procesit të privatizimit
- Gjatë periudhës Janar-Shtator 2014 përfaqësues të Njësisë kanë marrë pjesë në ngjarje të ndryshme, me qëllim të promovimit të procesit të privatizimit në përgjithësi, si dhe projekteve specifike në veçanti, përfshirë:

- Panairin Ndërkombëtar "Prishtina 2014", i mbajtur me 30 prill-03 maj 2014, organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës
- Panairin Expokos 2014, në Prishtinë
- Forumin "Kosova 2014", që është mbajtur në Prishtinë, me 27 Maj 2014

- Dizajni dhe editimi i tetë (8) shpalljeve/njoftimeve për gazeta lokale dhe uebfaqe; dhe
- Konceptimi, dizajnimi dhe realizimi i katër (4) TV reklamave

Shpallja e Shitjeve të Aseteve 24, 25 dhe 26

Në kuadër të aktiviteteve mbështetëse për shpalljen e shitjeve janë ndërmarrë veprimet si në vijim:

- Përmbledhja e materialeve relevante, koordinimi me zyret rajonale dhe Njësinë për Përgatitjen e Tenderëve në lidhje me përgatitjen e shpalljeve për Shitje të Aseteve
- Publikimi i shpalljeve të Shitjeve është bërë në të gjitha gazetat lokale, uebfaqen e AKP-së dhe përmes transmetimit të TV Reklamës në tri Televizionet Kombëtare RTK, RTV 21, KTV. Njoftime të shkurtëra gjithashtu janë publikuar rreth afateve për para-kualifikim dhe datave për dorëzimin dhe hapjen e tenderëve.
- Investitorët e parakualifikuar janë njoftuar mbi shpalljen e Valëve dhe Shitjeve të Aseteve edhe përmes postës elektronike dhe SMS shërbimit.
- Informatat rreth shpalljes së Shitjeve janë bërë edhe në mediet elektronike, me ç'rast janë përzgjedhur pesë (5) portalet më të vizituara.
- Për herë të parë këtë vit është zbatuar publikimi i shpalljeve përmes radio reklamave, me c'rast përzgjedhur 3 radio stacionet nacionale dhe 5 radio stacione lokale, në rajonet ku ka pasur më shumë prona të përfshira në shitje.

Marrëdhënie me Investitor

Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor vazhdon të mbetet pika primare e komunikimit me investitorët potencial lokal dhe ndërkombëtar, duke u përgjigjur kërkesave dhe ofruar udhëzime dhe këshillime rreth procesit të privatizimit dhe pjesëmarrjes në tenderët e shpallur, përfshirë parakualifikimin, koordinimin e hulumtimit paraprak dhe sigurimin e materialeve tenderuese (Rregullat e Tenderit, Memorandume Informimi etj.) . Gjatë periudhës Janar-Shtator 2014 janë realizuar takime të vazhdueshme me të gjithë investitorët e interesuar, që kanë rezultuar me:

- 279 investitorë të rinj të parakualifikuar gjatë kësaj periudhe
- Mbi 1,160 marrëveshje për ruajtjen e sekretit afarist të nënshkruara me palët e interesuara për pronat dhe asetet e tenderuara gjatë kësaj periudhe

Ueb Faqja

Uebfaqja e AKP-së popullohet në mënyrë të vazhdueshme me të gjitha informatat ne lidhje me procesin e privatizimit në Kosovë. Kjo përfshinë lansimin e Shitjes së Aseteve, listat preliminare dhe finale të punëtoreve për shpërndarjen e 20%, raporteve përfundimtare te likuidimit, komunikatave për media, raporteve dhe rregulloreve, rezultateve dhe vendimeve për shitjet e aseteve, si dhe informatave të tjera të rëndësishme. Në bazë të dhënave historike, numri i vizitave të uebfaqes ka një ngritje të vazhdueshme, ku për periudhën Janar-Shtator 2014 janë regjistruar 230,071 vizita (nga 311,584 vizita sa kanë qenë gjatë tërë vitit 2013).

IV.3. NJËSIA PËR KONTROLLË DHE MBIKQYRJE

Ky Raport përfshin aktivitetet e Njësisë për Kontroll dhe Mbikëqyrje – Divizioni i Shitjes për periudhën Janar - Shtator 2014.

Detyrat kryesore të Njësisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes është mbledhja dhe sistematizimi i raporteve financiare nga Ndërmarrjet Shoqërore (NSH) që administrohen nga AKP si dhe sistematizimin, grumbullimin dhe krahasimin e raporteve financiare në mënyrë që të ruhet dhe rritet vlera e NSh-ve dhe për të ndërmarrë masa në kohën e duhur në rastet kur prona mundë të keq menaxhohet. Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes përgatitë dhe ekzekuton transferimin e detyrimeve nga NSh-të tek blerësit e këtyre ndërmarrjeve në pajtim me Politikat Operacionale të AKP-së.

Gjithashtu Njësia për kontroll dhe mbikëqyrje ka për detyrë që të monitorojë përmbushjen e zotimeve për investime kapitale, zotimit për punësim dhe vazhdim të aktivitetit të biznesit, sipas Marrëveshjes për Zotime për ndërmarrjet e privatizuari përmes metodës së Spin Off-it Special dhe Spin Off-et me kushte.

Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje bazuar në planin e biznesit për 2014 ka përcaktuar prioritetet e veta që kanë qenë si në vijim:

- Mbledhjen dhe analizimin e raporteve financiare të NSh-ve të kryera nga zyrtarët tanë për kontroll dhe mbikëqyrje në rajon dhe koordinimin e aktiviteteve me zyrtarët për objektivat e përbashkëta, vizitat në zyrat rajonale dhe NSh-të me qëllim të verifikimit të informatave lidhur me pronën e këtyre ndërmarrjeve, ruajtjen dhe rritjen e vlerës së pronës, si dhe identifikimin e rasteve ku keq menaxhimi i kësaj prone mund të ndodhë.
- Transferimi i detyrimeve të NSh-ve tek blerësit që i përkasin 12 muajve të fundit ose 3 muajve të fundit në varësi nga lloji i obligimeve që transferohen.
- Vizitat dhe kontaktet me institucionet tjera relevante në mënyrë që të kemi një komunikim më të mirë institucionet e interesit të përbashkët si dhe koordinimin e aktiviteteve me njësitë përkatëse përbrenda njësisë së Qeverisjes së Korporatave dhe departamenteve tjera brenda AKP.

Më poshtë është pasqyruar në mënyrë tabelore përshkrimi i aktiviteteve të arritura të njësisë për kontroll dhe mbikëqyrje për periudhën raportuese 1 Janar deri 30 Shtator 2014:

Tabela e aktiviteteve kryesore

Aktivitetet	Të arriturat gjate periudhës raportuese
Raportet Financiare të Pranuara nga NSh-të	15
Transferimi i detyrimeve të NSh-ve tek blerësit	23

Tabela e aktiviteteve tjera

Aktivitetet e tjera	**Të arriturat gjatë periudhës raportuese**
Takime me institucionet tjera	5
Njoftimet mbi detyrimet e dorëzuara tek institucionet e tjera	46
Takime me menaxhmentin e NSh - ve	12
Totali	**63**

Njësia për kontroll dhe mbikëqyrje siç u tha edhe me lartë bën edhe monitorimin e ndërmarrjeve te privatizuara me spin off special dhe ndërmarrjeve të privatizuara me kushte. Në vazhdim po paraqesim raportin mbi ndërmarrjet që janë nën monitorim të NJKM.

“Spin off-et” Speciale

Që nga fillimi i procesit të privatizimit e deri më tani janë privatizuar 26 ndërmarrje përmes metodës së “Spin Off-it Special”. Janë tri ndërmarrje të privatizuara me metodën e “Spin Off-ve Speciale” të cilat kanë qenë në monitorim gjatë vitit 2014 dhe njëra prej tyre është liruar nga raportimi për shkak të plotësimit të kushteve të parapara me marrëveshjen e zotimeve (Jugoterm International Gjilan) është liruar me vendim te bordit te AKP-se. Ndërsa gjatë periudhës kohore Janar – Shtator 2014, dy ndërmarrje kanë vazhduar të jenë aktive, respektivisht në proces të përmbushjes së kushteve të Marrëveshjes për Zotime.

Më poshtë janë të listuara NSh-të e privatizuara përmes metodës së Spin Off-it Special të cilat kanë qenë në procesin e monitorimit gjatë periudhës Janar – Shtator 2014:

- IDGJ Tobacco
- NBI Suhareka (Agrokosova Holding)
- Jugoterm

Ndërmarrja e Re "IDGJ Tobacco" Ndërmarrja e Re "IDGJ Tobacco" Shpk, është privatizuar përmes metodës së Spin Off-it Special në valën e 11-të të shitjes, ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të parapara në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 13 Gusht 2008. Me datë 27 Mars 2012 është aprovuar Marrëveshja për Përtëritje (Novacion) e Marrëveshjes së Zotimeve lidhur me Ndërmarrjen e Re "IDGJ Tobacco" Shpk nga Grupi punues i AKP-së. Kjo Marrëveshje është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 29 Mars 2012, si dhe është nënshkruar nga të gjitha palët e përfshira në këtë Marrëveshje me datë 12 Prill 2012., ku kusht për këtë Ndërmarrje gjatë periudhës dy vjeçare është të realizoj Investime prej 4,000,000.00 € dhe të plotësoj numrin e punëtorëve prej 14 punëtor në muajin e parë, 35 punëtor në muajin e dytë, 55 punëtor në muajin e tretë dhe 90 punëtor nga muaji i katërt e deri në përfundim të Marrëveshjes së Novacionit. Periudha e raportimit për këtë ndërmarrje përfundon me 10 Shtator 2014.

Për periudhën dy vjeçare kjo Ndërmarrje ka dorëzuar tete (8) Raporte tre mujore. Ne mënyrë qe te verifikohen Investimet e realizuara dhe punësimi ne ketë Ndërmarrje nga ana e Blerësit, AKP do te angazhoj kompaninë audituese te pavarur për te bere auditimin e Investimeve dhe punësimit te realizuar. Ne ketë Ndërmarrje gjate vitit 2014 janë realizuar tete (8) vizita monitoruese.

Ndërmarrja e Re "Jugoterm International", është privatizuar përmes Spin Off-it Special në Valën e 15-të të shitjes, ndërsa ratifikimi i Kontratës është bërë me 17 Prill 2012. Zotimi për Investime duhet të përmbushet brenda periudhës dy vjeçare në vlerën prej 2,760,000.00 €, ndërsa Zotimi për Punësim me 282 punëtor me gjysmën e punëtorëve gjatë gjashtë muajve, ndërsa pjesën tjetër të punëtorëve deri në përfundimin e Zotimit në bazë të Kontratës. Ne ketë Ndërmarrje gjate vitit 2014 janë realizuar 7 vizita monitoruese. Me datën 26 dhe 31 Gusht 2014 ne Mbledhjen e mbajtur nga Bordi i Drejtoreve te AKP-se është marre vendimi për lirim nga Marrëveshja e Zotimeve, sipas nenit 7.1.1 dhe strategjisë së Bordit për trajtimin e spin-off-ve speciale për Ndërmarrjen e Re "Jugoterm International" LLC.

Ndërmarrja e Re "NBI Suhareka/Agrokosova Holding"- është privatizuar me 27 Gusht 2007 nga blerësi "Gruppo Vinicolo Fantinel" dhe "QMI" përmes metodës së "Spin Off-it Special" në valën e 19-të të shitjes ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të paraparë në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 27 gusht 2009. Sipas Marrëveshjes së Zotimeve blerësi është zotuar se do të bëjë investime kapitale në vlerë prej 8,600,000 euro si dhe të punësoj 173 punëtorë gjatë 6 mujorit të parë ndërsa në fund të vitit të parë numri i të punësuarve do të arrij gjithsej 345 punëtorë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese AKP ka angazhuar auditorë të jashtëm për të audituar përmbushjen e kushteve të marrëveshjes së zotimeve nga blerësit e Ndërmarrjes së Re "Agrokosova Holding". Sipas raportit të auditorit të jashtëm blerësi i ndërmarrjes së Re "Agrokosova Holding" ka përmbushur kushtin për investime kapitale në nivelin 88.87% ndërsa atë për punësim 39%. Në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të AKP të mbajtur me datën 20 korrik 2012, Bordi ka vendosur që vendimi i Bordit i datës 16 dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve të mbetet në fuqi por të shtyhet ekzekutimi i këtij vendimi për 6 muaj dhe në

ndërkohë të angazhohet një kompani që të bëjë vlerësimin e investimeve të bëra në këtë ndërmarrje dhe pastaj të rishikohet vendimi i Bordit për tërheqjen e aksioneve. Pastaj në mbledhjen e mbajtur me datën me datën 26 dhe 31 Gusht 2014 Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të privatizimit lidhur me çështjen e Ndërmarrjeve të reja të privatizuara ne Spin off Special ka vendosur që për Ndërmarrjen e Re "Agrokosova Holding" të anulohet vendimi i Bordit të datës 16 dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve dhe ti vazhdohet afati për përmbushjen e kushteve të Marrëveshjes për Zotime nga 27 gusht 2009 e deri me 31 dhjetor 2014 dhe pas përfundimit të afatit të auditohet ndërmarrja për tërë periudhën e investimeve sipas kontratës për të vërtetuar përmbushjen e zotimeve.

Ndërmarrja e Re "Kualiteti International" Sh.p.k Gjilan

Ndërmarrja e Re,, Kualiteti International'' Sh.p.k Gjilan është privatizuar në valën e 25 të shitjes dhe kontrata është nënshkruar më datën 26 maj 2008. Shitja e ndërmarrjes është bërë me spin off të thjeshtë por me kusht që gjatë periudhës 2 vjeçare ndërmarrja të mbaj aktivitetin e vet si mulli respektivishte si depo për grumbullimin e drithërave.

Në bazën e të dhënave të ndërmarrjeve të privatizuara me spin off special apo me kushte të trashëguara nga AKM nuk ka qenë e përfshirë kjo ndërmarrje se duhet monitoruar, prandaj edhe nuk është monitoruar asnjëherë aktiviteti i saj.

Më datën 20.10.2014 Blerësit të ndërmarrjes ,, Kualiteti International'' Sh.p.k Gjilan AKP i ka dorëzuar një shkresë ku ka kërkuar nga Bleresi që deri më datën 30.10.2014 të dorëzoj nje raport ku do të dëshmoj se gjatë kësaj periudhe ai ka mbajtur aktivitetin. Gjithashtu AKP e ka njoftuar Blerësin se AKP nuk disponon me asnjë vendim të bordit të AKP-së se Blerësi dhe Ndërmarrja e Re janë liruar nga marrëveshja e zotimeve. Lidhur me asetet e Neë Co,, Kualiteti International'' Gjilan ne kemi kërkuar nga Kuvendi Komunal i Gjilanit informata mbi regjistrimin e certifikatve të pronësisë të këaj ndërmarrje. Nga përgjigja e marrë nga zyrtarët komunal është theksuar se përpos ngastrës 2489/1 e cila është dhënë në shfrytëzim te personi tretë, ngastrat tjera janë në shfrytezim të Neë Co,, Kualiteti International''L.L.C – Gjilan, por që evidentohen të ngarkuara me barrë hipotekore.

Ndështkimet financiare për mospërmbushje te zotimeve

Për shkak te mospërmbushjes se zotimeve deri me tani janë aplikuar ndështkimet financiare për blerësit të cilët nuk i kane përmbushur zotimet.

Me poshtë japim formën tabelare te ndështkimeve për periudhën kohore Janar 2013 - Dhjetor 2013 si dhe shumën e përgjithshme e ndështkimeve financiare qe janë aplikuar deri në fillim te vitit 2013:

Shuma totale e ndështkimeve për 5 SSO-të		
Ndërmarrje Re	Periudha Janar – Shtator 2014	Prej datës së fillimit e deri më 30 Shtator
Ndërmarrja e Re Grand Hotel	0	8,822,314.97
Ndërmarrja e Re IDGJ Tobacco	0	4,573,649.11
Ndërmarrja e Re Xim Strezovc	0	7,298,170.76
Ndërmarrja e Re MIM Golesh	0	8,447,812.27
Ndërmarrja e Re Agrokosova Holding	0	3,579,997.53
Totali	**0**	**32,721,944.64**

Ndërmarrjet e Privatizuara me Kushte

Gjatë periudhës Janar – 30 Shtator 2014, Njëmbëdhjete Ndërmarrje të privatizuara me kushte kanë qenë në procesin e monitorimit të përmbushjes së kushteve të kontratës, kryesisht vazhdimit të aktivitetit të njëjtë të biznesit. Ndërmarrja "Rilindja Zona Industriale është liruar me vendim te Bordit të AKP të datës 27 Shkurt 2014 për shkak të përmbushjes së kushteve të marra përsipër me marrëveshjen e zotimeve.

Tabela përmbledhëse e ndërmarrjeve të privatizuara me kushte:

Nr.	Emri i Ndërmarrjes	Statusi
1	Ndërmarrja e Re "SharrCem"	Nën monitorim
2	Ndërmarrja e Re "Hotel Union"	Nën monitorim
3	Ndërmarrja e Re "Llamkos"	Nën monitorim
4	Ndërmarrja e Re "Famipa"	Nën monitorim
5	Ndërmarrja e Re "Amortizatorët"	Nën monitorim
6	Ndërmarrja e Re "Dubrava DF"	Nën monitorim
7	Ndërmarrja e Re "Emin Duraku-Edico"	Nën monitorim
8	Ndërmarrja e Re "Emin Duraku"- KI	Nën monitorim
9	Ndërmarrja e Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça"	Nën monitorim
10	Ndërmarrja e Re "Hotel Onix dhe Banja e Pejës"	Nën monitorim
11	Ndërmarrja e Re "Rilindja Zona Industriale" Sh.p.k	Është liruar

Ndërmarrja e Re "Sharrcem" është privatizuar me 9 Dhejtor 2010 për shumën prej EUR 30.1 milion. Sipas Marrëveshjes për Shitblerjen e aksioneve blerësi ka marrë përsipër që gjatë 5 viteve në vijim të bëjë investime në vlerë prej 35 milion euro si dhe të vazhdojë të punësoj gjatë 3 vitet e ardhshme të gjithë ish-punonjësit e ndërmarrjes, gjithsej 503.

Blerësi i Ndërmarrjes së Re "Sharrcem" gjatë periudhës 3 vjeçare vazhdimisht ka paraqitur raporte vjetore lidhur me investimet e realizuara në ndërmarrje Bazuar në raportimet e deritanishme për investime rezulton se blerësi ka raportuar investime në vlerë prej afërsisht 20.5 mil €. Megjithatë edhe përkundër investimeve të vazhdueshme në ndërmarrje gjatë dy viteve të fundit mund të vërehet se ka ulje të trendit të investimeve. Blerësi për vitin 2013 ka raportuar investimeve në vlerë prej afërsisht 3 mil € ndërsa gjatë vizitës së realizuar në muajin Gusht 2014 jemi informuar se deri tani blerësi ka investuar afërsisht 2.6 mil € dhe se shuma totale e investimeve për këtë vit nuk do të tejkaloj shumën 3.5 mil €. Edhe pse është ënde herët për të qenë plotësisht të sigurte por duke i bazuar në trendët e tanishme të investimeve ekziston rreziku që deri në përfundim të periudhës së zotimeve blerësi të mos mundë të realizoj shumë e zotuar prej 35 mil €. Ndërsa sa i përket punësimit blerësi vazhdon të punësoj të njëjtin numër të punonjësve edhe pse zotimi për punësim ka përfunduar në fund të vitit 2013. Ndërmarrja e Re "Sharrcem" është e obliguar t'i Raportoj AKP-së deri 9 Dhjetor 2015.

Ndërmarrja e Re "Llamkos Steel" Sh.p.k, Ndërmarrja e Re "Llamkos Steel" Sh.p.k, është privatizuar në valën 6 të shitjes përmes Likuidimit, ndërsa ratifikimi i Kontratës së Shitjes është bërë me datën 25 Gusht 2011. Bazuar në Marrëveshjen e Shitblerjes se aseteve dhe Planin e Biznesit, blerësi i Ndërmarrjes së re Llamkos ka marrë përsipër që të punësoj 437 punonjës 6 muaj pas nënshkrimit të kontratës si dhe të bëjë investime ne vlerë prej 25 milion Euro vetëm gjatë dy viteve të para të veprimtarisë.

Blerësi i ndërmarrjes gjithashtu merr përsipër të zbatoj edhe dy faza të tjera investimesh, gjate fazës së dytë (18 muaj pas përfundimit të fazës së parë) do të investohen edhe 45 mil Euro ndërsa gjatë fazës së tretë (18 muaj pas përfundimit të fazës së dyte) do të investohen edhe 30 mil Euro të tjera.

Pas përfundimit të fazës së parë të zotimeve dhe për qellim te verifikimit te përmbushjes së zotimeve AKP ka angazhuar kompaninë audituese "Grand Thorton'' e cila ka bëre auditivin e përmbushjes së zotimeve për investime kapitale dhe punësim. Sipas raportit te auditivit prej shumës totale te investimeve te raportuara nga ana e Blerësit vetëm shuma prej **10,485,335.00** Euro përmbush kriterin e investimeve ne përputhje me kontratën e shitblerjes dhe ajo është paraqitur ne kolonën 1.1 dhe 1.2 kurse pjesa tjetër e investimeve te paraqitura ne tabelën e mëposhtme nuk janë pranuar si investime.

Prandaj si pasojë e mospërmbushjes së kushteve të kontratës për investime për periudhën e pare 24 mujore Bordi I Drejtorëve të AKP në mbledhje e mbajtur me datën 27 Qershor 2014 Bordi i Drejtorëve të AKP ka nxjerr vendim që të imponoj ndëshkime financiare për Ndërmarrjen e Re Llamkos Steel" në Vushtrri. Pas pranimit të vendimit të Bordit Nr. Ref. BD-67/14, NjKM dhe Menaxhmenti i AKP i ka dërguar blerësit të ndërmarrjes njoftimin lidhur me vendimin e bordit për imponimin e ndëshkimeve financiare së bashku me vendimin. Shuma e ndëshkimit është gjithsej EUR 1.6 milion. Njoftimi për ndëshkim është dërguar gjatë muajit Tetor 2014. Kjo shumë do të paraqitet si e ardhur e arkëtueshme në pasqyrat financiare të datës 31 Dhjetor 2014.

Gjatë vitit 2014 Njësi për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese në këtë ndërmarrje. Bazuar në atë çfarë kemi parë gjatë vizitës gjendja në Ndërmarrjen e Re "Llamkos" është jo e kënaqshme dhe është duke u përkeqësuar dita ditës. Ndërmarrja aktualisht nuk zhvillon asnjë veprimtari prodhuese si pasojë e vështirësive financiare me të cilat po ballafaqohet blerësi i ndërmarrjes punëtorëve të kësaj ndërmarrje nuk iu janë paguar pagat që nga muaji mars 2014. Po ashtu duhet të vihet në dukje se në ndërmarrje kemi parë vetëm dy punëtorë të sigurimit fizik ndërsa pjesët tjera të fabrikës siç janë rezervarët e gazit dhe amoniakut janë pa kurrfarë mbikëqyrje.

Ndërmarrja e Re "Famipa" Ndërmarrja e Re "Famipa" sh.p.k është privatizuar në valën 49 të shitjeve, ndërsa Kontrata e Shitblerjes është nënshkruar me datën 13 Shtator 2011.

Shtojca 5, Seksioni B i Deklaratës së bartjes të aseteve dhe detyrimeve parasheh që blerësi i Ndërmarrjes së Re "Famipa" do të vazhdoj aktivitetin e njëjtë në ndërmarrje (prodhimin dhe përpunimin e metaleve) si dhe nuk do të çmontoj dhe dislokoj pajisjet nga ndërmarrja të paktën deri në përfundim të kontratës.

Gjate vitit 2014 Njësi për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese në këtë ndërmarrje. Ndërmarrja e re "Famipa" është një nga ndërmarrjet e privatizuara me kushte që vazhdimisht ka pas mjaft vështirësi në përmbushjen e kushteve të kontratës dhe ndërmarrje asnjëherë nuk ka arrit të zhvilloj aktivitet të pandërprerë por ka funksionuar vetëm gjatë periudhave të ndryshme kohore kur ka pas porosi. Vlen të theksohet se në disa raste gjatë kohës kur kemi realizuar vizita monitoruese në ndërmarrje, punonjësit e ndërmarrjes na kanë informuar se ata janë ftuar të jenë prezent në ndërmarrje gjatë kohës kur Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka paralajmëruar vizitë të rregullt monitoruese.

Duke marrë parasysh se raportimet e blerësit kanë qenë vetëm sipërfaqësore ku në formë të shkruar janë përshkruar aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës raportuese dhe të njëjtat nuk janë mbështetë me fakte, Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje disa herë iu ka drejtuar blerësit në formë të shkruar dhe ka kërkuar nga ai që të sjell dëshmi bindëse për të dëshmuar se është duke i përmbushur kushtet e kontratës. Në përfundim të periudhës kontraktuese përfaqësuesit e blerësit kanë paraqitur dy raporte shumë voluminoze si prova për vazhdim të aktivitetit. Megjithatë këto dokumente duhet të shqyrtohen hollësisht dhe me kujdes ndërsa për qellim të auditimit të plotësimit të kushteve të kontratës AKP ka angazhuar Kompaninë e Auditimit "AUDIT AK" që të bëj auditimin e plotësimit të kushteve të kontratës Nr. 1948/2011 të nënshkruar në mes të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Blerësve të Ndërmarrjes së Re "Famipa" Sh.p.k në Prizren.

Ndërmarrja e Re "Hotel Union" Ndërmarrja e Re Hotel Union është privatizuar në valën 11, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 02 Gusht 2006. Bazuar në Marrëveshjen e Zotimeve 541/2006, neni 2 dhe 3, blerësi i Ndërmarrje së Re është zotuar së do të restauroj dhe mirëmbajë pamjen e jashtme të ndërtesës në atë mënyrë që thellësisht do të ruaj stilin dhe karakterin historik të ndërtesës si dhe t'i siguroj Aleancës së Shkrimtarëve të Kosovës një hapësirë prej 200 m2 për 13 vitet e ardhshme. Pas rinovimit the funksionalizimit të objektit të ndërmarrjes, Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka organizuar disa takime të përbashkëta me përfaqësuesit e blerësit dhe Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës me qellim të përcaktimit të hapësirës që i takon LSHK megjithatë edhe pas shumë takimeve palët nuk kanë mundur të arrijnë një marrëveshje të pranueshme. Në këto takime Blerësi ka propozuar që përfaqësuesit e Lidhjes së

Shkrimtarëve të zgjedhin një lokacion në qendër të qytetit dhe të paguaj qiranë për 13 vite. Në anën tjetër Përfaqësuesit e Lidhjes së shkrimtareve nuk janë pajtuar që të zgjedhin një lokacion tjetër duke insistuar se bazuar në marrëveshjen me AKP Blerësi ka obligim që të siguroj hapësirën për Lidhjen e shkrimtareve brenda Objektit te Hotel Union. Pas përpjekjeve të shumta të NJKM për të ofruar qëndrimet e palëve, ato deri më tani nuk kanë treguar shenja që janë të gatshme për kompromis në mënyrë që kushti kontraktual të përmbushet në tërësi.

Pasi që palët nuk kanë arritur të merren vesh, dhe se mospërmbushja e kushtit të kontratës që ka të bëjë me Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës përbën shkelje të kushteve të kontratës, NJKM ka qenë e detyruar konform Marrëveshjes së zotimeve, të përpiloj një njoftim për shkelje të kushteve të kontratës dhe t'ja dërgoj blerësit. Në letrën e dërguar është cekur që "AKP konsideron se mos sigurimi i hapësirës së premtuar për Shoqatën e Shkrimtarëve paraqet shkelje të "Marrëveshjes së Zotimeve"". Respektivisht nenit 6.2.3 të Marrëveshjes së Zotimeve duke ia kujtuar që Benetton ka 10 ditë pune për të sanuar shkeljen e rëndë apo të dorëzojë AKP-së dëshmi të mjaftueshme që një shkelje e tillë nuk ekziston.
Sipas informatave të fundit që ka NjKM blerësi i Hotel Union është duke shqyrtuar mundësin që ti paguaj Lidhjes së Shkrimtarëve qiranë për tërë periudhën (13 Vite) ashtu siç ka qenë kërkesa e parashtruar me shkrim nga ana e Lidhjes së Shkrimtarëve.

Ndërmarrja e Re "Hotel Onix Banja e Pejës dhe Banja e Shëndetit '' Pejë;

Ndërmarrja e Re "Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix" shpk, është privatizuar si projekt individual përmes tenderit ndërkombëtarë ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 22 prill 2013. Bazuar në shtojcën 1, Marrëveshja për Zotime e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve të thjeshta në Ndërmarrjen e Re "Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix" shpk, Blerësi është zotuar si në vijim:

Të vazhdoj aktivitetin aktual të biznesit që nënkupton vazhdimin e veprimtarisë së njëjtë të Ndërmarrjes Shoqërore në banjë shëndetësore dhe hotel. Blerësi i Ndërmarrjes së Re siguron dhe garanton se do të vazhdoj dhe do të mbajë aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e Periudhës se Zotimit. Ndërmarrjen e Re "Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix", është duke zhvilluar veprimtari biznesi dhe Blerësi është duke e ju përmbajtur kushteve të kontratës ashtu siç është zotuar. Përpos vazhdimit të veprimtarisë së biznesit blerësi ka bërë edhe investime të konsiderueshme në rindërtimin e objekteve dhe përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse

Gjatë vitit 2014 NjKM ka realizuar vizita të rregullta monitoruese në Ndërmarrja e Re "Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix" Sh.p.k në Banjë të Pejës. Bazuar në atë çfarë kemi parë gjatë vizitave monitoruese. Ndërmarrjen e Re "Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix", është duke zhvilluar veprimtari biznesi dhe Blerësi është duke e ju përmbajtur kushteve të kontratës ashtu siç është zotuar. Vlen të theksohet se blerësi i ri ka përfunduar renovimin e objektit të vjetër (ish Termali) dhe në të njëjtën kohë ka dyfishuar kapacitetin e këtij objekti. Sipas informatave që kemi marrë gjatë vizitës monitoruese në këtë objekt pas renovimit mundë të akomodohen rreth 350 pacient. Ndërmarrja aktualisht ka në shfrytëzim të gjitha kapacitetet në dispozicion dhe të gjitha dhomat janë të mbushura me pacient ndërsa në anën tjetër janë bërë rezervime për të paktën edhe muajin e ardhshëm.

Ndërmarrja e Re "Fabrika e Amortizatorëve" - është privatizuar në valën 45A, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar më 31 Mars 2011. Ndërmarrja e Re "Fabrika e Amortizatorëve gjendet në Komunën e Prishtinës. Në bazë të marrëveshjes, si detyrim kontraktues Blerësi i ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe mbaj aktivitetin aktual të biznesit. Gjate vitit 2014 janë realizuar gjashte (6) vizita monitoruese nga te cilat munde te përfundojmë se ndërmarrja zhvillon aktivitetin prodhues sipas kërkesave individuale por jo edhe ndonjë prodhim serik te amortizatorëve.

Blerësi ka raportuar ne periudha te rregullta ashtu siç parashihet edhe me Kontrate, por deri me tani nuk ka raportuar për Investime te bëra dhe punësim te realizuar, duke u thirrur ne atë se sipas kontratës se Shitblerjes nuk është i obliguar. Periudha e Monitorimit përfundon me 31 Mars 2016.

Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Kompleksi Industrial" Shpk, është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 03 Shtator 2012. Ndërmarrja e Re ""Emin Duraku Kompleksi Industrial" Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 03 Shator 2017. Nga fillimi i vitit 2014 e deri me tani janë realizuar shtate (7) vizita monitoruese. Blerësi ka rindërtuar njërin nga objektet e Ndërmarrjes, ku si aktivitet ka qepjen e dyshekëve dhe jastëkëve. Ne baze te marrëveshjes se shitjes Ndërmarrja ne vitin e parë duhet të raportoj çdo tre muaj, ndërsa gjatë viteve të tjera çdo gjashtë muaj. Blerësi ka raportuar ne periudha te rregullta ashtu siç parashihet edhe me Kontrate, por deri me tani nuk ka raportuar për Investime te bëra dhe punësim te realizuar, duke u thirrur ne atë se sipas kontratës se shitblerjes nuk është i obliguar.

Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Edico" Shpk, është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 14 Gusht 2012. Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Edico" Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 14 Gusht 2017. Blerësi raporton çdo 6 muaj.

Blerësi është duke e mbajtur dhe vazhduar aktivitetin, kryesisht aktiviteti zhvillohet ne fushën e tekstilit, produktet e prodhuara shiten ne tregun vendor. Blerësi mban te punësuar me orar dhe pagese te plote 17 punëtor, po ashtu për ata punëtor paguan edhe një shujte te ngrohtë. Qe nga fillimi i vitit e deri me tani ne ketë Ndërmarrje janë realizuar shtatë (7) vizita monitoruese.

Ndërmarrja e Re "Dubrava Dairy Farm" – është privatizuar në valën e 28 –të të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 19 Dhjetor 2011. Ndërmarrja e Re "Dubrava Dairy Farm" gjindet në Komunën e Istogut. Në bazë të Marrëveshjes, si detyrim kontraktues Blerësi i Ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe të mbaj aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së detyrimit kontraktues, respektivisht deri më 19 Dhjetor 2016, (periudha prej 5 viteve). Detyrimi kontraktues që del nga kontrata është që Ndërmarrja e Re "Dubrava Dairy Farm" është e obliguar të mbaj të punësuar 17 punëtor, si dhe të mbaj 250 krerë gjedhe për ketë periudhë kohore në bazë të Kontratës. Bazuar në Raportet gjashtëmujore, Blerësi ka investuar në blerjen e 250 krerë gjedheve dhe ka punësuar 17 punëtorë në bazë të Kontratës. Që nga fillimi i vitit e deri me tani në ketë Ndërmarrje janë realizuar gjashtë (6) vizita monitoruese.

Ndërmarrja e Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça" - Ndërmarrja e Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça" Sh.p.k, është privatizuar si projekt individual, ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 14 Qershor 2013. Me këtë Blerësi i Ri siguron dhe garanton se do të vazhdoj dhe do të mbaj aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së Zotimit për tri vitet e ardhshme, konkretisht deri më 14 Qershor 2016. Blerësi ka raportuar ne baza te rregullta ashtu siç parashihet me kontrate. Prodhohen bateri për shtëpi dhe bateri industriale vetëm kur kane porosi për to, përndryshe Ndërmarrja nuk prodhon vazhdimisht, dmth nuk ka linje te pandërprerë prodhimi te baterive. Qe nga fillimi i vitit e deri me tani ne ketë Ndërmarrje janë realizuar shtatë (7) vizita monitoruese.

Ndërmarrja e Re "Rilindja Zona Industriale" Sh.p.k, është privatizuar si Spin-Off në valën e 56, ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 08 Nëntor 2013.

Bazuar në nenin 2, të Marrëveshjes së Zotimeve, e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve të thjeshta në Ndërmarrjen e Re "Rilindja Zona Industriale" Sh.p.k, Blerësi është zotuar si në vijim:

- Siguron dhe garanton se do të mbajë të punësuar 110 (njëqind e dhjetë) punëtor me orar të plotë gjatë periudhës së Zotimit, periudhë kjo e cila hyn në fuqi nga data 08 Nëntor 2013 dhe do të zgjasë 60 ditë kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së Shitjes, konkretisht deri më 08 Janar 2014.

Kjo ndërmarrje është liruar nga marrëveshja e zotimeve me vendim te Bordit te AKP te datës 27 Shkurt 2014

IV.4. NJËSIA E ADMINISTRIMIT DIREKT

Në rrjedhën normale të ngjarjeve, mbikëqyrja, kontrolli dhe monitorimi i ndërmarrjeve është bërë nga Zyrat Rajonale të AKP-së. Masat e Administrimit Direkt janë implementuar në rastet specifike kur një NSH kishte ngadalësim apo ngecje në progres apo ishte në rrezikshmëri financiare për shkak të keqmenaxhimit, apo dëmtimit të aseteve e që reflektonte në dëm të interesave të NSH-së dhe punëtorëve të saj. Kur Zyrat Rajonale të kenë shterur të gjitha mundësitë dhe opsionet për të gjeneruar ndikim pozitiv në NSH-në e cila shfaq një trend të rënies, atëherë propozohen masat e Administrimit Direkt nga Zyrat Rajonale të AKP-së për t'u implementuar në këtë ndërmarrje. Të gjitha NSH-të e vendosura dhe/ose të larguara nga AD janë të miratuara nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

Gjate këtij 9 mujori Njësia e AD ishte kryesisht e fokusuar ne Administrimin e Ndërmarrjeve te cilat me vendim te Bordit ishin vendosur nen AD, po ashtu kishte përgatitur te dhënat për Ndërmarrjet te cilat janë larguar nga AD.

1. Ndërmarrjet e vëna nën Administrim Direkt gjatë periudhës Janar – Shtator 2014:

NSH "KDSHF GENCI" Prishtinë

Pas futjes se Ndërmarrjes Shoqërore nën kontrollin të Njësisë së Administrimit Direkt, duke u mbështetur në ligjin e AKP-së dhe politikat operacionale, me qëllim të rritjes së vlerës dhe menaxhimit më të mirë të ndërmarrjes, u ndërmorën masat e menjëhershme si në vijim:

- Inspektimi i aktiviteteve financiare dhe qasja në xhirollogaritë bankare të Ndërmarrjes;
- Emërimin e Bordit të Përkohshëm Menaxhues
- Inspektimi i dokumenteve ligjore, përfshirë aktivitete e kontraktuara;
- Regjistrimi i aseteve të Ndërmarrjes;
- Takimi me Menaxhmentin, Sindikatën e Punëtorëve dhe njoftimi me Ligjin dhe rregulloret e punës së AKP-së;

Aktualisht ndërmarrja ushtron aktivitetin e saj me sukses dhe nuk ka vështirësi operaionale. Ndërmarrja ka ne shfrytëzim objektin e Ndermarrjes Publike Banesore ne te cilin shfaqen filmat. Te hyrat realizohen nga shfaqja e filmave si dhe nga lëshimi i aseteve me qira.

2. Ndërmarrjet që janë larguar nga Administrimi Direkt gjatë periudhës Janar – Shator 2014:

NSH "Fapol" Podujevë

Me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së kjo Ndërmarrja me datë 06 Qershor 2013 është vendosur nën Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së me qëllim të krijimit të një strukture të brendshme organizative, dhe me qellim të hartimit të skemës organizative dhe skemës së re të pagave.

Gjatë kësaj periudhe raportuese 9 mujore, Ndërmarrja ka pasur vështirësi të shumta në funksionimin e sajë pasi qe nuk ishte licencuar për ushtrimin e aktivitetit te terminalit doganor, dhe kjo gjë kishte shkaktuar rënien e te hyrave dhe përfundimisht ne muajin korrik edhe largimin e te gjithë shpeditereve nga terminali me ç'rast edhe është mbyllur aktiviteti i zhdoganimit te mallrave.

Kjo Ndërmarrje ne vazhdimësi ka operuar me fitim e po ashtu nuk ka pasur borxhe e as kreditor te regjistruar.

Në muajin Gusht 2014 Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka marrë vendim që kjo NSH të largohet nga Administrimi Direkt dhe të futet ne Likuidim. Ky vendim ka hyrë ne fuqi me datën 01.10.2014.

3. Ndërmarrjet që cilat janë Aktualisht nën Administrim Direkt

Ndërmarrja e re "Grand Hotel Prishtina" Prishtinë

Ndërmarrja e re Grand Hotel është vendosur nën Administrim Direkt më 20 Korrik 2012. Gjendja e kësaj Ndërmarrje ka qenë shumë e vështirë. Pas stabilizimit te situatës ne Ndërmarrje duke nënshkruar marrëveshje për riprogramim të borxheve me Ndërmarrje publike, KEK, PTK, TERMOKOS; si dhe shpërndarjen e pagave të punëtorëve me rregull, AD kishte lëshuar me qira disa asete nder te cilat: parkingu, zyre, lokale afariste, restorante dhe hapësira reklamuese nga të cilat janë paguar borxhet e Ndermarrjes si dhe janë siguruar pagat për punëtorë.

Gjatë periudhës 9 mujore të vitit 2014, Ndërmarrja ka vazhduar aktivitetin e sajë ditor duke ofruar shërbimet Hoteliere, siç janë: fjetjet, ahengje te ndryshme, konferenca, si dhe vazhdimin kontratave te qirasë apo edhe rishpalljen e disa aseteve me qira varësisht nga skadimi i kontratave.

Të dhënat financiare për periudhën 01.01.2014 deri me 30.09.2014 për NR "Hotel Grand" kanë qenë si vijon:

Te hyrat ..... 605,579.40 euro

Shpenzimet ..... 499,317.32 euro dhe

Fitimi operativ..... 106,262.08 euro

NSH "Boksitet e Kosoves"

Kjo ndermarrjes gjate ketij 9 mujori ka funksionuar me bilanc pozitiv ne aspektin operativ ngase ka arritur te inkasoj te hyra per ti permbyllur obligimet e pagave per punetorët aktiv të Ndërmarrjes. Edhe ne kete periudhe ka pasur probleme te natyres juridike, krysisht me pronen e kesaj Ndermarrje e cila ende figuron ne emer te Ekonomise Pyjore. Dy asetet kryesore te kesaj Ndermarrje Separacioni dhe Fabrika e Llaqit jane te leshuara me qira.

NSH "Ereniku –Industria" Gjakove

Kjo Ndermarrje gjate ketij 9 mjori ka vazhduar te mos ushtroj aktivitetin e saj. Të hyrat e vetme realizohen nga lëshimi i aseteve me qira. Për shkak te Vendimit të Dhomes se Posaçme te Gjykates Supreme nuk ka mundur te futet ne likuidim. Punetoret aktiv paguhen me rregull.

Ndërmarrje e Re "MIM Golesh"

Bordi i Drejtoreve te AKP-se pas vendimit per terheqjen e aksioneve ka vendosur qe kjo Ndërmarrje te vendoset nen Administrim Direkt. Gjatë muajit Tetor 2014 është ekzekutuar vendimit i Bordit per terheqjen e aksioneve dhe është vendosur nën Administrim Direkt.

V. DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUDIMIT

Divizioni i Koordinimit të Likuidimit (DKL) në kuadër të të cilit është pjesë Departamenti për Koordinim të Likuidimit i cili përbëhet nga tre njësi:

1. Njësia e Monitorimit të Likuidimit dhe Fondeve të Mbetura
2. Njësia e Likuidimeve nga AKP-ja
3. Njësia për Listat e Punëtorëve

NJËSIA E MONITORIMIT TË LIKUIDIMIT DHE FONDEVE TË MBETURA

Fillimi i procedurave të likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore

Gjatë periudhës raportuese Janar – Shtator 2014, kanë filluar procedurat e likuidimit dhe emërimin e Autoriteteve të Likuidimit për 122 Ndërmarrje Shoqërore.

Me fillimin e procedurave janë bërë njoftimet për kreditorët nëpër gazeta në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi, siç është e paraparë me Ligjin mbi AKP-në. Gjithashtu Autoritetet e Likuidimit kanë dërguar njoftim tek kreditorët e njohur për fillimin e procedurave të likuidimit si dhe kanë filluar me shqyrtimin e kërkesave të kreditorëve brenda afateve ligjore.

Nga 122 Ndërmarrje Shoqërore likuidimi i së cilave ka filluar në periudhën raportuese tashmë afati për parashtrimin e kërkesave është mbyllur për 110 prej tyre ndërsa 12 Ndërmarrje Shoqërore të tjera janë në proces të pranimit të kërkesave. Në këtë periudhë nga pretenduesit e ndryshëm janë dorëzuar 11,957 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) kërkesa kreditore pranë zyrës për pranimin e kërkesave në DKL, ku pastaj në mënyrë periodike janë bartur tek Autoritetet e Likuidimit të Ndërmarrjeve përkatëse nëpër zyrat rajonale respektive.

Rezultatet e shqyrtimit të kërkesave nga Autoriteti i Likuidimit

Në përputhje me Ligjin nr 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në Korrik 2012 është angazhuar konzorciumi “Deloitte dhe Tashko&Pustina” për projektin e ofrimit të Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e Portofolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës.

Përveç 327 Autoriteteve të Likuidimit sa kanë qenë të emëruara, gjatë periudhës raportuese janë emëruar edhe 122 Autoritete të Likuidimit për NSh-të të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit gjatë vitit 2014, gjithsej 449.

Gjatë periudhës raportuese Autoritetet e Likuidimit të këtyre ndërmarrjeve kanë arritur që të bëjnë shqyrtimin dhe të dërgojnë 28,877 vendime tek pretenduesit të cilët kanë parashtruar kërkesa pranë Agjencisë. Autoritetet e Likuidimit të këtyre Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim kanë përgatitur edhe 2,463 draft vendime të cilat pas kalimit të procedurave të kontrollit të kualitetit edhe këto pritet që së

shpejti të ju dërgohen palëve. Gjatë periudhës raportuese janë edhe 4,484 kërkesa për informata shtesë të cilat janë dërguar te pretenduesit.

Autoritetet e Likuidimit të këtyre Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim kanë përgatitur raportet përfundimtare dhe raportet për shpërndarje për 25 Ndërmarrje Shoqërore të cilat i janë prezantuar Bordit të Drejtorëve të AKP-së për aprovim, ndërsa janë përgatitur edhe 137 Draft Raporte për Shpërndarje për po kaq Ndërmarrje Shoqërore në Likuidim.

Procedurat e likuidimit të përfunduara nga Autoritetet e Likuidimit

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë nën procesin e likuidimit, vetëm për 25 NSh janë përgatitur raportet përfundimtare ose ato të shpërndarjes përfundimtare apo të përkohshme të fondeve.

Përderisa në anën tjetër, për pjesën tjetër të ndërmarrjeve, 424 ende janë duke vazhduar procedurat e likuidimit, përkatësisht procedurat e parapara ligjore lidhur me shqyrtimi e kërkesave kreditore, përgatitjen e Raporteve Përfundimtare për përmbylljen e procesit të likuidimit si dhe shpërndarjen e fondeve tepricë në buxhetin e Republikës së Kosovës. Pritet që në muajt në vijim të shënohet progres në procesin e përfundimit të procedurave të likuidimit të këtyre ndërmarrjeve nëse plotësohet Bordi i Drejtorëve të Agjencisë, nëse përfundon procesi i shitjes së aseteve të mbetura si dhe nëse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e përshpejton procesin e punës së vetë në raport me procesin e likuidimit.

Tabela përmbledhëse e kërkesave të shqyrtuara të kreditorëve:

1	Numri i të gjitha kërkesave të dorëzuara në Agjenci që nga fillimi i procesit të likuidimit	87,626
2	Numri i vendimeve të marrura nga KL-të (AKM-AKP)	5,986
3	Numri i vendimeve të marra nga Kontraktori (AL-të)	70,589
4	Numri i kërkesave të reja të pranuara që nga fillimi i punës së kontraktorit	37,621
5	Numri i të gjitha kërkesave ende të pa shqyrtuara	11,051

NJËSIA E LIKUIDIMEVE NGA AKP

Bazuar në nenin 13 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, në rastet kur ndërmarrja shoqërore e cila është objekt i likuidimit nuk ka asnjë pasuri apo kundër së cilës nuk është parashtruar asnjë kërkesë kreditore në afat, atëherë në këto raste anëtarët e AL-së emërohen nga radhët e personelit të AKP-së, dhe i gjithë procesi i

likuidimit të këtyre ndërmarrjeve realizohet nga Njësia përkatëse përbrenda agjencisë, gjegjësisht Njësia e Likuidimit të NSh-ve nga AKP-ja.

Gjatë periudhës raportuese Janar - Shtator 2014, në Njësinë e Likuidimeve nga AKP-ja nuk ka kaluar asnjë NSh shtesë nga ato 10 që kanë qenë në periudhat e mëhershme raportuese, konform ligjit është punuar në përgatitjen e raporteve përfundimtare të NSh-ve të mëhershme që kanë qenë në kompetencë të kësaj Njësie.

Në vijim janë të listuara NSh-të për të cilat është punuar në procesin e përmbylljes së likuidimit:

1. Kooperativa Bujqësore "Klina" – Skenderaj
2. Kooperativa Bujqësore "Vitomirica" – Pejë
3. NSh SHAM "Ruzhdi Bytyqi" – Vushtrri
4. NSh "Auto Moto" – Prizren

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës ka aprovuar Raportet Përfundimtare të procesit të likuidimit dhe në të njëjtën kohë ka lejuar përmbylljen e procesit të likuidimit për 3 Ndërmarrje Shoqërore (pa asete ose pa kërkesa kreditore) dhe është refuzuar një raport përfundimtar për KB Klina Skenderaj.

Në vijim janë ndërmarrjet për të cilat është përmbyllur procesi i likuidimit dhe NSh-ja raporti i së cilës është kundërshtuar nga DHPGJS-ja gjatë periudhës raportuese i cili pasi të përgatitet konform vendimit të DHPGJS-së do i prezentohet prapë për aprovim.

Emri i Ndërmarrjes:	**Data e Vendimit të DhPGjS-së:**
1. SHAM "Semafori" – Suharekë	17 Janar 2014
2. Kooperativa Bujqësore "Ozdrim" – Pejë	27 Shkurt 2014
3. NSh SHAM "Ruzhdi Bytyqi" – Vushtrri	19 Mars 2014
4. Kooperativa Bujqësore "Klina" – Skenderaj	4 Prill 2014

Gjithashtu, si rezultat i përfundimit të procedurave të likuidimit janë përgatitur Raportet Përfundimtare të procesit të likuidimit edhe për 2 ndërmarrje dhe të njëjtat pasi t'i prezentohen Bordit të Drejtorëve do të dërgohen në DHPGJS me kërkesë për aprovim të përmbylljes së likuidimit të këtyre ndërmarrjeve.

NJËSIA PËR LISTAT E PUNËTORËVE PËR 20%

Njësia e listave të punëtorëve është përgjegjëse për pranimin nga menaxhmenti i NSh-ve, verifikimin dhe përgatitjen për publikim të listave fillestare dhe finale të punëtorëve të kualifikuar si dhe shpërndarjen e

fondeve të 20%-it nga çmimi i shitjes i aseteve të NSh-ve për ish punëtorët e atyre NSh-ve të cilat janë përfshirë në procesin e shitjes së aseteve përmes privatizimit apo shitjes përmes likuidimit.

Njëri prej aktiviteteve kryesore të kësaj njësie është shpërndarja e pjesshme e 20 % nga shitjet e NSh-ve dhe shpërndarjen nga shitjet e mëpastajshme të aseteve. Ky aktivitet ende mbetet një nga aktivitetet me prioritet i AKP-së. Përgatitja dhe publikimi i Listave fillestare dhe Listave finale po ashtu është trajtuar me prioritet të lartë. Gjatë periudhës raportuese Janar – Shtator 2014, kjo njësi ka arritur që të publikoj gjithsej 13 Lista të punëtorëve edhe atë 5 Lista fillestare dhe 8 Lista Finale si dhe ka bërë shpërndarjen e pjesshme të 20 % për punëtorët e kualifikuar për 203 Ndërmarrje Shoqërore dhe shpërndarjen nga shitjet e mëpastajshme të aseteve.

Shuma e fondeve të shpërndara për këtë periudhë raportuese është € 13,805,768.79 ndërsa numri i përfituesve nga shpërndarja e këtyre fondeve është 31,850 punëtor. Në këtë shumë bënë pjesë edhe shpërndarja e fondeve për shitjen e mëvonshme të aseteve të NSh-ve të cilat janë privatizuar në fazat e mëhershme të privatizimit.

VI. NJËSIA E RIORGANIZIMIT DHE ADMINISTRIMI I NSH-VE

1. Veprimet e ndërmarra në Planin e Riorganizimit të Trepçës

Në cilësinë e Administratorit, AKP ka ushtruar mandatin e saj në përputhje të plotë me Ligjin për Riorganizim të Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurive të Tyre duke respektuar dispozitat e këtij Ligji. Në funksion të kësaj, Njësia për Riorganizim të Trepçës (NjRT) - AKP ka punuar me prioritet në përgatitje të kushteve për hartim të Planit të Riorganizimit që është edhe objektiv i Administratorit.

Për shkak të kompleksitetit të madh që ka ndërmarrja Trepça dhe interesit vital ekonomik, AKP, me qëllim të përmbushjes së mandatit, ka iniciuar procedurat për angazhimin e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale (OSHP) që do të ofrojë përvojat dhe ekspertizat e rangut ndërkombëtar, që nevojiten për hartim të Planit të Riorganizimit të suksesshëm.

Duke ditur rëndësinë e procesit, si dhe duke pritur se tenderi për OSHP do të ketë si kundërvlerë implikime të mëdha financiare që do të financohen me paranë publike të Buxhetit të Republikës së Kosovës, AKP ka konsideruar se koordinimi shtesë para cilitdo veprim dhe vendim që do të ndërmerret në kuadër të riorganizimit, është i domosdoshëm. Andaj, me qëllim të përmbushjes së mandatit, AKP ka tentuar të inicojë procedurat për angazhimin e OSHP me koordinim ndërinstitucional, dhe në vendimmarrje të përbashkët me institucionet relevante, Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DhPGjS), Kuvendin e Kosovës dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës - me theks te veçante Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik.

Nisur nga fakti se procedurat ligjore për ndryshimin e kornizës Ligjore për Trepçën janë iniciuar në Kuvendin e Kosovës, AKP nuk ka mundur të injorojë të njëjtat, megjithëse si Institucion i Pavarur Publik, AKP ka vazhduar me punën e Administrimit të Trepçës në përputhje me Ligjin në fuqi, dhe ka iniciuar tenderin për angazhim të OSHP. Kjo, për faktin se AKP ka qenë e obliguar të respektoj Ligjin, afatet ligjore, dhe Udhëzimet e DhPGjS si mbikëqyrëse e procesit Riorganizimit në Ndërmarrjen Trepça

Megjithatë, Komisioni për vlerësim ka vlerësuar vetëm një ofertë si të përgjegjshme sipas kritereve dhe Ligjit për Prokurim Publik, andaj më 20 Maj 2014 AKP ka anuluar Tenderin për angazhim të OShP.

Sipas afateve ligjore, Agjencia ka qenë e obliguar të siguroj që Plani i Riorganizimit për Trepçën të dorëzohet në DhPGjS për aprovim deri në fund të korrikut 2014, gjë që ka qenë e pamundur të realizohet marrë parasysh afatin e shkurtër kohor dhe anulimin e tenderit. Për shkak të rrethanave të lartcekura AKP ka shfrytëzuar të drejtën të kërkojë zgjatjen e afatit për dorëzim të Planit Riorganizimit.

AKP me 10 korrik 2014, ka parashtruar kërkesë në DhPGjS me anë të së cilës ka kërkuar miratim për shtyrjen e afatit për dorëzimin e Planit të Riorganizimit edhe për 18 muaj shtesë. Kjo kërkesë është parashtruar pas krijimit të rrethanave aktuale: dështimi i tenderit të parë për angazhimin e OSHP-së, zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2014, si dhe disa faktorë të tjerë. Gjithashtu përbërja jo e plotë e Bordit të Drejtorëve të AKP, dhe përfundimi i mandatit të Bordit, ishin shkaqe kryesore që BiD AKP ka autorizuar Menaxhmentin që të paraqesë kërkesë në DhPGjS kërkesën për shtyrjen e afatit.

Dhoma me Aktvendim përcaktoi se aprovohet kërkesa për zgjatje të afatit për dorëzim të Planit të Riorganizimit deri më 2 prill 2015, që nënkupton shtyrje të afatit edhe për 8 muaj.

Në mbledhjen e fundit të Bordit të Drejtorëve të mbajtur me 26 dhe 31 gusht 2014, është vendosur për shpalljen e tenderit për OSHP, si dhe disa kompetenca të tjera janë deleguar tek Menaxhmenti për ridraftim dhe shqyrtim të Termave të Referencës.

Për shkak të rrethanave të krijuara pas Shtatorit (mungesa e kuorumit e Bordit të Drejtorëve) ka krijuar situatat e mëposhtme:

1. Pamundësuar inicimin e veprimeve që duhen të ndërmerren për realizim të Planit të Riorganizimit të tilla si angazhimi i Ofruesit të Shërbimeve Profesionale. Situata aktuale nuk krijon mundësitë që tenderimi dhe përzgjedhja së OShP-së të realizohet me sukses brenda afatit të dhënë nga DhPGjS .
2. rrezikojnë arritjen e objektivave të Administratorit, e që është Dorëzimi i Planit të Riorganizimit brenda afateve të caktuara nga Dhoma e Posaçme.

- NjRT ka finalizuar regjistrimin e kërkesave kreditore. Kërkesat gjithashtu janë të kategorizuara. Gjithsej janë 1,303 kërkesa kreditore.

Dy nga 1,303 kërkesat janë kërkesa grupore, prej të cilave: njëra e Trepçës - me 10,067 kërkesa, dhe tjetra e Interlex Associates (kërkesa të punëtorëve të Trepçës) me 3,464 kërkesa.

Gjegjësisht flitet për gjithsej 14,832 kërkesa individuale përbrenda këtyre 2 kërkesave grupore.

NjRT ka bërë regjistrimin në listë, skanimin dhe fajlimin nëpër folderë elektronik dhe fajlimin fizik nëpër folderë të shtypur (hard copy), të të gjitha kërkesave të lartëpërmendura.

NjRT ka propozuar dhe kërkuar formimin e Grupit punues/Komisionit për shqyrtimin dhe kalkulimin e kërkesave Kreditore. Mundësia për këtë është konfirmuar edhe nga Dep. Ligjor i AKP. NjRT ka rekomanduar që shqyrtimi i kërksave duhet të fillojë sa më parë me kapacitete të AKP-së. Rezultati i këtij Komisioni do të ishte përgatitja e raportit individual për secilën kërkesë, dhe raportit final që do ti dërgohet Dhomës së Posaçme, dhe do të jetë bazë për mbajtjen e takimit të parë të kreditorëve.

- NjRT ka hulumtuar çështjen e grumbullimit të elaborateve të rezervave të Trepçës. Konstatimi është se çështja e vlerësimit të rezervave është operacion i cili mund të realizohet nga Administratori në bashkëpunim me Trepçën dhe me përkrahje të ekspertëve lokal duke u mbështetur në elaboratet shkencore të pranuara nga ish organet shtetërore deri në vitin 89, dhe plotësimi i tyre nga shërbimi gjeologjik i Trepçës në mënyrë të dokumentuar.

Nëse është nevoja për vlerësim të rezervave sipas standardeve ndërkombëtarisht të njohura si ato kanadeze dhe/ose Australiane, atëherë do të angazhohen vlerësues të certifikuar sipas këtyre standardeve (Vlerësues të jashtëm, pasi që Trepça nuk ka vlerësues të certifikuar të tillë) për të konfirmuar dhe konvertuar vlerësimin e Trepçës sipas standardeve ndërkombëtare.

NjRT ka mbajtur takime me Menaxhmentet e Trupat profesionale të gjeologëve në veri dhe jug.

Menaxhmenti i Trepçës Jug ka formuar Komisionin e veçantë për verifikim të rezervave me elaborate të vërtetuara dhe të dokumentuara sipas standardeve të ish - Jugosllavisë. Raporti për Rezervat e pjesës qendrore dhe jugore të Brezit të Trepçës pritet të përfundohet në Nëntor 2014.

Përderisa, Menaxhmenti i Trepçës veri, edhe pse është zotuar për themelimin e Komisioneve Profesionale të Gjeologëve për verifikim të rezervave, nuk e ka realizuar ende nismën e tillë.

- Është kruciale që Plani i Riorganizimit të ketë të dhëna të sakta në mënyrë që të sigurohen informata cilësore për vendimmarrje strategjike. Andaj, regjistrimi i aseteve dhe aspekti i paraqitjes së drejtë dhe gjithëpërfshirëse në Pasqyrat Financiare është i rëndësisë së veçantë.

Pasqyrimi i drejt i pasurisë së Ndërmarrjes, jo vetëm në aspektin e përcaktimit të vlerës aseteve, por edhe në aspektin e vlerësimit të përdorshmërisë aktuale apo funksionalizimit potencial në të ardhmen të këtyre aseteve do të garantonte baza të mira për përgatitjen e Planit të Riorganiz.

Ajo që është bërë gjatë periudhës raportuese është se me udhëzim të NjRT, Menaxhmenti Mitrovicë ka përditësuar regjistrin e aseteve, dhe posedon vlerën e aseteve me vlera kontabël.

Aktualisht, NjRT është angazhuar në zgjidhjen e problemit për vlerësim edhe të aseteve të vjetra që nuk kanë vlera kontabël (asete historike).

NjRT në bashkëpunim me Trepçën – Menaxhmentin në Mitrovicë ka formuar grupet punuese për vlerësim të këtyre aseteve të vjetra, të cilat aktualisht kanë filluar.

Në këtë mënyrë përmbushet parakushti që për këtë kategori të aseteve Ndërmarrja të posedoj dokumentacion adekuat për trajtim në kontabilitet.

NjRT ka iniciuar takime me menaxhmentin Zveqan ku menaxhmenti është për bashkëpunim sipas udhëzimeve të NjRT dhe sipas metodologjisë së punës që është realizuar nën menaxhim të Menaxhmentit Mitrovicë. Por NjRT nuk është në dijeni dhe ende nuk ka pranuar raport për sa i përket fillimit të punës së komisioneve për përditësim të regjistrit të aseteve.

Në takimet e zhvilluara Menaxhmenti Zveqan ka informuar se posedon regjistrin e aseteve të “reja” të përditësuar, mirëpo nuk ka bërë ende regjistrimin e aseteve “historike” të cilat janë pa vlerë kontabël.

2. Monitorimi i Trepçës

NjRT, përveç punëve në planin e riorganizimit të ndërmarrjes gjatë periudhës raportuese ka bërë mbikëqyrjen e punëve të përditshme në Trepçë duke shfrytëzuar kapacitetin e plotë që ka duke marr parasysh numrin e vogël të stafit të angazhuar në NjRT (gjithsej katër zyrtarë) dhe nga ana tjetër kërkesat e shumta për mbikëqyrje në Trepçë me specifika teknike të veçanta në fusha të ndryshme, që kërkojnë angazhim të shtuar.

Për këtë mbikëqyrje NjRT raporton rregullisht Menaxhmentit dhe ka përcaktuar edhe mënyrat e komunikimit dhe raportimit ndërmjet AKP-së dhe Menaxhmentit të Trepçës.

Mbikëqyren shumë procese, por do të ndajmë ato më të rëndësishmet:

Mbikëqyrja e procedurave të shitjes së Koncentratit të Trepçës

Mbikëqyrja e procedurave të prokurimit që tejkalon vlerën 10,000 Euro

Asistimi i Trepçës dhe angazhimi në kontestet Gjyqësore të saj

Mbikqyrja e afarizmit - në përgjithësi - të ndërmarrjes, përfshirë këtu:

- përkujdesin për rritje të prodhimit, rritje të të hyrave nga shërbimet, qiratë, etj;
- Përkujdesja për zvogëlim të të dalurave /ulje të kostos;
- Sigurimi i takimeve dhe asistimi i takimeve me palët e treta, kontraktorët, etj;
- Themelimi dhe pjesëmarrja në Komisione me interes të veçantë, si Komisioni për definim dhe hartim të listës së Pronave të paluajtshme të Trepçës dhe komisione ad hoc për çështje specifike

Në mënyrë që të ilustrojmë aktivitetin primar të Trepçës - e që është nxjerrja dhe përpunimi i xehes, më poshtë mund të shihet raporti i prodhimit për periudhën raportuese nëntëmujore 1 janar - 30 shtator, 2014 të cilin e kanë raportuar Menaxhmenti Mitrovicë dhe Menaxhmenti Zveqa i "Trepca – Ndërmarrje në Administrim të AKP"

Prodhimi i realizuar në minierën Stantërg dhe Artanë me flotacione Tuneli Parë dhe Kizhinicë:

Gjatë kësaj periudhe është realizuar eksploatimin i 152,683.90 tonë xehe të Plumbit dhe Zinkut (Pb dhe Zn) nga dy minierat, që ka rezultuar me prodhim të 11,244.4 ton koncentrati Pb dhe Zn ne Flotacionet Tunel i Parë dhe Kizhnicë prej të cilave 5,702.3 ton konc. Pb dhe 7,139.1 konc. Zn.

Kjo sasi e prodhuar e koncentratit për këtë periudhë, tejkalon për 18.29% prodhimin e vitit të kaluar 2013 për të njëjtën periudhë kohore.

Prodhimi i koncentratit në "Trepcë" Janar - Shtator të viteve paraprake dhe vitit aktual					
PËRSHKRIMI	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**
Koncentrat Pb në (t)	3,690.40	3,279.47	4,823.67	5,166.00	**5,702.30**
Koncentrat Zn në (t)	5,401.12	3,925.57	6,071.20	5,690.00	**7,139.10**
Gjithsejt Koncentrat Pb dhe Zn	9,091.52	7,205.04	10,894.87	10,856.00	**12,841.40**
Dallimi në % me vitin paraprak	-	-20.75%	51.21%	-0.36%	**18.29%**

Prodhimi i realizuar në minierën Belo Bërdo dhe Cërnac me flotacionin në Leposaviq:

Për periudhën 1 janar deri më 30 shtator 2014, për minieren e Cernacit dhe Belo Bërdos, Menaxhmenti Zveqan ka raportuar eksploatimin e 45,629 ton xehe të Plumbit dhe Zinkut (Pb dhe Zn), prej te cilave janë realizuar 4,764 ton koncentrat në Flotacionin në Leposaviq, prej të cilave 2,731 ton koncentrat Pb dhe 2,030 koncentrat Zn.

3. Urë ndërmjetësuese ndërmjet Dhomës së Posaçme, AKP-së dhe Trepçës

NjRT gjatë periudhës raportuese ka dorëzuar raportet e rregullta tremujore në DhPGjS, si dhe të gjitha kërkesat, udhëzimet për veprim, dhe komunikimin e natyrave tjera, të dorëzuara në DhPGjS, të cilat janë iniciuar dhe proceduar nga NjRT, dhe të cilat janë realizuar në bashkëpunim me Trepçën dhe Departamentet gjegjëse të AKP-së.

4. Aktivitetet e veçuara gjatë Periudhës Raportuese

Gjatë periudhës raportuese janar-shtator 2014, janë zhvilluar edhe shumë ngjarje të tjera të cilat nuk janë cekur më lartë, në të cilat NjRT ka qenë e involvuar, dhe prej të cilave veçojmë:

- NjRT ka qenë e angazhuar në takime të grupit punues për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, si dhe në takim të Komisionit Parlamentar për të dhënë asistencë dhe shpjegime për çështjen në fjalë.
- Në shkurt 2014 është bërë pranim-dorëzimi i detyrës së Menaxherit në Trepça me seli Mitrovice, me ç'rast i emëruari nga BiD AKP, Prof Dr. Ahmet Tmava morri pozitën e Menaxherit të ndërmarrjes, pas procesit të rekrutimit sipas procedurave të parapara ligjore.
- Pas një periudhe katërvjeçare, Trepça Veri, sivjet ka pranuar subvencionet nga buxheti i Republikës së Kosovës. NjRT në koordinim me Njësinë Veri ka përgatitur dokumentacionin për hapjen e xhirollogarisë në të cilën Trepça Veri do të pranojë mjetet e subvencionit nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.
- NjRT/AKP dhe Trepça Jug kanë formuar Komision të përbashkët me detyrë të auditimit të përgjithshëm në të gjitha njësitë e Trepçës për procedurat operacionale të zhvilluara deri tani. Të gjeturat e këtij Komisioni janë të përmbledhura në Raportin përfundimtar.
- Me datë 30 mars, 2014, Njësia e Krimeve Ekonomike dhe Antikorrupcionit - Rajoni Mitrovicë (NjHRKEK), ka sekuestruar 17,428 kg të Plumbit të rafinuar nen dyshimin të bazuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare nga ana e zyrtarëve të Trepça Veri. NjHRKEK i ka dorezuar AKP-së katër kontrata që kanë të bëjnë me Plumbin e sekuestruar të Trepçës. NjRT AKP, pas shqyrtimit te këtyre kontratave si bazë për transformim të pronësisë se asetit, dhe bazës ligjore, ka konstatuar se këto kontrata janë nënshkruar nga ndërmarrja në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, duke inicuar procedurë në DhPGjS për të konstatuar Ligjshmërinë e aktit.
- Me datë 10 prill, në Seancën e Kuvendit të Kosovës, me 45 vota për, 10 kundër dhe 6 abstenime është miratuar në shqyrtim të parë Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrje Publike. Me 16 prill, Komisioni Parlamentar për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, organizoi Dëgjim Publik lidhur me Projektligjin Nr.04/L-270 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe me kete rast e ftoi edhe AKP-në (NjRT).

VII. DEPARTAMENTI I KOORDIMINIT RAJONAL

Departamenti i Koordinimit Rajonal bën mbikëqyrjen e punës së Zyrave Rajonale të AKP-së. AKP-ja ka pesë Zyra Rajonale (ZR) në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë që përfshin të gjithë territorin e Kosovës dhe tri zyra satelitore në Leposaviq, Shtërpce dhe Graçanicë të cilat përgjegjësi kryesore kanë grumbullimin e informative lidhur me NSh-të në rajonet përkatëse si dhe implementimin e privatizimit, likuidimit dhe aktivitetet e qeverisjes korporative.

Mandati i ZR është zbatimi i funksioneve administrative të AKP-së lidhur me NSh-të për të siguruar që AKP-ja në mënyrë të duhur kryen obligimet e veta. ZR janë përgjegjëse për të gjitha detyrat të cilat AKP-ja ka nevojë t'i zbatoj për të siguruar realizim të suksesshëm të mandatit të vet që nuk janë rezervuar në mënyrë ekskluzive nga zyra qendrore e AKP-së apo caktuara njësive tjera funksionale të AKP-së.

Departamenti i Koordinimit Rajonal përmes pesë zyrave të saja rajonale dhe tri zyrave satelitore, gjatë kësaj periudhe ndër të tjera ishin përgjegjëse për:

- Përgatitjen e Ndërmarrjeve të Reja dhe aseteve sipas Planit të Punës;
- Grumbullimin e shënimeve relevante për NSh-të dhe arkivimin dhe ruajtjen e tyre;
- Ndërlidhjen në mes komunave, organizatave, agjencive dhe bashkëbisedues tjerë mbi çështje që kanë të bëjnë me AKP-në;
- Çështjet financiare; monitorimi i rregullt dhe kontrolli i pasqyrave financiare të NSH-ve aktive;
- Çështjet ligjore: monitorimi i rregullt, ndihma dhe paraqitja ligjore e NSH-ve në gjykatat e rregullta kurdo që kërkohet;
- Çështjet kadastrale: Hetimi dhe plotësimi i të gjitha çështjeve ligjore të kërkuara Kadastrale të pazgjidhura dhe ngritja e kooperimit me Zyrat Kadastrale Komunale;

Zyret rajonale kanë vazhduar me takime të ndryshme me menaxhmente të NSH-ve, zyrtar komunal, palë të ndryshme, vizita në teren si dhe seanca të ndryshme në gjykata komunale dhe gjykata tjera etj.

Privatizimi

Sipas Planit të Punës 2013 – 2015 nuk ishte parapare që të përgatiten Valë të privatizimit mirëpo Zyret Rajonale kanë përgatitur dhe tenderuar Valën 60 ku kanë përfshirë gjithsej tetë (8) Ndërmarrje të Reja me Spin Of të Rregullt dhe ka pranuar edhe ofertat për Ndërmarrjet e Reja në privatizim dhe për Asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim (SHAL 26). Fatkeqësisht hapja e ofertave u ndalua dhunshëm me pretendime të paqëndrueshme dhe të pabazuara lidhur me një aset të vetëm.

Per shkak se për Ndermarrjet e përfëshira në Valën 60 Bordi i Drejtorëve ka marr vendim ti nënshtroheshin procesit të Likuidimit, andaj Vala 60 nuk u persërit dhe ndërmarrjet që ishin paraparë në këtë Valë janë përgatitur për shitje përmes likuidimit.

Likuidimi

Gjatë këtij viti zyret rajonale kanë përgatitur 122 Bord Brief për NSH-të e reja për futjen e tyre në procesin e likuidimit.

Zyrtarët e rastit kanë vazhduar punën me përgatitjen e vendimeve të lëshuara nga AL, regjistrimin e kërkesave të reja ne databazë, verifikimin e të gjitha kërkesave të regjistruara në databazë, skanimet e tyre, rregullimet e arkivave si dhe insertimin e dokumentet në databazë, përgatitjen e njoftimeve për kreditorët e njohur në momentin e futjeve të Ndërmarrjeve në likuidim.

Zyrat Rajonale kanë përgatitur tërë dokumentacionin për tri (3) valë të shitjes së aseteve me likuidim të cilat përmbanin 166 asete. Këto Valë të likuidimit përmbanin 166 Dokumente me të Dhëna mbi Ndërmarrjet, Memorandume Informimi për Shitjen e Aseteve me Likuidim (MIShAL), Dhomën e të Dhënave dhe CLOR.

Shqetësimet / problemet me të cilat është ballafaquar ZR gjatë periudhës raportuese

Zyrat Rajonale janë ballafaquar me disa çështje dhe probleme gjatë procesit. Disa nga çështjet ishin:

- Mungesa e dokumenteve të pronësisë dhe dokumenteve tjera të rëndësishme, të cilat vështirësonin përcaktimin e statusit të ndërmarrjes. Ky është një hap i rëndësishëm në procedurën e shitjeve të aseteve;
- Sfidë kryesore për zyret rajonale mbetet mungesa e dokumentacionit të pronësisë si dhe të dhënat e vjetruara kadastrale të pronësisë në raste kur NSH-ja posedon të dhëna të gabuara sa i përket pronësisë të aseteve të caktuara. Zyrat Komunale Kadastrale në shumë raste nuk janë shumë bashkëpunuese dhe vazhdimisht refuzojnë të azhurnojnë të dhënat kadastrale. Kjo drejtpërdrejtë ndikon në përgatitjen e aseteve për shitje;
- Ndërrimi i titullarit të pronave shoqërore – prona të cilat janë nën mandatin a AKP-së;
- Mungesa e bashkëpunimit me komunat në veri të Kosovës. Kjo drejtpërdrejtë ndikon në procesin e privatizimit dhe likuidimit pasi që aty ekziston një numër prej 29 i NSh-ve (8 prej tyre është duke u shqyrtuar statusi i tyre);

VIII. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT

Departamenti i Financave dhe Buxhetit në kuadër të Agjencisë mbulon dy aktivitete të menaxhimit financiar:

1. Buxheti i Agjencisë -aktivitetet administrative dhe operacionale të Agjencisë apo të tjera; dhe
2. Fondeve në mirëbesim të Ndërmarrjeve Shoqërore

1. AKTIVITETET NGA BUXHETI I AGJENCISË

1.1 PASQYRAT FINANCIARE

- Pasqyrat financiare të të Hyrave të Dedikuara, Grantit të përgjithshëm qeveritar dhe fondeve të donatorëve për vitin fiskal 2013 janë përgatitur dhe janë dorëzuar me 24 Janar 2014 në Ministrinë e Financave;
- Pasqyrat financiare 9 mujore sipas rregullores nr. 06/2011 për të Hyrat e Dedikuara, buxhetit të Kosovës fondeve të donatorëve për periudhën Janar – Shtator 2014 janë përgaditur dhe do të dorëzohen më brenda afatit ligjor në Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave; dhe
- Raportimi për pasqyrat financiare për Buxhetin e Kosovës për vitin 2013 në Komisionin për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Republikës së Kosovës

1.2 BUXHETI

Burim kryesor i financimit për buxhetin e Agjencisëë janë të **Hyrat e Dedikuara** që mbulon aktivitetet direkte administrative dhe operative të saj. Mirëpo, duke filluar nga viti 2014, Agjencia, përveç të hyrave të dedikuara, ka pasur financim të tjera të tilla si **Fondi i Përgjithshëm Qeveritar**.

Të hyrat e dedikuara të Agjencisë

Shpenzimet administrative apo operative që kanë të bëjnë me aktivitetet direkte të Agjencisë mbulohen nga të hyrat e dedikuara të Agjencisë. Sipas nenit 21 të ligjit nr. 04/L-034, të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFPP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuara si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimete veta të përgjithshme administrative dhe operative.

Fondi i Përgjithshëm Qeveritar

Fondi i përgjithshëm Qeveritar apo Granti Qeveritar janë burim i financimit për të mbuluar aktivitetet që nuk ndërlidhen në menyrë direkte për Agjencinë, por janë për mbulimin e shpenzimeve që Agjencia administron e që kanë të bëjnë me riorganizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore e në këtë rast është vetëm Riorganizimi i NSh Trepça. Fondi i përgjithshëm qeveritar është fondi kryesor i Republikës së Kosovës për financimin e buxheteve të organizatave buxhetore.

Departamenti i Financave dhe Buxhetit gjatë kësaj periudhe sa i përket buxhetit ka përshirë aktivitetet e mëposhtme:

- Monitorimi i përformancës së buxhetit 2014;
- Korniza afatmesme e shpenzimeve 2015 - 2017; dhe
- Përgatitja e buxhetit për vitin 2015

1.2.1. Përformanca e Buxhetit të vitit 2014.

Burim i financimit për Buxhetin 2014 të Agjencisë (i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës) gjatë kësaj periudhe e deri në përfundim të vitit fiskal 2014 janë të hyrat e dedikuara dhe fondi i përgjithshëm qeveritar.

Gjatë periudhës Janar – Shtator 2014 kanë ndodhur këto aktivitete dhe atë si më poshtë:

- **Reduktimi i Alokimeve sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 07/172**

Qeveria e Kosovës me datën 27 Shkurt 2014 ka marrë vendim për kursimin 15% të shpenzimeve në kategorinë Mallra dhe Shërbime dhe Komunali për të gjitha Organizatat buxhetore për vitin 2014.

Duke iu referuar Vendimit të Qeverisë Nr. 07/172 të datës 27.02.2014, si dhe kërkesës së Ministrisë së Financave lidhur paraqitjen e kursimeve të identifikuara sipas programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike për vitin 2014, AKP me datën 14 Mars 2014 përmes shkresës zyrtare ka njoftuar MF dhe ka paraqitur vlerën e cila kursehet sipas programeve dhe burimit të financimit.

- Gjithsej kursimet e identifikuara brenda programeve të AKP-së janë 1,140,881€ .
- Kursimet nga të hyrat Qeveritare (kodi 10) janë 600,000.00€.
- Kursimet nga të hyrat e dedikuara (kodi 23) janë 540,881.00€.

Në muajin Tetor 2014, jemi njoftuar se nuk janë bërë shkurtimet për të hyrat e dedikuara sipas vendimit për reduktimin e alokimeve nr. 07/172.

- **Rishikimi i buxhetit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për vitin 2014**

Duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Financave lidhur rishikimin e buxhetit për vitin 2014, AKP me datën 10 Korrik 2014 përmes shkresës zyrtare ka njoftuar MF dhe ka paraqitur kursimet si dhe nevojat shtesë si më poshtë:

Gjithsej shuma e kursimeve të paraqitura për vitin 2014 është €3,662,500.00.

- Kursimet nga të hyrat e dedikuara (kodi 23)gjithsej €268,000.00 për mallra dhe shërbime si dhe €42,100.00 për Shpenzime Kapitale.
- Kursimet nga buxheti i Kosovës (kodi 10) gjithsej €3,352,400.00 për mallra dhe shërbime.
- Transfer nga programi i Likuidimit në programin e Administratës Qendrore (kodi 229)në kategorinë Mallra dhe Shërbime në shumë prej 72,000.00€.
- Mjete shtesë nga buxheti i Kosovës (kodi 10) kemi kërkuar për programin e Likuidimit në shumë prej 5,000,000.00€.

Rishikimi i buxhetit ende nuk është aprovuar nga Ministria e Financave për shkak se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e ka miratuar ende.

Për buxhetin 2014, gjatë gjithë kohës është raportuar përformanca e shpenzimeve kundrejt buxhetit me Drejtorët e Departamenteve dhe Kryesuesve të Njësive. Gjithashtu kohë pas kohe janë diskutuar objektivat në realizimin e buxhetit sipas planifikimeve.

Buxheti deri më datën 30 Shtator 2014 prej 10,745,873 është shpenzuar gjithsej EUR 4,337,213.50 ose 38.23%, e që përshinë buxhetin nga fondi i përgjithshëm qeveritar ndërsa buxheti i të hyrave të dedikuara prej EUR 7,345,873 është shpenzuar gjithsej EUR 4,317,352.50 ose 59%.

1.2.2 Korniza afatmesme e shpenzimeve

Sipas kërkesës së Ministrisë së Financave lidhur përgatitjen e Kornizës Afat-Mesme të Shpenzimeve (KASH), AKP datën 27 Mars 2014 ka përgatitur dhe dorëzuar në MF përmbledhjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të AKP-së për vitet 2015-2017 si më poshtë:

VITI	2015	2016	2017
Gjithsej	**11,647,859**	**6,412,187**	**5,120,597**
Te hyrat vetanake	7,647,859	6,392,187	5,100,597
Te hyrat Qeveritare	4,000,000	20,000	20,000

1.2.3 Buxheti i vitit 2015

Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka udhëhequr dhe koordinuar punën në mes të Departamenteve dhe Njësive në planifikimin e buxhetit për vitin 2015 dhe si i tillë është aprovuar nga bordi i drejtorëve në mbledhjen e muajit Korrik 2014.

Për të identifikuar sa më mirë kërkesat buxhetore për vitin 2015 të programeve të AKP-së, Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka organizuar dëgjime buxhetore me Mbajtësit e Buxhetit/Udhëheqësit e Departamenteve për të gjitha programet buxhetore, me ç'rast është analizuar secila linjë buxhetore e vitit 2015 si dhe parashikimet e hershme për vitet 2016-2017.

Sipas kërkesave të mbajtësve të buxhetit (Kryesues të Njësive dhe Drejtorët të Departamenteve) si dhe Protokoleve të dëgjimeve buxhetore të mbajtura me 03 dhe 4 Qershor 2014 me mbajtësit e buxhetit brenda AKP-së lidhur me kërkesën buxhetore për vitin 2015, Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka përgatitur kërkesën buxhetore për vitin 2015 me parashikimet e hershme për vitet 2016-2017.

Gjithsej buxheti(sipas kërkesës së tretë buxhetore) për vitin 2015 është EUR 16,080,964 dhe atë si më poshtë:

	KËRKESA BRENDA KUFIJVE BUXHETOR TË PËRCAKTUAR NË QARKOREN E TRETË BUXHETORE 2015/3		**KËRKESA SHTESË MBI KUFIJTË BUXHETOR TË PËRCAKTUAR NË QARKOREN E TRETË BUXHETORE 2015/3**		
	AKTIVITET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE	PLANI I RIORGANIZIMIT TË TREPÇËS	OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONAL PËR LIKUIDIMIN E NSH-ve	PAGA DHE MEDITJE	
BURIMI I FINANCIMIT	FINANCOHET NGA BUXHETI VJETOR I AKP-së **KODI 23**	FINANCOHET NGA **KODI 10** (BUXHETI I KOSOVES)	FINANCOHET NGA **KODI 10** (BUXHETI I KOSOVES)	FINANCOHET NGA BUXHETI VJETOR I AKP-së **KODI 23**	**GJITHSEJ**
GJITHSEJ	**6,164,131.00**	**3,400,000.00**	**5,000,000.00**	**1,516,833.00**	**16,080,964.00**
Paga dhe meditje	3,286,391.00	-		1,516,833.00	4,803,224.00
Mallra dhe sherbime	2,619,740.00	3,400,000.00	5,000,000.00		11,019,740.00
Shpenzimet komunale	98,000.00	-			98,000.00
Subvencione dhe transfere	80,000.00	-			80,000.00
Investimet kapitale	80,000.00	-			80,000.00

1.3 PROCESIMI I PAGESAVE

- Procesimi i 2,140 transaksioneve (884 zotime dhe 1256 pagesa) nga buxhetit vjetor i Kosovës e cila financohet nga të hyrave të dedikuara të Agjencisë dhe fondit të përgjithshëm të Qeverisë (Trepça)

1.4 RAPORTIMET

- Harmonizimi i raporteve dhe raportimi në baza mujore i raporteve financiare për pasyrat financiare 2014 ndaj
  - Departamentit të thesarit të Ministrisë së Financave;
  - Menaxhmentit dhe mbajtësve të Buxhetit;
  - Palëve të treta nëpërmjet publikimit të tyre në uebfaqen zyrtare të Agjencisë në gjuhën shqip, serbisht dhe anglisht
- Raportimet mujore në Ministrinë e Financave për faturat e papaguara;
- Raporti i blerjeve mbi EUR 500 për vitin 2013 ndaj Administratës Tatimore të Kosovës;
- Raportime të tjera sipas kërkesave nga palët me interes

1.5 AKTIVITETET TJERA

- Harmonizimi mujor i listës së pagave për periudhën Janar – Shtator 2014 me Ministrinë e Administratës Publike;
- Inkasimet ditore për telefoninë fikse dhe mobile. Këto inkasime janë për shpenzimet që kanë tejkaluar limitet të cilat i mbulon Agjencia sipas politikave për telefoni fikse dhe mobile. Vlen të theksohet se pas propozimit nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit është marrë vendim nga Menaxhmenti për ndalesë në 50% të pagës bruto për obligimet e papaguara deri në periudhën 30 Prill 2014;
- Është mbajtur trajnimi për dy punonjës të Departamentit të Financave dhe Buxhetit në trajnimin e organizuar nga AUK me temën "Udhëheqja dhe Menaxhimi i Cikleve të Projektit;
- Takime me Administratën Tatimore të Kosovës në lidhje me tatimin në burim për qiranë. Jemi në proces të harmonizimit me ATK-në në lidhje me këto obligime. Është vërtetuar si ATK nuk i ka të gjitha pagesat e azhurnuar të Agjencisë (një problem i identifikuar për të gjitha organizatat buxhetore). Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka shprehur gatishmërinë për t'i dërguar kopjet e pagesave (edhe pse janë dërguar më parë) në menyrë që të plotësohen të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës. Gjatë kësaj periudhe janë dorëzuar kopjet e pagesave për vitin 2013 dhe periudhën Janar – Maj 2014;
- Më datën 8 Maj janë caktuar dy ushtrues të detyrës për pozitën Drejtor i Departamentit të Financave dhe Buxhetit dhe Kryesues i Njësisë për Menaxhimin e Fondeve. Kjo për shkak të plotësimit të pozitës së Drejtorit në Departamentin e Financave dhe Buxhetit, pasi që është caktuar

ushtrues i detyrës të Zëvendës Drejtorit Menaxhues – Likuidimi. Ushtruesit e Detyrës në Departamentin e Financave dhe Buxhetit janë:

- Adem Selishta – u.d Drejtor i Departamentit të Financave dhe Buxhetit (paraprakisht Kryesues i Njësisë për Menaxhimin e Fondeve); dhe
- Korab Lufi – u.d Kryesues i Njësisë për Menaxhimin e Fondeve (paraprakisht Zyrtar i Kontabilitetit dhe Fondeve)

1.6 PASURITË

Pasuritë e Agjencisë të blera nga fondet e buxhetit dhe pasuritë e dhëna donacion janë mbajtur në përputhje me Rregullorën nr. 02/2013 të Ministrisë së Financave. Detaje lidhur me pasuritë janë shpalosur në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese.

1.7 AUDITIMET

- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dorëzuar raportin e auditorit për Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2013 për buxhetin vjetor. ZAP-i ka dhënë opinion të modifikuar lidhur me çështjen e pagesave për Autoritetin e likuidimit. Agjencia ka paraqitur me shkrim ZAP-it argumentet dhe mospajtimet lidhur me këtë opinion.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm të AKP-së (NJAB) ka filluar auditimin e Departamentit të Financave dhe Buxhetit për periudhën Shtator 2013 - Tetor 2014. Raporti Final pritet të dorëzohet pas përfundimit të auditimit, përderisa është përpiluar Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së;

2. FONDET NË MIRËBESIM

2.1 PASQYRAT FINANCIARE

- Pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim për vitin fiskal 2013 janë përgatitur dhe janë dorëzuar më 22 Janar 2014 në Sekretariatin e Bordit të Drejtorëve dhe më 24 Janar 2014 janë dorëzuar në Ministrinë e Financave;
- Pasqyrat financiare 9 mujore për Fondet në Mirëbesim për periudhën Janar – Shtator 2014 janë përgaditur dhe do të dorëzohen më brenda afatit ligjor në Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave;

2.2 BUXHETI

Buxhet për Fondet në mirëbesim është për ndërmarrjet shoqërore të cilat hyjnë në likuidim. Janë gjithsej 461 Ndërmarrje Shoqërore të cilat kanë hyrë në likuidim. Buxheti përfshinë periudhën që nga hyrja e Ndërmarrjes në likuidim e deri në përfundim të saj.

Përgatitja e buxhetit të fondeve në mirëbesim për NSh-të në likuidim është jashtë kompetencave të Departamentit të Financave dhe Buxhetit, por që ka filluar të jetë pjesë e procesit të monitorimit dhe kontrollës që nga mbledhja e muajit Gusht 2014 të bordit të drejtorëve, kjo sipas kërkesave të ZDM – Likuidimi në menyrë që të rritet cilësia, plotësia dhe zvoglimi i rrezikut të tejkalimit të buxhetit .

2.3 PROCESIMI I PAGESAVE

- Procesimi i 5,078 transakcioneve dalëse të fondeve në mirëbesim në BQK dhe harmonizimi i 11,803 transaksioneve (hyrëse dhe dalëse) nga fondet në mirëbesim.

2.4 RAPORTIMET

- Harmonizimi me Bankën Qendrore të Kosovës dhe raportimet në baza mujore të raporteve për pasqyrat financiare për Fondet në Mirëbesim ndaj:
  - Menaxhmentit dhe Drejtorëve;
  - Zyrave Rajonale dhe Autoritetit të Likuidimit - Raporteve Përmbledhëse të Llogarive të Likuidimit dhe Kartelave bankare. Raportimi në baza mujore përfshinë periudhën Janar deri më 30 Shtator 2013. Raportet janë paraqitur dhe në uebfaqen e AKP-së (në gjuhën shqip, serbisht dhe anglisht); dhe
  - Palëve me interes përmes publikimit në uebfaqen zyrtare të Agjencisë në gjuhën: shqip, serbisht dhe anglisht

2.5 INVESTIMET E FONDEVE NË MIRËBESIM

Sa i përket investimeve të fondeve në mirëbesim, Agjencia Kosovare e Privatizimit është e orientuar në tregun e investimeve afatshkurtra siç janë depozitat deri në dymbëdhjetë muaj (12) në Bankën Qendrore të Kosovës dhe bankat komerciale të Kosovës dhe në letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës (bonot e thesarit).

2.5.1 Afatizimi i mjeteve në depozita kohor

Departamenti i Financave dhe Buxhetit gjatë gjithë kohës ka qenë aktive sa i përket afatizimit të mjeteve në depozita kohor. Gjatë periudhës Janar – Shtator 2014 janë realizuar gjithsej 6 afatizime në depozita kohor dhe atë

1. Tre depozita në depozita tremujor, gjithsej në shumën totale prej EUR 65,000,000.00 dhe se të gjitha kanë mataruar;

2. Dy depozita në depozita gjashtëmujor, gjithsej në shumën prej EUR 50,000,000.00, ka matuar një prej tyre; dhe
3. Një depozit në depozita dymbëdhjetëmujor, gjithsej në shumën totale prej 5,000,000.00 që maturon më 5 Korrik 2015.

Gjithsej Interesi i fituar është EUR 32,209.72 që përshinë interesin nga depozitat maturuar të shënuar më lartë prej EUR 20,343.06 dhe interesi prej EUR 11,866.67 nga depoziti i vitit paraprak më 23 Shtator 2013 që ka maturuar më 21 Mars 2014.

Nga viti 2010 duke i përshirë dhe depozitat që maturojnë më 31 Tetor 2014 dhe 5 Korrik 2015 (EUR 117,750.00) interesi i fituar nga pjesëmarrja në depozitat e afatizuara do të jetë gjithsej EUR 7,233,687.

Mjetet janë afatizuar në Bankën Qendrore dhe bankat komerciale të Kosovës, mirëpo vlen të theksohet se në këtë treg, kohëve të fundit norma e interesit vjetor ka qenë shumë e ulët. Oferta e fundit nga banka komerciale ka qenë në normën prej 0.10% ndërsa nga Banka Qendrore nuk kemi pasur ofertë kjo për arsyen se normat e interesit kanë qenë negative dhe atë deri në MINUS 20% (sipas njoftimit më datën 5 Shtator 2014).

Për më tepër janë të paraqitura në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

2.5.2 Investimi i letrave në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës (bonot e Thesarit) kohor

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e datës 21 Qershor 2012 ka marrë vendim që menaxhmentit t'i lejohet diskutimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Ministrinë e Financave dhe Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në menyrë që të mundësohet investimi i fondeve në mirëbesim në tregun primar dhe tregtimi në tregun sekondar të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria.

Nuk është bërë ende ndonjë investim ose pjesëmarrje në ofertim të letrave me vlerë të Qeverisë për shkak se nuk është përfunduar me sukses përpjekja e Agjencisë për këto investime për arsyet të cilat nuk i janë të njohura Agjencisë.

Në muajin Gusht 2014, është mbajtur takimi me Bankën Qendrore të Kosovës në lidhje me përmisimin e kushteve dhe krijimin e mundësive për të gjithë akterët e rëndësishëm të kapitalit në Kosovës. Iniciativ kjo e këshilltarit të Gurvenatorit të Bankës Qendrore të Kosovës. Krijimi i mundësi i përket asaj që të ndryshohen kushtet teknike dhe legjislative për pjesëmarrjen në këtë treg. Agjencia është konsideruar një akterë shumë i rëndësishëm për qarkullimin e kapitalit në tregun e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria. Pritet që të bëhet një grup punues i cili përshfinë dhe akterët të tjerë të tilla si Trusti Pensional i Kosovës. Agjencia ka shprehur gatishmërin që të jap kontributin e saj në menyrë që t'i krijohen dhe Agjencisë mundësitë për pjesëmarrje në këtë treg kjo sepse plotëson një nga objektivat themelore për rritjen e vlerës së NSh-ve.

2.6 AKTIVITETET TJERA

- Janë mbajtur takime me Administratën Tatimore të Kosovës në lidhje me barrën tatimore të vendosur në asetet e NSh-ve. Agjencia ka kërkuar që të dërgohen të dhënat sa i përket datave të vendosjes së barrës tatimore në menyrë që të përputhen me datat e vendosjesë së NSh-ve në

likuidim, mirëpo një gjë e tillë nuk është ofruar ende ndërsa sa i përket kërkesave të tjera të aprovuara të paraqitur si kreditor- ATK i NSh-ve, Agjencia ka sqaruar se në mungesë të kuorumit të tre drejtorëve ndërkombëtarë nuk mund të realizohen këto pagesa. Kjo sipas nenit 14, paragrafi 7 dhe nenit 15 paragrafi 2.7 e që ka rezultuar në mos realizimin e pagesave për të gjithë kërkesat e pranuara të kreditorëve. Gjithashtu një problem i tillë është diskutuar dhe me institucionet tjera të tilla: Komuna e Prishtinës (tatimi në pronë), Ujësjellsi – KUR Prishtina apo palëve të tjera të ndërlidhura me këto kërkesa.

- Gjatë periudhës raportuese Janar – Shtator 2014, AKP ka faturuar INA-në në periudha mujore për periudhën nga 20 Dhjetor 2013 e deri më 20 Korrik 2014 në shumën prej EUR 220,000.00. Faturimi është për qiranë mujore në shumën prej EUR 22,000.00 për shfrytëzimin e depove në Bardhosh. Shuma e pa paguar nga INA është EUR 22,000.00 për periudhën mujore 20 Qershor 2014 – 20 Korrik 2014 e faturuar më datën 17 Korrik 2014. Deri në periudhën raportuese, janë paguar tatimet prej EUR 15,840.00 në Administratën Tatimore të Kosovës për të hyrat e realizuar nga qiraja në shumën prej EUR 176,000.00 e që përshfinë periudhën TM4 2013, TM1 dhe TM2 2014.

2.7 AUDITIMET

- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dorëzuar raportin e auditorit për Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2013 për fondet në mirëbesim. ZAP-i ka dhënë opinion të modifikuar lidhur me cështjen e pagesave për Autoritetin e Likuidimit. Agjencia ka paraqitur me shkrim ZAP-it argumentet dhe mospajtimet lidhur me këtë opinion.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm të AKP-së (NJAB) ka filluar auditimin e Departamentit të Financave dhe Buxhetit për periudhën Gusht 2013- Tetor 2014. Raporti Final do të dorëzohet pas përundimit të auditimit, përderisa është përpiluar Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së;

2.8 Pagesat ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e NSh-ve

Që nga Tetor i vitit 2012 kanë filluar pagesat ndaj “Deloitte” e cila e është kontraktuar për të ofruar shërbime profesionale si pjesë e Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Janë dy lloje të pagesave: fikse (kuartale) dhe variabile sipas vendimeve të shqyrtuara të kreditorëve.

2.8.1 Kostoja fikse:

Shuma totale e kostos fikse për pagesë ndaj “Deloitte” deri në përfundim të kontratës është EUR 4.9 milion. Kjo shumë do të paguhet nga secila NSh në likuidim sipas metodës fikse të përshkallëzuar e të aprovuar nga Komiteti Drejtues i Projektit për kontratën me OSHP-në për likuidimin e NSH-ve.

Gjithsej shuma e paguar deri në datën raportuese është EUR 2,947,221.60 dhe atë:

1) gjatë vitit 2012 shumën prej 1,228,009 (982,407.20 pagesë pas dorëzimit të raportit fillestar dhe për kuartalin e parë Shtator – Dhjetor 2012 janë paguar 245,601.80);
2) gjatë vitit 2013 shumën prej 1,228,009 për pesë kuartale (secili nga 245,601.80); dhe

3) gjatë vitit 2014 shumën prej 491,203.60 për dy kuartale (secila nga 245,601.80)

Fillmisht kostoja fikse paguhet nga llogaria e tarifës administrative së Agjencisë dhe më pastaj mjetet i kthehen tarifës administrative nga secila llogari e NSh-së në likuidim pas përcaktimit të numrit të kërkesave të kreditorëve dhe shumës së shitjeve për secilën ndërmarrje. Për të gjitha pagesat e realizuara nga llogaria e tarifës administrative, mjetet e kthyera në tarifën administrative nga llogaritë e NSh-ve në likuidim janë gjithsej EUR 285,250.

2.8.2 Kostoja variabile

Nga Marsi i vitit 2013, ofruesi i shërbimeve profesionale "Deloitte" e kontraktuar nga Agjencia ka shqyrtuar vlefshmërinë e kërkesave të kreditorëve dhe për të cilat deri në datën raportuese më 30 Shtator 2014 ka faturuar për 65,156 vendime (pranim/refuzim të kërkesave të kreditorëve) për të gjtha llojet e kërkesave të kreditorëve (sipas ligjit të AKP-së me nr. 04/L-034, neni 40). Shuma e paguar për shqyrtimin e këtyre kërkesave është gjithsej EUR 5,430,121.46 dhe atë:

1) Neni 40.1.5, kërkesa për pronësi të aseteve shumën prej EUR 131,799 për 551 vendime të marrra;
2) Neni 40.1.6.1 kërkesa për paga të pa paguara shumën prej EUR 3,336,458 për 42,133 vendime të marra;
3) Neni 40.1.6.2 kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës shumën prej EUR 1,210,651për 15,286 vendime të marra;
4) Neni 40.1.7 kërkesa të pasiguruara shumën prej EUR 478,764 për 6,047 vendime të marra; dhe
5) Neni 40.1.8 kërkesa e pronarëve apo aksionarëve shumën prej EUR 272,449 për 1,139 vendime të marra.

Vlerat e shënuara më sipër paraqesin vlerat e 80% e faturuar dhe paguar të shumave për vendimet sipas kontratës.

Sipas kontratës, së pari faturohet dhe paguhet vetëm 80% e shumës së kontraktuar dhe pjesa prej 20% paguhet pasi që të ketë kaluar afati kohor për ankesë në Dhomës e Posaçme të Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës. Për ato ankesa të cilat janë dorëzuar kërkesa brenda afatit kohor, 20% paguhet pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesës nga DhPGjSK.

2.9 DETAJE TJERA LIDHUR ME AKTIVITETET FINANCIARE TË AGJENCISË.

Detaje tjera lidhur me aktivitetet financiare të Agjencisë janë shpalosur në tabelat financiare dhe Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Buxhetit Vjetor dhe në tabelat financiare dhe Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim.

IX. DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor (tutje DL) ofron shërbime ligjore për aktivitetet e Agjencisë përfshirë privatizimin, likuidimin, prokurimin dhe rastet specifike të Trepçës.

Departamenti është ndarë në njësi punuese të organizimit, ndarjes së punëve dhe përgjegjësive me qëllim të realizimit në menyrë efikase dhe efektive në tërësi të objektivave dhe përgjegjësive të Departamentit Ligjor dhe të cilat janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e përgjithshme të AKP-së.

Në vijim janë sqaruar aktivitetet bazuar në sipas njësive në Departamentin Ligjor:

1. Njësia për Përfaqësime në Gjykatë(NjPGj).
2. Njësia për Opinione Ligjore(NjOL).
3. Njësia për Regjistrimin e Ankesave (NjRA).
4. Sekretariati i KSHALP-së: Për shqyrtimin e ankesave për 20 %.
5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KShALP).

Departamenti Ligjor shërben si ombrellë për Komisionin Shqyrtues për Ankesat e Listave të Punëtorëve (KShALP), megjithëse ky komision vepron në mënyrë autonome dhe i raporton vetëm Bordit të Drejtorëve të Agjencisë.

1. Njësia për Përfaqësime në Gjykatë (NjPGj)

Gjatë periudhës Janar – Shtator janë pranuar gjithsej 150 lëndë ndërsa për veprimet procedurale në lëndë për perudhën në fjalë Janë:

- *Mbrojtje në padi, gjithsej 141;*
- *Kundërpërgjigje, gjithsej 35;*
- *Përgjigje në masë të përkohshme, gjithsej 57;*
- *Ankesa, gjithsej 20;*
- *Përgjigje në ankesa, gjithsej 24;*
- *Parashtresë, gjithsej 33;*
- *Përgjigje në përgjigje; gjithsej 2;*
- *Padi, gjithsej 1;*
- *Seanca Gjyqësore, janë mbajtur 56; dhe*
- *Përgjitgje në urdhër, gjithsej 83;*

Sa i përket çështjeve lidhur me listat e punëtorëve, gjatë periudhës Janar – Shtator 2014 janë pranuar gjithsej 819 lëndë kurse veprimet e ndërmarra në lëndë për këtë periudhë janë si më poshtë:

- *Urdhra, gjithsej 119;*
- *Pjesëmarrje në seancë gjyqësore, gjithsej 17;*
- *Aktgjykim, gjithsej 96;*
- *Aktvendim, gjithsej 31;*
- *Ankesa kundër Aktgjykimeve, gjithsej 37;*
- *Përgjigje në ankesa janë gjithsej 473 nga 539 ankues; dhe*
- *Parashtresa, gjithsej 9*

2. Njësia për Opinione Ligjore(NjOL)

Njësia e Opinioneve Ligjore (NJOL) ka zhvilluar aktivitete të ndryshme, por që kryesisht konsistojnë në dhënien e mendimeve dhe këshillave ligjore, hartimin e dokumenteve juridike, rregullore apo akte tjera juridike, si dhe pjesëmarrjen në takimet e ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe raportuese NJOL ka kontribuar në përformancën e Agjencisë duke dhënë afërsisht 36 opinione ligjor sipas 'Kërkesave për Veprim' të njësive dhe departamenteve por edhe Menaxhmentit të Agjencisë.

Krahas opinioneve ligjore, sipas nevojës NJOL ka hartuar apo ka marrë pjesë në hartimin, shqyrtimi apo analizimin e mëse 38 dokumenteve të ndryshme, si rregullore të brendshme, vendime, kontrata, letër-përgjigje, kërkesa, etj.

Janë shqyrtuar në aspektin juridike afërsisht 41 Kërkesa për Përcaktimin e Statusit Juridik për ndërmarrjet shoqërore, si dhe janë realizuar një varg takimesh në të cilat është kërkuar pjesëmarrja e zyrtarëve ligjorë dhe konsulta ligjore.

3. Njësia për Regjistrimin e Ankesave (NjRA)

Gjatë këtij muaji në Njësinë për ankesa të Departamentit Ligjor janë regjistruar dhe proceduar gjithsejtë janë pranuar 3,538 parashtresa.

Nga numri i përgjithshëm i lartë cekur i kërkesave/shkresave të pranuara nga Njësia e Ankesave 3,538: prej tyre janë pranuar rreth 1.144 kërkesa/lëndë të reja dhe 2.394 dokumente/ parashtresa shtesë lidhur me lëndët e ekzistuese të cilat janë regjistruara me herët.

Aktivitete janë si në vijim:

- 84 Njoftime sipas nenit 29 dhe 30 të Ligjit të AKP-së;

- 1,923 Kërkesa lidhur me likuidimin ose ndaj NSH-ve në likuidim (përfshirë këtu lëndët të cilat punohen nga Njësia e Ankesave në Departamentin Ligjor, Autoritetet e Likuidimit tek ZR apo lidhur me kompaninë Deloittee, të cilat lëndë në ndonjë mënyra kanë kaluar përmes Njësisë së ankesave;
- 10,439 Kopje fizike të lëndëve të ndryshme janë radhitur sipas regjistrimit në sistemin elektronik;
- 1,051 parashtresa me kopje të mjaftueshme janë dorëzuar tek zyra e protokollit, për dërgim në gjykatë;
- 730 parashtresa janë dorëzuar tek Zyrtarët Kompetent për ndërmarrjen e veprime të më tejme;
- 7,346 Aktivitete tjera: si informata, sqarime dhe ndihmë e dhënë njësive dhe departamenteve tjera të Agjencisë;
- Po ashtu rreth 1,151 lende/ dokumente origjinale lidhur me NSH- të në likuidim janë dorëzuar tek Autoritetet e Likuidimit pranë Zyrave Rajonale;
- 5,400 parashtresa te ndryshme janë protokolluar në librin intern të protokollit të Njësisë për ankesa deri me datën 30.09.2014; si dhe
- Si dhe rreth 472 korrigjime dhe plotësime, ndryshime janë kryer në Bazën e të dhënave elektronike të Njësisë për ankesa sipas sugjerimeve të dhëna nga zyrtarët e Zyrës Rajonale të Prishtinës.

Select Date Logged Range: 1/1/2014 9/30/2014 Go

Drag a column header here to group by that column

#	Number of Claims	Claim Type
	6	A = Ownership of SOE
	178	B = Ownership of SOE asset
	266	Banesat
	83	D = Creditor (unsecured)-wages
	23	E = Creditor (unsecured)-other
	1	F = HPD - flats
	40	G = Other
	19	H = Rules of Tender
	528	I = Workers List
	Total Sum=1144	

4. Sekretariati I KSHALP-së Për Shqyrtimin e ankesave për 20%

Gjatë periudhës raportuese, Zyrtaret e Sekretariati të KSHALP-së kanë bërë shqyrtimin për përfshirje apo mospërfshirje të ankuesve në Listat Përfundimtare për 6 NSH-ve, varësisht nga kapaciteti i publikimit të Listave Fillestare nga Departamenti i Likuidimit, për këtë periudhë raportuese KSHALP ka rishqyrtuar 112 ankesa për 6 NSH.

Sekretariati i KSHALP ka përgatitur draft vendime për refuzimin e ankesave për 6 NSH. Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe seanca dëgjimore me menagjmentin e Ndërmarrjeve Shoqërore me arsyetim

rreth funksionimit të ndërmarrjeve para privatizimit dhe rreth përgatitjes se Listave Fillestare për 6 Ndërmarrje te shqyrtuara në këtë periudhë.

Punë shtesë e Sekretariatit të KSHALP-se gjatë kësaj periudhe:

- Angazhimet e Kryesueses me punë shtesë rreth SDR-ve të cilat janë në shqyrtim te Komisioni për KPS (SDR).
- Angazhimet e gjithë Stafit të Sekretariatit lidhur me harmonizimin e dosjeve elektronike dhe dosjeve fizike, si dhe plotësimi me dokumente relevante shtesë nga zyret rajonale për bazën e shënimeve.
- Dy zyrtarë të njësisë së KSHALP-së janë angazhuar me punë shtesë tek Njësia e Regjistrimit të Ankesave në AKP për të përfunduar verifikimin, kontrollimin dhe fajllimin e kërkesave të 2 ndërmarrjeve, te cilat kërkesa janë dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit. Gjithashtu është bërë edhe regjistrimi i kërkesave të ndryshme në bazën e shënimeve te Njësia e Ankesave ne periudhe angazhimi për 2 muaj.
- Përfundimi i skanimit, fotokopjimit dhe lidhja e librave amëz nga kontraktori, dhe dorëzimi i librave amëz të zyret rajonale.
- Komunikimi dhe asistimi i zyrave rajonale lidhur me nxjerrjen e shënimeve nga Librat amëz për lëshimin e vërtetimeve për punëtorët e ndërmarrjeve të ndryshme (Librat amëz janë grumbulluar përkohësisht nga Sekretariati deri në skanimin e tyre).
- Procedimi i propozimit mbi anulimin e 2 listave fillestare nga Komisioni.

5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KShALP)

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të punëtorëve (KSHALP) është themeluar me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë në Muajin Shtator 2011, në përputhje me nenin 10,pika 10.4 të Politikave Operuese, dhe është organ i pavarur, i brendshëm për shqyrtim administrativë, ndërsa kryesuesi dhe 2 anëtarët tjerë, njëri përfaqësues jo shqiptar është emëruar me vendimin e Bordit të Agjencisë.

KSHALP asistohet nga Sekretariati e cila është njësi e veçantë e Departamentit Ligjor dhe është i përbërë nga Koordinatori, Zyrtarët ligjor dhe administrativë të cilët janë përgjegjës për mbështetjet të KSHALP-së në ofrimin e asistencës së nevojshme në bashkëpunim dhe sipas udhëzimeve të Kryesuesit të KSHALP-së.

Varësisht kapacitetit të publikimit të listave fillestare nga Departamenti i Likuidimit, për këtë periudhë raportuese, KSHALP ka rishqyrtuar dhe vendosur lidhur me 112 ankesa për 6 ndërmarrje shoqërore si dhe janë mbajtur seanca dëgjimore me Menagjment të NSH-ve dhe sipas vlerësimit të KSHALP-së edhe me ankuesit-punëtorët e NSH-ve.

Po ashtu KSHALP-ja, gjatë kësaj periudhe ka rishqyrtuar propozim Vendimet për refuzimin e ankesave për 6 NSH, përfundimi i Vendimeve për anulimin e dy Listave fillestare të Punëtorëve si dhe ka mbajtur konsulta te vazhdueshme lidhur me NSH të ndryshme dhe Listës përfundimtare sipas kërkesave të palëve.

X. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Me qëllim të ofrimit te kushteve sa më të mira infrastrukturore dhe mundësimin e arritjes së objektivave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Departamenti i Administratës ka ndërmarrë shumë hapa të rëndësishëm dhe ka realizuar një punë voluminoze.

Në kuadër të Departamentit të Administratës bëjnë pjesë këto njësi/zyra:

1. Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme;
2. Njësia e Burimeve Njerëzore;
3. Njësia e Arkivit;
4. Njësia e Përkthimeve;
5. Njësia e Teknologjisë Informative;
6. Zyra e Protokollit; dhe
7. Transportit.

1. Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme

- Janë protokolluar 578 fatura të cilat janë përcjellë në Departamentin e Financave, prej tyre janë futur në "freebalanc"e 327 fatura;
- Kemi mbuluar 834 kërkesa për furnizim me material administrativ dhe higjienik;
- Me kërkesë të menaxhemntit ne kemi përgatitur nja raport mbi vlerësimin e gjendjes së sigurisë së objekteve sa i përket alarmeve kundër zjarrit dhe vëzhgimi me kamera të sigurisë në Zyrën qendrore dhe zyrat rajonale si dhe propozimet dhe kostot financiare për ngritjen e cilësisë së sigurisë raport i cili është vlerësuar nga Menaxhmenti, edhe pse gjatë muajit Shtator kemi pasur kërkesa dhe pyetje nga Menaxhmenti ende nuk kemi mundur të fillojmë me procedurat për inicimin e deklaratës për instalimin e sistemit të alarmeve kundër zjarrit si dhe ngritja e cilësisë së sistemit të kamerave dhe jemi në pritje të përgjigjes nga Departamenti i Financave;
- Me kërkesë të Menaxhmentit kemi bërë përpilimin e planit të emergjencave dhe të evakuimit dukë përfshirë skicimin e të gjitha zyrave të AKP-së si dhe i sallës së kuqe ku mbahen valët e privatizimit dhe shitja e asteve si dhe bashkërendimi për të siguruar numrat me Policinë e Kosovës, Emergjencës, zjarrfikësve si dhe numrat tjerë emergjent;
- Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi bërë të gjitha riparimet e kërkuara si në Zyrën qendrore po ashtu edhe në Zyrat Rajonale të AKP-së që në total të përafërt janë 480 riparime;
- Në bashkëpunim me departamentet tjera kemi iniciuar deklaratën për kontraktimin e kompanisë për shërbimet e sigurimit fizik për nevoja të AKP-së;

- Kemi iniciuar deklaratën për mirëmbajtje dhe furnizim me disa air kondicionerëve të rinj aty ku kemi nevojë, gjithashtu pas nënshkrimit të kontratës kemi servisuar të gjitha air kondicionerët në të gjitha zyrat e AKP-së;
- Kemi përpiluar listën dhe kemi bërë kërkesën për furnizim me pajisje sanitare dhe elektrike për nevoja të AKP-së për një periudhë një vjeçare, pas nënshkrimit të kontratës jemi furnizuar me pajisje sanitare dhe elektrike të mjaftueshme për të mirëmbajt ndërtesat e AKP-së për një periudhë përafërsisht një vjeçare;
- Me kërkesë të Menaxhmentit kemi përpiluar raportin dhe analizën ekonomike për bashkimin e Zyrës Rajonale me Selinë Qendrore të AKP-së, përparësitë dhe dobësitë;
- Në mënyrë që të kemi një menaxhim sa më të mirë të situatës për ngrohje të zyrave të AKP-së, kemi iniciuar deklaratën për servisim dhe mirëmbajtje të gjeneratorëve dhe ngrohjeve qendrore;
- Bazuar në nevojat dhe kërkesat kemi iniciuar deklaratën për furnizim me tonerë për nevoja të AKP-së, për një periudhë një vjeçare;
- Duke u munduar në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve dhe materialeve, kemi iniciuar deklaratën e nevojave për furnizim me material administrativ për një periudhë një vjeçare;
- Bazuar në kërkesat dhe nevojat për ujë në ZR Gjilan, kemi dërguar një rezervuar uji prej 2000 litra dhe kemi instaluar në sistemin e ujit brenda objektit të AKP Zyra Gjilan;
- Bazuar në kërkesat dhe nevojat e AKP-së kemi iniciuar deklaratën e nevojave për furnizim me material higjienik për një periudhë një vjeçare;
- Në bashkëpunim me sektorin e transportit kemi iniciuar deklaratën për furnizim me karburante për ngrohje qendrore, gjeneratorë dhe vetura.

2. Njësia e Burimeve Njerëzore

- Është bërë azhurnimi dhe konfirmimi si dhe janë dërguar për ekzekutim në baza mujore Listat e Pagave (Payrollit) për muajt, Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht dhe Shtator 2014;
- Është finalizuar Procesi i Rekrutimit dhe Selektimit për 3 (tre) pozita të lira (Zyrtar për Regjistrim të Ankesave, Zyrtar Financiar, Zyrtar i Lartë Ligjor për Përgatitjen dhe Përmbylljen e Shitjeve)
- Për shkak të mungesës e kompetencave të nënshkrimit, janë pezulluar proceset e rekrutimit dhe selektimit për 3 (tre) pozita (Koordinator i Njësisë, Kryesues i KSHALP, Zyrtar Kadastral ZR Prishtinë);
- Kanë dhënë dorëheqje 6 (gjashtë) punonjës;
- 1 (një) rast i shkëputjes së marrëdhënies së punës si pasojë e skadimit të Kontratës;
- 2 (dy) raste të shkëputjes së marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit sipas moshës (65 vjet);
- 1 (një) rast i shkëputjes së marrëdhënies së punës si pasojë e vdekjes;

- Me rastin e arrestimit të disa zyrtarëve të AKP-së dhe njëkohësisht me rastin e njoftimit nga Prokuroria Speciale me rastin e hetimeve të disa zyrtarëve të AKP-së, janë përgatitur vendimet për pezullim parandalues për 5 (pesë) zyrtarë të AKP-së;
- Në bazë të Planeve Individuale të Zhvillimit të punonjësve, është përgatitur Plani Vjetor i Agjencisë për Trajnim dhe Zhvillim të punonjësve për vitin kalendarik 2014 dhe i njëjti është aprovuar nga 2 ZDM-të;
- Është koordinuar pjesëmarrja në Trajnimet e mëposhtme:
- Menaxhim të Ciklit të Projekteve dhe Udhëheqje për 15 punonjës të AKP-së;
- Programet Certifikuese në SHKÇAK (SCAAK) në tre (3) Nivelet për 11 punonjës të Agjencisë;
- Programi Certifikues PMP për 33 punonjës të AKP-së;
- Konferencë Europiane për BNJ "HR TECH EUROPE 2014 Conference, për 1 punonjës të Agjencisë;
- Trajnim "Finance for non Financial Managers", për 1 punonjës të Agjencisë;
- Trajnim për Provim të Jurisprudencës (OAK), për 1 punonjës të Agjencisë;
- Trajnim për 3D Animations & Visual Effects (ICK), për 1 punonjës të Agjencisë;
- Trajnim për VVeb Design (ICK), për 1 punonjës të Agjencisë;
- Konferencë "Summer Global Business Conference 2014" (Inovation Institute), për 1 punonjës të Agjencisë;
- Është koordinuar pjesëmarrja në Trajnime dhe Programe Certifikuese për 4 punonjës të Agjencisë;Trajnimi i organizuar nga MAP për avancimet e reja në sistemin e menaxhimit të vijueshmërisë në punë për 1 punonjës të Agjencisë;
- Pjesëmarrje në trajnim në IKAP të zyrtarëve të BNJ për Planifikim të Personelit;
- Në përkrahje të programit " Trajnim dhe Praktikë për Studentët e dalluar të UP-së " i cili është një bashkëpunimi i USAID/KPEK dhe AFAS, është aranzhuar fillimi i praktikës për 25 studentë të këtij programi në të gjitha zyrat rajonale dhe departamentet e AKP-së;
- Ka përfunduar mbledhja e vlerësimeve të performancës për vitin 2013, planet individuale të punës si dhe Planet Individuale të Zhvillimit për vitin 2014 të punonjësve (përpilimi i Udhëzuesit të Brendshëm të Agjencisë mbi Menaxhimin e Performancës, modifikimi i formularëve relevant, informimi/ këshillimi dhe pajisja e punonjësve me të njëjtat, kolektimi, selektimi, popullimi i bazës së të dhënave, kalkulimi i mesatares në baza individuale si dhe përgatitja e raportit vjetor);
- Është bërë njoftimi për deklarim të pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik të AKP-së;
- Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka shqyrtuar dhe ka marr vendim për 11 (njëmbëdhjetë) ankesa dhe 4 (katër) janë në proces;
- Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar dhe ka marr vendim për 4 (katër) raste dhe 2 (dy) janë në proces;

- Është formuar Komisioni për Rishikim të pagës mirëpo momentalisht nuk është duke shqyrtuar asnjë rast për shkak të mungesës së kompetencave të zëvendësimit të njërit anëtar të Komisionit si dhe adresimit dhe marrjes së vendimit pas rekomandimit nga Komisioni;
- Komunikim i rregullt me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës lidhur me asistim rreth informatave shtesë për ankesat e deponuara tek ta;
- Kontakt i vazhdueshëm me Policinë e Kosovës, respektivisht Departamentin për Krime të Rënda rreth kërkesave të tyre për stafin AKP-së;
- Me qëllim të përmirësimit të procesit të hyrje/daljeve të stafit të AKP-së, është instaluar edhe një terminal i ri për regjistrim të hyrje/daljeve.

3. Njësia e Arkivit

- Aranzhimi i depos se re të Arkivit;
- Regjistrimi i dokumentacionit të AKM-së dhe AKP-së në softuerin e Arkivit;
- Dokumentacioni i skanuar, regjistruar dhe arkivuar- 293 regjistratorë te Departamenteve të ndryshme të AKP-së;
- Kontratat e privatizimit te skanuara, regjistruara dhe arkivuara, gjithsej 66 kontrata;
- Kërkesat për dokumentacion, gjithsej 81 kërkesa;
- Libra të protokollit të arkivuar, 4 libra;
- Dokumentacioni i azhurnuar, Njësia e Marketingut.

4. Njësia e Përkthimeve

- Njësia e Përkthimeve gjatë periudhës nëntëmujore prej 01.01.2014 deri 30.09.2014 ka përkthyer 965 dokumente me 5,532 faqe dhe ka siguruar përkthyesit për 15 takime dhe
- Asistimi në shumë përkthime të drejtpërdrejta, si ne takime të ndryshme me palë të interesuara, mbledhjet e Bordit si dhe në ditët e shitjeve.

5. Njësia e Teknologjisë Informative

- Është përfunduar procesi i instalimit fillestar të pajisjeve për “disaster recovery system” . Implementimi e Recovery Center për qëllime të mbrojtjes se sistemit (replikimi i dyanshëm - (pjese e planit për rimëkëmbje në rast fatkeqësie) . Po ashtu është siguruar dhoma e serverëve me dyer dhe dritare të sigurisë më të lartë;
- Pasi që shumica e ZR janë lidhur me rrjet optik, është shpejtuar më shumë se 3x herë lidhja e rrjetit dhe internetit me zyrat regjionale. Kjo ka rezultuar me mungesën e ankesave nga ana e zyrave regjionale për shkak të lehtësimit të punës së përditshme;

- Implementimi i portalit për Helpdesk është njëra nga të arriturat. Sidoqoftë mos-insistimi I shfrytëzuesve për përdorimin e tij, e ka minimizuar rëndësinë e tij. Njësiti i TI-së e shfrytëzon aktivisht për të gjeneruar raporte për kompjuterë në rrjet;
- Instalimi dhe përgatitja e pajisjeve tjera për VVindovvs 7 Upgrade. Janë përfunduar këto regjione: GJILANI, PEJA, MITROVICA, dhe gjysma e ZYRËS QENDRORE.
- Zgjerimi i portofolios së shërbimeve të fotokopjeve në AKP. Edhe pse ende nuk janë implementuar në tërësi, shtimi i fotokopjeve të vogla si skener do të evitojë problemet me servisimin e skenarëve të vjetër;
- Instalimi dhe përgatitja e pajisjeve tjera për "Ëindovvs 7 Upgrade edhe pse janë planifikuar të kryhen deri ne fund te vitit, kemi mbetur mbrapa për shkak të mungesës së pajisjeve (RAM, HDD dhe kompjuterë të ri). Për shkak të shumë vonesave të ndryshme, ky proces është ende ne fazën e prokurimit. Mungesa e TAPE për Backup është paraqitë si problem në muajin tetor;
- Implementimi I plotë I Recovery Center bëhet vetëm kur pjesa tjetër të jetë fizikisht larg lokacionit qendror. Në pamundësi me realizuar teknikisht në një të ardhme të afërt, do të mundohemi që pjesën tjetër të Recovery të zhvendosim në pjesën e kabinetit të rrjetit (ana e majtë e ndërtesës);
- Këtë vit ka pasur prishje të pajisjeve të rrjetit të cilat fatmirësisht nuk kanë ndikuar në mbarëvajtje të punës së AKP-së. Si shembull është nje disk nga SAN-i (Storage Area Netëork) 14/03/2014) për të cilin kemi pritur më shumë se 1 muaj që të ndërrohet nën garancion. Për ti evituar këto probleme në të ardhmen, i kemi paraparë të prokurohen disqe rezervë të cilat do të ndërroheshin menjëherë pa pasur nevojë të presim ekzekutimin e garancionit;
- Restaurimi I shënimeve të vjetra nga backup sipas kërkesave të policisë së Kosovës, na ka shkaktuar telashe pasi që ai backup është I ndërtuar në teknologji të vjetër SDLT II. Administratori I rrjetit ka arrit me I kthyer krejt databazat e mailboxit për periudhën 2009-2011. Për të mos u munduar në të ardhmen me teknologji të vjetra, kemi rekomanduar që databazat e ekstraktuara të ruhen ose fizikisht në ndonjë server ose në tape të formatit të ri.

6. Zyra e Protokollit

- Gjatë kësaj periudhe janë pranuar si dokumente hyrëse në këtë zyre 4805 shkresa;
- Shkresa dalëse nga kjo zyre janë regjistruar 4046;
- Të regjistruara në sistem hyrje/dalje janë 8851;
- Të skanuara 8851;
- Pranimi me Postë 4830;
- Dërgimi me Postë 2188;
- Dërgimi me Libër Personal brenda AKP-së 4805;
- Dërgimi me Libër jashtë AKP-së 118;

- Dërgimi në DHP nga Delloitt-ti 1054.

7. Njësia e Transportit

- Kemi bërë regjistrimin e automjeteve zyrtare të AKP-së në pronësi të AKP-së edhe pse pas shumë vonesave nga Komuna e Prishtinës;
- Në bazë të problemeve që i kemi hasur në verën e kaluar edhe në konsultim me Njësinë e TI-së, kemi iniciuar deklaratën për riparimin e dhomës së serverëve në zyrën Qendrore të AKP-së;
- Kemi pasur 1382 kërkesa te rregullta për shfrytëzimin e veturave;
- Po ashtu kemi pasur 1164 shërbime tjera te ndryshme për vetura te cilat janë dërgimi dhe kryerja e shërbimeve te ndryshme për departamentet e ndryshme neper zyre rajonale,mbushja e veturave me derivate,larja dhe pastrimi i tyre si dhe sjellja dhe dërgimi i veturave nga ZR dhe qendrore për servisim;

XI. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Gjatë periudhës Janar – Shtator 2014, Departamenti i Prokurimit ka përmbyllur 31 kontrata. Kontrata janë si më poshtë:

- Shërbimi Fizik
- Lidhja e kontratës për objektin me qira për Zyrën Satelitore ne Leposaviq
- Shërbimet e shtypjes se materialeve promovuese
- Regjistrimi dhe sigurimi I automjeteve –AKP
- Vazhdim I kontratës me gazetën Dangraf Dailypres
- Vazhdim I kontratës me Televizionet RTK, KTV dhe RTV 21
- Kontratë për promovimin e Agjencisë nëpërmjet Radiove Lokale dhe Nacionale
- Shfrytëzimi I portalit Qysh. Me për qëllime të marketingut dhe promovimit të Agjencisë
- Mirëmbajtja e databazes se Njësisë për Ankesa te Departamentit Ligjor
- Ri-tender-Auditimi I ndërmarrjeve shoqërore, ndërmarrjeve të privatizuara me Spin Off Special dhe ndërmarrjeve të privatizuara me kushte
- Furnizim me material higjenik
- Shërbimi Fotokopjimit dhe Printimit,Servisimi I pajisjeve te IT-se
- Furnizim me material administrativ
- Fotokopjim, Skanim dhe Lidhje e Librave Amëz
- Publikime I reklamave / njoftimeve ne Portale (10% I kontratave baze)
- Pjesëmarrja ne Panairin e Përgjithshëm Ndërkombëtar “Prishtina 2014
- Furnizim me vetura te reja transporti
- Furnizimi dhe montimi I dritareve dhe derës grile
- Publikime I reklamave / njoftimeve ne Portale
- Mirëmbajtja e Air Kondicionerëve dhe furnizimi me Air Kondicioner
- Lidhja e kontratës për objektin me qira për nevojat e AKP-se ne Shtërpcë
- Furnizim me pajisje te TI-se - RAM Memorie
- Hapësirat Afariste për Rajonin e Prishtinës
- Vazhdimi I Kontratës për Arkivin ne Prizren

- Vazhdimi I Kontratës për Arkivin ne Mitrovicë
- Xhirimi dhe emetimi i drejtpërdrejt i Ceremonisë se Dorëzimit dhe të Pranimit të Ofertave
- Furnizim me pajisje sanitare dhe elektrike
- Vazhdimi I Kontratës për Arkivin ne Pejë
- Vazhdimi I Kontratës për Arkivin ne Gjilan
- Regjistrimi dhe sigurimi I automjeteve -AKP
- Furnizimi i pajisjeve të IT-së (Hard disk)

XII. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) me sukses ka arritur që të përmbushë planin e vet të punës për periudhën Janar-Shtator 2014, duke i ofruar menaxhmentit të lartë rekomandime konkrete.

Në vazhdimësi paraqiten aktivitetet e NJAB-së gjatë kësaj periudhe:

- **Auditimi i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve:** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar kryesisht në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me Sekretarinë Ekzekutive të Bordit (SEB). Bazuar në të gjeturat e auditimit dhe konkluzionet e dhëna, ky auditim ka rezultuar me 6 rekomandime përkatëse.
- **Auditimi i Departamentit të Koordinimit Rajonal (ZR e Gjilanit dhe ZR e Prizrenit):** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me procesin e dhënies së objekteve (lokaleve) me qira në ZRGJ dhe ZRPz, implementimin efektiv të vendimeve të Bordit dhe Menaxhmentit nga ana e Departamentit të Koordinimit Rajonal përkatësisht Zyrat Rajonale të Gjilanit dhe Prizrenit si dhe aktivitetet tjera të ndërmarra nga këto zyre. Bazuar në të gjeturat e auditimit dhe konkluzionet e dhëna, ky auditim ka rezultuar me 9 rekomandime përkatëse.
- **Auditimi i Njësisë së Riorganizmit:** ky auditim është finalizuar në muajin Shtator. Objektivat kryesore te ketij auditimi janë bazuar kryesisht në vleresimin e rrezikut, të cilat janë të nderlidhura me Njesine per Riorganizim (NJR). Bazuar në të gjeturat e auditimit dhe konkluzionet e dhëna, ky auditim ka rezultuar me 4 rekomandime përkatëse.
- **Auditimi i Departamentit të Shitjes**: Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar kryesisht në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me Departamentin e Shitjes. Auditimi i Departamentit të Prokurimit është në fazën e Draft-Raportit, dhe i njëjti pritet që të finalizohet në fund të muajit Tetor.
- **Auditimi i Departamentit të Prokurimit**: duke u bazuar në planin e punës se NJAB-it, ky auditim ka filluar në muajin Gusht. Auditimi në fjalë është përqendruar në rishikimin e procedurave për aktivitetet e prokurimit publik, duke përfshirë përgatitjen e planit të punës, përgatitjen e dosjes së tenderit, vlerësimin e kontratave publike, specifikimet teknike, reklamimin dhe transparencën, udhëheqjen me procedurat e prokurimit dhe kërkesat mbi përshtatshmërinë, pagesat, përmbarimi i kontratës, etj. Auditimi i Departamentit të Prokurimit është në fazën e shkruarjes së Draft-Raportit, dhe i njëjti pritet që të finalizohet në fillim të muajit Nëntor.
- **Hartimi i Strategjisë (2014-2016) dhe Planit të Punës për 2014:** është duke u rishikuar Strategjia e NJAB-it për vitet 2014-2016 dhe e njëjta pritet të amandamentohet për vitet 2015-2017 si dhe është duke u përgatitur Plani Vjetor i Punës për vitin 2014.

- **Zyrtari i Standardeve Profesionale (ZSP):** përgjatë periudhës raportuese Zyrtari për Standarde Profesionale ka trajtuar disa raste kryesisht të iniciuara nga Menaxhmenti dhe nga departamentet përkatëse.
- **Trajnimi i stafit të NJAB-së:** Në këtë periudhë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm nuk ka pasur trajnime të stafit.

XIII. STRUKTRURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT



TABELAT E PASQYRAVE FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

GJENDJA E LLOGARIVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

raporti nënshkruar më 29 Tetor 2014
për periudhën 30 Shtator 2014

Tabela 1 (sqarimet për tabelat jepen në fund të shënimeve shpjeguese)

		Llogaritë Rrjedhëse **30 Shtator 2014** 1	Depozitat Kohore* **30 Shtator 2014** 2	**Totali 30 Shtator 2014 3=1+2**	31 dhjetor 2013 4	31 dhjetor 2012 5	31 dhjetor 2011 6	31 dhjetor 2010 7	31 dhjetor 2009 8	31 dhjetor 2008 9
	BILANCI I FONDEVE NË MIRËBESIM	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**
1	Privatizim	72,076,626	10,589,292	**82,665,918**	122,250,942	210,850,705	279,466,900	278,534,087	259,719,544	261,147,260
2	Likuidim	382,849,783	40,791,038	**423,640,821**	385,590,737	273,474,558	267,860,645	214,480,470	175,188,793	123,626,811
3	Para të NSH-ve në mirëbesim	7,007,020	-	**7,007,020**	6,893,134	5,971,317	5,401,324	5,691,148	3,388,895	5,673,507
4	Komercializim	3,667,287	-	**3,667,287**	3,667,287	3,667,287	4,115,381	3,520,026	3,567,460	2,940,103
5	Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët	25,195,116	-	**25,195,116**	27,809,806	30,926,511	20,963,568	9,662,836	132,986	147,085
6	Depozita nga tenderët e privatizimit	111,738	-	**111,738**	321,749	1,749,269	2,016,346	3,139,227	3,391,091	4,718,572
7	Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim	267,528	-	**267,528**	267,537	49,860	2,231,034	1,892,396	1,428,339	1,080,181
12	5.3	21	Monitorimi i NSH-ve të privatizuara përmes spin-	**Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i AKP-së:** • Duhet të rishikojnë bazën sipas të cilës ndëshkimet e shqiptuara financiare janë falur, të konsiderohet ndikimi i këtij vendimi	Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i AKP-së	31 dhjetor 2014	Zbatim i vazhdueshëm

Rekomandimi nr.	Neni në raport	Faqe	Referencë	Rekomandimi i ZAP-së	Departamenti Përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
			off special dhe NSH-ve të privatizuara përmes metodës së privatizimit me kushte të veçanta	dhe çfarë veprime janë të nevojshme dhe nëse një zotim nuk përmbushet duhet ti nënshtrohet ndëshkimit adekuat, financiar dhe ligjor.			
13	5.3	22	Monitorimi i NSH-ve të privatizuara përmes spin-off special dhe NSH-ve të privatizuara përmes metodës së privatizimit me kushte të veçanta	**Menaxhmenti i AKP-së:** • Duhet të rishikoj objektivat e monitorimit dhe të implementoj një proces monitorimi nga një staf profesional. Kjo duhet të rregullohet në mënyrë që të prodhohen raporte të rregullta mujore për menaxhmentin për të ofruar paralajmërim e hershëm nëse kushtet e kontratave do të plotësohen.	Menaxhmenti i AKP-së dhe Njësia e Monitorimit	31 dhjetor 2014	Zbatim i vazhdueshëm
14	6	24	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	**Menaxhmenti i AKP-së:** • Duhet të sigurojë se përgatitja e buxhetit është zhvilluar nga një proces rigoroz i vlerësimit i cili reflekton në plotësi të gjitha informatat relevante duke përfshirë edhe shpenzimin e viteve të kaluara duke pasur parasysh ndryshimet e planifikuara. • Vëmendje e veçantë duhet t"i kushtohet identifikimit të barrierave dhe mundësive për të ngritur përqindjen e ekzekutimit për kategorinë mallra dhe shërbime.	Menaxhmenti i AKP-së dhe Departamenti i Financave Menaxhmenti i AKP-së dhe Departamenti i Financave	31 dhjetor 2014 31 dhjetor 2014	Zbatim i vazhdueshëm Zbatim i vazhdueshëm

Rekomandimi nr.	Neni në raport	Faqe	Referencë	Rekomandimi i ZAP-së	Departamenti Përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
				• Monitorimi efektiv i buxhetit vjetor duhet të aplikohet me qëllim që veprimet kohore të ndërmerren për të adresuar variancat përkundër shpenzimeve të planifikuara.	Menaxhmenti i AKP-së dhe Departamenti i Financave	31 dhjetor 2014	Zbatim i vazhdueshëm
15	6.1	26	Të hyrat e AKP-së	**Menaxhmenti i AKP-së të:** • Sigurojnë se të gjitha llogaritë e arkëtueshme menaxhohen bazuar në kontrata përkatëse.	Menaxhmenti i AKP-së dhe Departamenti i Financave	31 dhjetor 2014	Zbatim i vazhdueshëm
				Menaxhmenti i AKP-së: • Në mënyrë aktive duhet t‟i shqyrtojë të gjitha opsionet, përfshirë edhe mjetet ligjore, për të siguruar se pagesat e pajtuara do të kryhen.	Menaxhmenti i AKP-së	31 dhjetor 2014	Zbatim i vazhdueshëm
16	6.2.1	27	Shpenzimet jo përmes prokurimit	**Menaxhmenti i AKP-së duhet të rivlerësojë kornizën e përgjithshme qeverisëse në lidhje me Bordin e Drejtorëve të AKP-së për të siguruar se:** • Janë krijuar mekanizma për mbikëqyrje efektive të kompensimeve ndaj anëtarëve; dhe	Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i AKP-së	31 dhjetor 2014	Zbatim i vazhdueshëm
				• Termat e Referencës formale aplikohen për të gjithë anëtarët e bordit, duke specifikuar në mënyrë të qartë përgjegjësitë e tyre shtesë/specifike.	Menaxhmenti i AKP-së	31 dhjetor 2014	Zbatim i vazhdueshëm
17	6.3	28	Sistemi i auditimit të brendshëm	**Menaxhmenti i AKP-së:** • Duhet të zhvilloj një plan të qartë veprimi për të adresuar rekomandimet e NJAB, i cili konfirmon zyrtarët përgjegjës dhe kohën për kryerjen e veprimeve.	Menaxhmenti i AKP-së	31 dhjetor 2014	Zbatim i vazhdueshëm

Rekomandimi nr.	Neni në raport	Faqe	Referencë	Rekomandimi i ZAP-së	Departamenti Përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
18	6.3	28	Sistemi i auditimit të brendshëm	**Menaxhmenti i AKP-së:** • Duhet të punoj me udhëheqësin e Komitetit të Auditimit për të mbështetur një KA i cili aplikon praktikat më të mira. **Menaxhmenti i AKP-së dhe Bordi i AKP-së:** • Duhet të sigurojnë që të aprovohet statuti i Komitetit të Auditimit.	Menaxhmenti i AKP-së dhe Komiteti i Auditimit Bordi i Drejtorëve dhe Komiteti i Auditimit	31 dhjetor 2014 31 dhjetor 2014	Zbatim i vazhdueshëm Zbatim i vazhdueshëm

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE

PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 30 SHTATOR 2014

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

TË FONDEVE NË MIRËBESIM

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

SHËNIMET SHPJEGUESE

TË PASQYRAVE FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2014

Shënimi 1: Përmbledhje e metodave të rëndësishme të kontabilitetit:

1.1. Baza e përgaditjes së pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) janë përgaditur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme - Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Këto pasqyra financiare i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga "Rregullorja e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim" aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 23 Shkurt 2011 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare janë pjesë përbërëse për kuptimin e pasqyrave financiare dhe duhet të lexohen së bashku dhe në ndërlidhje me pasqyrat financiare.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë tërë periudhës raportuese.

1.2. Subjekti Raportues:

Agjencia Kosovare e Privatizimit shte themeluar sipas ligjit nr. 03/L-067 (në fuqi më 1 Korrik 2008), i ndryshuar me ligjin nr. 04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si organ i pavarur publik me zotësi të plotë juridike është pasardhëse (sa i përket Ndërmarrjeve Shoqërore) e ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që ka qenë e themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, e ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/18.

Periudha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej 1 Janar 2014 deri më 30 Shtator 2014. Në këto pasqyra financiare janë paraqitur edhe raporte që paraqesin të dhënat financiare nga data 1 Korrik 2003 deri më 30 Shtator 2014. Raportet e pasqyrave financiare janë paraqitur në Tabelën e Përmbajtjes së Pasqyrave Financiare.

Pasqyrat Financiare janë për Fondet në Mirëbesim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar ne Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenin 20 të Ligjit për Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit kontrollohet nga Bordi i Drejtoreve te Agjencise Kosovare të Privatizimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza vjetore.

Aktivitetet e AKP-së financohen përmes tarifës administrative të Agjencisë dhe fondeve të donatorëve nëse donatorët japin donacione. AKP-ja, gjatë vitit 2011 ka transferuar EUR 1.8 milion, ndërsa gjatë vitit 2012 Agjencia Kosovare e Privatizimit ka transferuar gjithsej shumën prej EUR 16,248,000.00

Gjithsej shuma prej EUR 16,248,000 përfshinë:

1. për vitin fiskal 2012 shumën prej EUR 8,200,000.00 (tetë milion e dyqind mijë euro) të transferuara me datën 28 Maj 2012 për financimin e aktiviteteve administrative dhe operative; dhe
2. për vitin fiskal 2013 shumën prej EUR 8,048,000.00 (tetë milion e katërdhjetë e tetë mijë euro) të transferuara me datën 28 Dhjetor 2012 për financimin e aktivitetetve administrative dhe operative.
3. fondet tepricë nga shpenzimet e vitit 2012 dhe 2013 janë bartur për shpenzimet e buxhetit për vitin 2014 dhe se me harmonizimin që kemi pasur me Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave, mjetet shtesë që do të transferohen në llogarië e 1000400070004642 AKP PRIVATIZIMI TARIFA ADMINISTRATIVE për mbulimin e buxhetit 2014 do të jenë gjithsej EUR 2,300,000.00.

Në pajtim me ligjin mbi themelimin e AKP-së, aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) nëpërmjet të metodave të spin of-it, likuidimit dhe qiradhënies afatgjate.

Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore.

Agjencia Kosovare e Privatizimit menaxhon Ndermarrjet Shoqerore ne Kosove dhe i mban keto Ndermarrje ne mirebesim. Si administruese e besuar, AKP eshte e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerave te NSH-ve.

Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk kontrollon subjekte tjera të cilat janë/apo mund të jenë konsoliduar në aktivitetet e tyre në këto pasqyra financiare.

1.3. Raportimi i Transaksioneve përmes Llogarive të AKP-së:

AKP-ja udhëheq dhe i kontrollon shpenzimet dhe të hyrat e fondeve në mirëbesim përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP-ja bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi i urdhër-transfereve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së.

Shënime lidhur me llojet e llogarive në mirëbesim janë shpalosur në shënimin 4a.

1.4. Valuta raportuese:

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në raportin përkatës.

1.5. Data e autorizimit të pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë autorizuar për lëshim më datën 31 Tetor 2014 nga: Avni Jashari, Zv. Drejtor Menaxhues, Likudim dhe Adem Selishta, U.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

1.6. Softveri që përdoret për Pasqyrat Financiare dhe Raportet Financiare:

Avni J. Jashari, gjatë viteve që ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Financave dhe Buxhetit, ka dizajnuar programin në Microsoft Excel për administrimin financiar të fondeve në mirëbesim, për të përgatitur raportet financiare si dhe Pasqyrat Financiare që vazhdon ende të përdoret dhe të plotëson të gjitha nevojat si softver për harmonizim bankar, për të gjeneruar pasqyra të ndryshme financiare ashtu siç është specifikuar ne Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenin 20 të Ligjit për Agjencisë Kosovare të Privatizimit .

Personeli i AKP-së qe punon ne kete softver është:

- Adem Selishta, U.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit: freskon, zgjidhë problemet e softverit, mbikqyrë harmonizimin bankar;
- Korab Lufi, u.d. Kryesues i Njësisë për Menaxhimin e Fondeve: zgjidhë problemet e softverit, mbikqyrë harmonizimin bankar;vendos të dhënat dhe kategorizon të gjitha transakcionet, harmonizon llogaritë bankare;
- Valon Fetahu, kategorizimi i transakcioneve dhe harmonizimi i llogarive bankare.
- Melita Cana, Korab Lufi dhe Nora Budima: përgatisin transferet bankare.

Ruajtja e kopjeve të të të dhënave në softver: Ruajtja e raportit financiar behet me reference të dates (p.sh. referenca “140930-raporti i llogarive në BQK” duhet të lexohet siç vijon: Raporti i llogarive në BQK për datën 30 Shtator 2014). Ruajtjet tjera bëhen ne diskun kryesor ne dy kompjuterë të ndryshëm, ne serverin e teknologjisë informative të AKP-së në rrjetin e follderit te perbashket te Raporteve Financiare. Njësia e Teknologjisë Informative bën në mënyrë automatike (ang. “shadovv copy”) kopje të përditshme të të dhënave në server në formë elektronike si dhe kopje javore në formatin e shiritave magnetik. Tre kopje në CD (Compact Disc) bëhen pas dorezimit të Pasqyrave Financiare.

1.7. Tabelat e kontrollimit automatik të gabimeve:

Janë të dizajnuara 36 tabela te cilat automatikisht kontrollojne se a gjenerohen rezultate të njejta qe merren nga pika referuese te ndryshme. Ne rast se të dhënat regjistrohen gabimisht ne softver, keto tabela automatikisht gjenerojne ndryshimin ne rezultate dhe formatizohen me ngjyre te kuqe te qelizes dhe me formatizim te nxire ("bold").

1.8. Autorizimet në llogarite bankare:

Të drejtat e nënshkrimit në llogaritë bankare të fondeve në mirëbesim janë të përcaktuara me procedurat bankare të AKP-së të aprovuara më datën 1 Shtator 2008 e të ndryshuar më 28 Shtator 2011 pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AKP-së.

Sipas nenit 11 dhe 15 të Ligjit të Agjencinë, Bordi i Drejtorëve e emëron Drejtorin Menaxhues të Agjencisë dhe dy Zëvendës Drejtorët Menaxhues dhe për një vendim të tillë nevojiten së paku 5 vota afirmative. Nga data 26.01.2014, Agjencia nuk ka Drejtor Menaxhues dhe detyrat e tij sipas Aktit të Themelimit të Agjencisë i kanë kryer dy Zëvendës Drejtorët Menaxhues bashkërisht. Për shkak të disa rrethanave të krijuara në fund të muajit Prill 2014, Bordi i Drejtorëve më 7 Maj 2014 kishte marr vendimin që të pezulloj nga puna njërin nga zëvendësdrejtorët Menaxhues të Agjencisë dhe të emëroj një ushtrues detyre në vendin e tij (ushtrues detyre i Zëvendësdrejtorit Menaxhues - likuidimi). Në mbledhjen e mbajtur më 26 dhe 31 Gusht 2014, Bordi i

Drejtorëve ka vendosur që të vazhdoj mandatin e ushtruesit të detyrës së Zëvendësdrejtorit Menaxhues deri në vendimin e ardhshëm të Bordit të Drejtorëve.

Më datën 17.09.2014, Zëvendësdrejtoresha Menaxhuese e Agjencisë për Divizionin e Shitjes ka dhënë dorëheqje të menjëhershme dhe të parevokueshme.

Pra, Agjencia tani e ka Bordin e Drejtorëve me vetëm tre anëtarë (Zëvendës Kryesuesi i Bordit së bashku me dy anëtarë) dhe në cilësinë e Menaxhmentit e ka një ushtrues detyre të Zëvendësdrejtorit Menaxhues.

Kompetencat e Agjencisë janë mjaft të kufizuara sa i përket zhvillimit normal dhe institucional të Agjencisë konform Ligjit për Agjencinë dhe akteve të tjera nënligjore.

AKP me datën 3 Tetor 2014 ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës kërkesën që të interpretoj dhe udhëzoj Agjencinë si në vijim:

- A mundet që një Zëvendësdrejtor Menaxhues (aktualisht si zyrtari më i lartë administrativ në Agjenci dhe si Menaxhment në kuptim të nenit 3.1.15 të Ligjit për Agjencinë) të ushtroj detyrën si Zyrtar Kryesor Administrativ i Agjencisë.

- A mund të konsiderohet se në kuadër të termit '*instrumenteve tjera*' i cili përmendet në Aktin e Themelimit të Agjencisë (neni 6), përfshihen edhe '*transferet apo transaksionet bankare*' të fondeve në mirëbesim të Agjencisë.

- Në ndërlidhje me Aktin Themelues të Agjencisë (neni 6) dhe Procedurat Bankare të Agjencisë (neni 7), a konsiderohet se transferet bankare të fondeve në mirëbesim nga shuma 0 (zero) deri në shumën EUR 500,000 (pesëqind mijë euro) mund të nënshkruhen kolektivisht nga: Zëvendës Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve, një Zëvendës Drejtor Menaxhues dhe Drejtori i Financave dhe Buxhetit.

Më 28 Tetor 2014 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar aktvendimin ku theksohet se Gjykata i kupton shqetësimet e Agjencisë dhe është e vetëdijshme për ndikimet që po shkaktohen në punën e saj si pasojë e mos funksionimit të Bordit. Megjithatë "gjykata nuk mund të ofroj zgjidhje (nëpërmjet interpretimit të dispozitave ligjore apo akteve tjera nënligjore të nxjerr nga Agjencia përfshirë dhënien e çfarëdo përgjigje në pyetjet e parashtruara) e cila do t'i mundësoj Agjencisë tejkalimin e pengesave që po ndikojnë në punën e saj në mungesë të Bordit të kompletuar dhe menaxhmentit pothuajse plotësisht jofunksional."

AKP-ja është drejtuar Ministrisë së Administratës Publike me shkresë më 25 Shtator 2014, lidhur me kërksën për opinion ligjor, se a mundet vetëm një zëvendës drejtor në Agjenci të nënshkruaj si Zyrtar Kryesor Administrativ.
Ministrisë së Administratës Publike, më 15 Tetor 2014, ka lëshuar opinion ligjor, se në mungesë të Drejtorit Menaxhues të AKP-së, duhet të zëvendësohet nga Zëvendës Drejtori Menaxhues i AKP-së, që në hirerarkinë e organit tonë është pozita më e lartë dhe vjen menjëherë pas pozitës së drejtorit.

Zyrtari Certifikues i Agjencisë nënshkruan çdo transaksion pas verifikimit dhe pasi që të jetë siguruar se transaksioni në fjalë përmban të gjitha elementet e duhura në përputhje me ligjin, politikat dhe procedurat e Agjencisë. Gjatë periudhës raportuese znj. Sahare Miftari: Certifikimi i transfereve bankare; Zyrtar Alternativ Certifikues është Valon Fetahu.

Shënim 2: Llogaritë bankare të Fondeve në Mirëbesim të AKP-së:

Te gjitha llogarite e mirebesimit mbahen si llogari bankare te veçanta (të ndara) ne Banken Qendrore te Kosoves (BQK), ndërsa në bankën Procredit mbahen të hapura llogaritë që mbajnë gjysmën e kapitalit themeltar të Ndërmarrjeve të Reja të cilat vendosen në proces të privatizimit me spin off të rregullt.

Në bankën Raiffeisen kemi edhe dy llogari të hapura për Ndërmarrjet e Reja, të cilat me momentin e bartjes së të drejtës së nënshkrimit apo marrjes së kontratës nga blerësi i ri do të bartet e drejta në këto dy llogari dhe kemi edhe një llogari të hapur për afatizimin e mjeteve.

Prej Korrikut 2003 deri në periudhën raportuese janë hapur 1,868 llogari bankare që kanë të bëjnë me Ndërmarrjet Shoqërore. Prej tyre janë mbyllur 233 llogari dhe 1,635 llogari janë aktive ne BQK.

Lista e te gjitha llogarive ne mirebesim të AKP-së dhe permbledhja e llogarive te privatizimit dhe likuidimit tregohen ne tabela ndarazi (sipas renditjes së paraqitur në tabelën e përmbajtjes së raportit vjetor financiar).

Specifikacioni i llogarive të AKP-së në Bankën Qëndrore janë paraqitur në raporte detaje të Pasqyrave Financiare.

Marrëveshja e Mirëkuptimit (MeM) në mes të Bankës Qëndrore të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit mbi urdhërpagesat elektronike është nënshkruar me datën 10 Dhjetor 2009. Kjo marrëveshje ka funksionuar shumë mirë prej momentit të nënshkrimit e deri në fund të periudhës raportuese.

Objektivë kryesore e AKP-së është automatizimi dhe elektronizimi i urdhërpagesave që kryhen përmes BQK-së, në rastet kur kemi të bëjmë me shumë transfere që duhet ekzekutuar brenda një dite.

Shënim 3: Interesi në llogaritë bankare

Interesi në llogaritë rrjedhëse

Interesi i fituar në BQK në llogaritë rrjedhëse të AKP-së paguhet në fund të çdo muaji. Normat e interesit për periudhat prej vitit 2003 e deri në periudhën raportuese janë paraqitur më poshtë:

Periudha	**interesi vjetor**	**Agjencia**
11 Korrik 2003 - 31 Dhjetor 2003	0.50%	ish-AKM
1 Janar 2004 - 31 Dhjetor 2005	1.00%	ish-AKM
1 Janar 2006 - 26 Mars 2006	1.25%	ish-AKM
27 Mars 2006 - 9 Korrik 2006	1.50%	ish-AKM
10 Korrik 2006 - 10 Shtator 2006	1.75%	ish-AKM
11 Shtator 2006 - 30 Nentor 2006	2.00%	ish-AKM
1 Nentor 2006 - 31 Janar 2007	2.25%	ish-AKM
1 Shkurt 2007 - 1 Maj 2007	2.50%	ish-AKM
2 Maj 2007 - 3 Korrik 2007	2.75%	ish-AKM
4 Korrik 2007 - 31 Dhjetor 2007	3.00%	ish-AKM
1 Janar 08 - 30 Qershor 2008	3.00%	ish-AKM
1 Korrik 2008 - 8 Gusht 2008	3.00%	AKP
9 Gusht 2008 - 17 Tetor 2008	3.25%	AKP

18 Tetor 2008 - 10 Dhjetor 2008	2.50%	AKP
11 Dhjetor 2008 - 17 Dhjetor 2008	1.75%	AKP
18 Dhjetor 2008 - 31 Dhjetor 2008	1.25%	AKP
1 janar 2009 - 22 Janar 2009	1.25%	AKP
23 janar 2009 - 19 mars 2009	0.50%	AKP
20 mars 2009 - 12 Korrik 2009	0.25%	AKP
13 Korrik 2009 - 31 Dhjetor 2009	0.10%	AKP
1 Janar 2010 - 31 Dhjetor 2010	0.10%	AKP
1 Janar 2011 - 26 Prill 2011	0.10%	AKP
27 Prill 2011 - 26 Korrik 2011	0.35%	AKP
27 Korrik 2011 – 22 Nëntor 2011	0.60%	AKP
23 Nëntor 2011 – 14 Dhjetor 2011	0.35%	AKP
15 Dhjetor 2011 – 31 Dhjetor 2011	0.10%	AKP
1 Janar - 10 Prill 2012	0.10%	AKP
11 Prill - 11 Korrik 2012	0.05%	AKP
12 Korrik – 31 Dhjetor 2012	0%	AKP
1 Janar 2013 – 31 Dhjetor 2013	0%	AKP
1 Janar 2014 – 30 Shtator 2014	0%	AKP

Investimet në depozitat kohore në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës:

Duke filluar nga 24 gushti i vitit 2010 Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka bërë depozita afat shkurtra të fondeve në mirëbesim në periudha të ndryshme të maturitetit prej 1 muaj deri 12 muaj. Në pajtueshmëri me vendimin e Bordit të Drejtorëve, të gjitha transaksionet e depozitave kohor janë autorizuar së bashku nga Zëvendës Drejtori Menaxhues për Koordinimin e Likuidimit dhe Drejtori i Financave dhe Buxhetit.

Depozitat kohore janë depozituar në Bankën Qëndrore të Kosovës dhe Raiffeisen Bank.

Departamenti i Financave dhe Buxhetit gjatë gjithë kohës ka qenë aktive sa i përket afatizimit të mjeteve në depozita kohor. Gjatë periudhës Janar – Shtator 2014 janë realizuar gjithsej 6 afatizime në depozita kohor dhe atë

1. Tre depozita në depozita tremujor, gjithsej në shumën totale prej EUR 65,000,000.00 dhe se të gjitha kanë mataruar;
2. Dy depozita në depozita gjashtëmujor, gjithsej në shumën prej EUR 50,000,000.00, ka matuar një prej tyre; dhe
3. Një depozit në depozita dymbëdhjetëmujor, gjithsej në shumën totale prej 5,000,000.00 që maturon më 5 Korrik 2015.

Gjithsej Interesi i fituar është EUR 32,209.72 që përfshinë interesin nga depozitat maturuar të shënuar më lartë prej EUR 20,343.06 dhe interesi prej EUR 11,866.67 nga depoziti i vitit paraprak më 23 Shtator 2013 që ka maturuar më 21 Mars 2014.

Nga viti 2010 duke i përshirë dhe depozitat që maturojnë më 31 Tetor 2014 dhe 5 Korrik 2015 (EUR 117,750.00) interesi i fituar nga pjesëmarrja në depozitat kohor do të jetë gjithsej EUR 7,233,687.

Mjetet janë afatizuar në Bankën Qendrore dhe bankat komerciale të Kosovës, mirëpo vlen të theksohet se në këtë treg, kohëve të fundit norma e interesit vjetor ka qenë shumë e ulët. Oferta e fundit nga banka komerciale ka qenë në normën prej 0.10% ndërsa nga Banka Qendrore nuk kemi pasur ofertë kjo për arsyen se normat e interesit kanë qenë negative dhe atë deri në MINUS 20% (sipas njoftimit më datën 5 Shtator 2014).

Për më tepër janë të paraqitura në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

1.5.1 Investimi i letrave në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës (bonot e Thesarit) kohor

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e datës 21 Qershor 2012 ka marrë vendim që menaxhmentit t'i lejohet diskutimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Ministrinë e Financave dhe Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në menyrë që të mundësohet investimi i fondeve në mirëbesim në tregun primar dhe tregtimi në tregun sekondar të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria.

Nuk është bërë ende ndonjë investim ose pjesëmarrje në ofertim të letrave me vlerë të Qeverisë për shkak se nuk është përfunduar me sukses përpjekja e Agjencisë për këto investime për arsyet të cilat nuk i janë të njohura Agjencisë.

Në muajin Gusht 2014, është mbajtur takimi me Bankën Qendrore të Kosovës në lidhje me përmisimin e kushteve dhe krijimin e mundësive për të gjithë akterët e rëndësishëm të kapitalit në Kosovës. Iniciativ kjo e këshilltarit të Gurvenatorit të Bankës Qendrore të Kosovës. Krijimi i mundësi i përket asaj që të ndryshohen kushtet teknike dhe legjislative për pjesëmarrjen në këtë treg. Agjencia është konsideruar një akterë shumë i rëndësishëm për qarkullimin e kapitalit në tregun e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria. Pritet që të bëhet një grup punues i cili përshinë dhe akterët të tjerë të tilla si Trusti Pensional i Kosovës. Agjencia ka shprehur gatishmërin që të jap kontributin e saj në menyrë që t'i krijohen dhe Agjencisë mundësitë për pjesëmarrje në këtë treg kjo sepse plotëson një nga objektivat themelore për rritjen e vlerës së NSh-ve.

Shënim 4: Sqarime lidhur me llojet e llogarive të AKP-së në BQK:

Përveç llogarisë së tarifës administrative të Agjencisë, llogarisë së donatorit, kapitalit themeltar të Agjencisë, fondit rezervë të Agjencisë, të gjitha llogaritë tjera të hapura nga Agjencia kategorizohen si llogari në mirëbesim që kanë të bëjnë me aktivitetet e Agjencisë sipas nenit 6, 8 dhe 9 të ligjit të Agjencisë.

Llogaritë e privatizimit:

Përdoren për të mbajtur paratë nga të shitjet gjatë privatizimit me metodën e spin off-it, kur edhe krijohen Ndërmarrjet e Reja (Nevvco).

Llogaritë e likuidimit:

Përdoren për mbajtjen e të ardhurave nga procesi i likuidimit te NSH-ve si dhe për pagesën e shpenzimeve gjatë procesit të likuidimit, pagesat e Ofruesve të Shërbimeve Profesionale dhe kreditorëve sipas shtojcës së ligjit të AKP-së.

Llogaritë e parave të NSH-ve në mirëbesim:

Mban parate e NSH ne mirebesim te AKP, ne rastet kur AKP vendos se NSH nuk ka kapacitete për të mbajtur këto të holla.

Llogaritë e parave të komercializimit:

Mban paratë e paguara nga qirate e komercializimit për kontratat e komercializimit te nenshkruara gjatë vitit 2000 nga UNMIK.

Llogaritë e parave të punëtorëve në llogaritë në mirëbesim (transferuar prej llog. të privatizimit dhe likuidimit):

Në rastet kur ka ankesa në listat e punëtorëve, mirëpo numri i ankesave është i ultë, AKP e bën shpërndarjen e parakohshme të 90% të 20%-it që u takon punëtorëve dhe pjesën e mbetur e parave që u takojnë punëtorëve te NSH-se specifike i mban në këto llogari. Paratë në këto llogari mbahen ndaras për NSH-të në fjalë dhe mund të transferohen prej llogarise se privatizimit apo te likuidimit.

Paratë e mbetura u transferohen punetoreve kur te gjitha ankesat në listat e punetoreve shqyrtohen nga Oda e Veqante e Gjykatës Supreme te Republikës së Kosovës.

Llogaria e depozitave të privatizimit:

Përdoret për të mbajtur depozitat e paguar nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit në privatizim. Kjo është një llogari e përkohshme nga e cila ne i kthejme depozitat ofertuesve të pasuksesshëm. Pasi të nënshkruhet kontrata e shitjes, depoziti i ofertuesit të suksesshem transferohet në llogarinë e privatizimit të hapur veçanerisht për Ndermarrjen e Re që privatizohet. Në rastet kur ofertuesit tërhiqen nga ofertat e tyre (përvec në raste të kërcënimeve), depozitat e këtyre ofertuesve transferohen në llogarinë e fondit rezervë të AKP-së.

Llogaria e tarifave për dorëzimin e ofertave në privatizim:

Përdoret për të mbajtur tarifat për dorëzimin e ofertës të pakthyeshme ndaj ofertuesve gjatë procesit të privatizimit.

Këto të holla llogariten si të ardhura vetanake të AKP.

Llogaria e depozitave të likuidimit:

Përdoret për mbajtjen e depozitave të paguara nga ofertuesit gjatë shitjeve të aseteve të NSH-ve gjatë procesit të likuidimit. Kjo është një llogari e përkohshme nga e cila i kthejmë depozitat ofertuesve të pasuksesshëm. Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë bankare të likuidimit e hapur për likuidimin e NSH të veçanta për të cilat ofertuesit janë deklaruar si fitues dhe kontratat e shitjes janë nënshkruar. Në rastet kur ofertuesit tërhiqen nga ofertat e tyre (përveç në raste të kërcënimeve), depozitat e këtyre ofertuesve transferohen në llogarinë e fondit rezervë të AKP-së.

Llogaria e tarifave për dorëzimin e ofertave në likuidim:

Përdoret për mbajtjen e tarifave për dorëzimin e ofertës të pakthyeshme ndaj ofertuesve gjatë procesit të likuidimit. Këto para llogariten si të ardhura vetanake për AKP.

Llogaria për dorzërimin ankesave për shqyrtim nga Komisioni i Shqyrtimit për likuidim:

Mban depozitat e paguar nga kreditorët për shqyrtimin e ankesave që kreditorët i deponojnë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në procesin e likuidimit.

Llogaria e kapitalit themeltar të AKP-së:

Mbahet kapitali themeltar i AKP-së. Ky kapital është paguar nga Buxheti i Republikës së Kosovës (BRK).

Aktualisht vetëm 1 milion EUR është paguar nga BKK gjatë mandatit të ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Shuma prej 9 milion EUR sipas ligjit mbi AKP-në do të paguhet sipas nevojës dhe kërkesës së AKP-së.

Llogaria e fondit rezervë të AKP-së:

Perdoret per te mbajur depozitet e konfiskuar nga ofertuesit gjate procesit te ofertimit ne privatizim dhe shitjeve gjate likuidimit. Në këtë llogari barten të hyrat vetanake nga:

- Tarifa e dorëzimit të ofertave në privatizim
- Tarifa e dorëzimit të ofertave në shitjet gjatë likuidimit
- Depozitat e konfiskuar ndaj ofertuesve që janë tërhequr nga procesi i ofertimit
- Tarifa e dorëzimit të ofertave në komercializim
- Interesi i fituar në llogarinë e depozitave të privatizimit; dhe
- Interesi i fituar në llogarinë e depozitave të likuidimit.

Llogaria e tarifës administrative të AKP-së:

Në këtë llogari transferohet tarifa administrative e Agjencisë sipas ligjit për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në Korrik 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar një garancion bankar lidhur me performancën e kontratës nga Deloitte Central Europe Limited për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale për likuidimin e portfolios së NSH-ve (nr. i prokurimit 239-11-068-211). Detajet e garancionit bankar janë si vijon: data e garancionit 9 Korrik 2012, shuma e garancionit €1,992,000, garancioni i vlefshëm deri më 10 Shtator 2016, emri i bankës që ka lëshuar garancionin: ING Bank N.V. PO BOx 350, 1000 Amsterdam, The Netherlands.

Llogaria e parave të donatorit:

Mban paratë e donatorit në raste kur paratë kanalizohen ndërmjet llogarive të AKP-së. Aktualisht është vetëm një llogari bankare që mban të hollat për një projekt të realizuar vite më parë nga ish-AKM-ja. AKP është në proces të identifikimit të raporteve narative dhe kontratës së donatorit që ish-AKM ka pasur me donatorët për këtë projekt.

Llogaritë e depozitimeve kohore:

Mban paratë që AKP transferon nga llogaritë individuale në llogaritë për depozitim kohor. Prej këtyre llogarive bankare, pas autorizimeve me shkrim nga AKP, Banka Qendrore e Kosovës i transferon paratë në depozitime kohore për periudhat e caktuara të maturitetit.

Shënim 5: Shpjegim për llojet e llogarive të AKP në Procredit Bank dhe Raiffeisen Bank:

Llogaritë PAK SOE:

Mban paratë e NSH-ve në mirëbesim të AKP në rastet kur AKP përcakton se një NSH nuk ka kapacitetet për të operuar me këto mjete.

Llogaritë e Ndërmarrjeve të Reja (llogaria që mban gjysmën e kapitalit themeltar):

Llogaria që mban gjysmën e kapitalit të aksionarit (EUR 1,250 apo 1,000 varet prej periudhës kur janë regjistruar Ndërmarrjet) të Ndërmarrjes së Re gjatë procesit të privatizimit. Deri në përfundim të shitjes, aksionar është AKP-ja. Në momentin e përfundimit të shitjes dhe nënshkrimit të kontratës, AKP i bartë aksionet te blerësi i Neëco-s. Pastaj, AKP i shkruan bankës dhe e bën transferimin e së drejtës së nënshkrimit në llogarinë bankare përkatëse. Prej valës 53 sipas ligjit të ri për shoqëritë tregtare nuk kërkohet pagesa e kapitalit themeltar.

Deri në fund të periudhës raportuese, AKP ka edhe 58 llogari të hapura të Ndërmarrjeve të Reja (Nevvco) të cilat ende priten të transferohen të blerësit pas nënshkrimit të kontratave të shitjes.

Llogaria e likuidimit për para të imta:

Mban mbetjen e parave të imta për qëllime të likuidimit (shërbime postare, fotokopjime etj.) në kohën kur këto shërbime janë paguar përmes bankës Procredit. Gjatë vitit 2014, mbetja në këtë llogari do të transferohet në BKK dhe llogaria do të mbyllet.

Llogaritë në Procredit Bank (PCB) më 30 Shtator 2014:

PËRMBLEDHJE E LLOGARIVE NË PCB	**VLERA**
PAK SOE	294.00
Llogaritë e Ndërmarrjeve të Reja (llogaritë ende pa e transferuar te pronari)	62,254.00
Liquidation	1.70
GJITHSEJ	**62,549.70**

Shiko specifikacionin e llogarive të AKP-së në Procredit Bank të paraqitura në fund të Pasqyrave Financiare.

Llogaritë në Raiffeisen Bank më 30 Shtator 2014:

PËRMBLEDHJE E LLOGARIVE NË Raiffeisen Bank	**VLERA**
Dy llogaritë e Ndërmarrjeve të Reja (llogaritë ende pa e transferuar te pronari)	2,489.00
Depozitimi kohor 12 mujor	25,000,000.00
GJITHSEJ	**25,002,489.00**

Shënimi 6: Pasqyra e faturave (detyrimeve) të papaguara të AKP-së:

Janë paraqitur në Pasqyrën e Detyrimeve e që është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shënimi 7: Detyrimet kontingjente

Detyrimet kontigjente që mund të ndikojnë në fondet në mirëbesim të AKP-së janë shpalosur në tabelën e detyrimeve kontigjente si pjesë e këtyre pasqyrave financiare.

Shënimi 8: Të ardhurat e arkëtueshme:

Janë raportuar si pjesë integrale e pasqyrave financiare.

Shënimi 9: Transakcionet e paekzekutuara nga BQK lidhur me depozitimet kohore:

Gjatë periudhës raportuese, nuk ka transakcione të cilat AKP ka dorëzuar në BQK e të cilat nuk janë ekzekutuar lidhur me depozitimet kohore.

Shënimi 10: Kthimi i mjeteve në Buxhetin e Kosovës për shpenzimet në emër të llogarive të likuidimit:

Faza e likuidimit: Është periudha pas fillimit të procesit të likuidimit të NSH-ve.

Pagesa e shpenzimeve të likuidimit nga Buxheti i Kosovës dhe kthimi përkatës në Buxhetin e Kosovës (nga llogaritë e likuidimit) bëhet duhet u bazuar në procedurën e datës 20 Nëntor 2007 për dhënien avans të fondeve të Buxhetit të Kosovës për NSH-të në likuidim si dhe në rezolutën e Bordit të Drejtorëve të ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të datës 9 Prill 2008 e azhurnuar nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Qershor 2012 për kthimin e këtyre mjeteve në Buxhetin e Kosovës respektivisht në tarifën administrative të Agjencisë pas realizimit të të hyrave nga procesi i privatizimit/likuidimit.

Sipas rezolutës së Bordit të Drejtorëve të datës 21 Qershor 2012 në fjalë, financimi i kostove të likuidimit (nenet 40.1.1.1 dhe 40.1.1.3 të Shtojcës së Ligjit të Agjencisë) bëhet si në vijim:

a) Tarifa fikse e Autoritetit të Likuidimit paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin e caktimit të saktë të kostos fikse proporcionalisht për secilën ndërmarrje shoqërore në likuidim, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompenzohet nga llogaria banker e ndërmarrjes në likuidim;

b) Tarifa variabile (për kërkesat e shqyrtuara) e Autoritetit të Likuidimit dhe kostot tjera të paraqitura në kostot 1.1 dhe 1.3 të nenit 40.1 të shtojcës së ligjit nr. 04/L-034 paguhen nga fondet e ndërmarrjes në likuidim. Në rast se ende nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit, atëherë tarifa variabile paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompenzohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.

Gjatë periudhës raportuese, me rastin e procesit të rishikimit gjysmëvjetor të buxhetit vjetor të Agjencisë për vitin fiskal 2013, Bordi i Drejtorëve ka marrë vendim që buxheti i likuidimit prej €269,360 (nga buxheti vjetor i Agjencisë) i paraparë për shpenzime të likuidimit do të financohen nga fondet në mirëbesim të likuidimit sipas rezolutës së Bordit të Drejtorëve të datës 21 Qershor 2012.

Gjatë vitit fiskal 2014 apo 2015 do të kthehen në Buxhetin e Kosovës ose tarifën administrative respektivisht €24,897.86 varësisht në cilin vit kanë ndodhur shpenzimet (deri në fund të 2012) si dhe € 595,005.27 të cilat do të kthehen nga llogaritë e NSH-ve në likuidim për shpenzimet të cilat gjatë vitit 2013 deri më 30 Shtator 2014 janë ekzekutuar nga tarifa administrative e Agjencisë në përputhje me rezolutën e Bordit të Drejtorëve të Qershorit 2012. Shpenzimet prej €595,005.27 janë paguar nga tarifa administrative për shkak se fatura e furnitorit ka përfshirë më shumë se një NSH dhe rrjedhimisht fatura nuk ka mundur të ndahet.

Buxhet për Fondet në mirëbesim është për ndërmarrjet shoqërore të cilat hyjnë në likuidim. Janë gjithsej 461 Ndërmarrje Shoqërore të cilat kanë hyrë në likuidim. Buxheti përshinë periudhën që nga hyrja e Ndërmarrjes në likuidim e deri në përfundim të saj.

Përgatitja e buxhetit të fondeve në mirëbesim për NSh-të në likuidim është jashtë kompetencave të Departamentit të Financave dhe Buxhetit por që ka filluar të jetë pjesë e procesit të monitorimit dhe kontrollës që nga mbledhja e muajit Gusht 2014 të bordit të drejtorëve, kjo sipas kërkesave të ZDM – Likuidimi në menyrë që të rritet cilësia, plotësia dhe zvoglimi i rrezikut të tejkalimit të buxhetit.

Shënimi 12: Regjistrimi i avanseve të parave të imta nga llogaritë e likuidimit dhe llogaria e tarifës administrative:

Gjatë periudhës raportuese janë dhënë para të imta në formë të avansit për secilën nga zyret rajonale të Agjencisë. Paratë e imta janë paguar nga Llogaria e Tarifës Administrative të AKP-së dhe pëdoren për të mbuluar shpenzimet e imta gjatë procesit të likuidimit deri në shumën prej 200 EUR ashtu sic përcaktohet me udhëzimin për procedurat e prokurimit me fondet e likuidimit. Kur të shpenzohet një avans i parasë së imtë gjatë mbylljes së avansit, atëherë shpenzimet përkatëse u atribuohen llogarive përkatëse të likuidimit dhe në anën tjetër kompenzohet Llogaria e Tarifës Administrative të AKP-së.

Deri në fund të periudhës raportuese janë në avans para të imta shumat për pesë zyret rajonale: ZR Prishtina EUR 3,000; ZR Mitrovica EUR 2,000; ZR Prizren EUR 4,000; ZR Peja EUR 4,000 dhe ZR Gjilan EUR 5,000. Gjithsej shuma e dhënë në avans për të pesë zyret rajonale është: EUR 18,000. Avanset e pranuara gjatë vitit 2014 nga Zyret Regjionale do të mbyllen në fund të vitit 2014 dhe paratë do të kthehen nga llogaritë përkatëse të likuidimit në Llogaria e Tarifës Administrative të AKP-së.

Avansi për udhëtime zyrtare në përfaqësimin e Bankos në likuidim gjithsej EUR 1,600.00

Llogaria e Tarifës Administrative të AKP-së	
	Shuma
Gjendja fillestare 1 Janar 2014 **(**Avanse të hapura të pranuara në Dhjetor 2013 për shërbime postare dhe taksa gjyqësore (avansi mbyllet deri më 31 Janar 2014)	**500.00**
Pranimet e avanseve	18,000+1,600= 19,600.00
Shpenzimet	479.00 + 820 =1,299.00 (Në fund të vitit bëhet mbyllja e këtyre avanseve në vlerën prej 18,000.00)
Kthimet e mjeteve ne llogari	21.00+780=801
Gjendja në fund të periudhës raportuese i avanseve të hapura për likuidim	**18,000.00**

Pagesat ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për likuidimin e NSH-ve:

Që nga Tetor i vitit 2012 kanë filluar pagesat ndaj "Deloitte" e cila e është kontraktuar në Korrik 2012 për të ofruar shërbime profesionale si pjesë e Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Janë dy lloje të pagesave: fikse (kuartale) dhe variabile sipas vendimeve të shqyrtuara të kreditorëve.

2.8.1 Kostoja fikse:

Shuma totale e kostos fikse për pagesë ndaj "Deloitte" deri në përfundim të kontratës është EUR 4.9 milion. Kjo shumë do të paguhet nga secila NSh në likuidim sipas metodës fikse të përshkallëzuar e të aprovuar nga Komiteti Drejtues i Projektit për kontratën me OSHP-në për likuidimin e NSH-ve.

Gjithsej shuma e paguar deri në datën raportuese është EUR 2,947,221.60 dhe atë:

1) gjatë vitit 2012 shumën prej 1,228,009 (982,407.20 pagesë pas dorëzimit të raportit fillestar dhe për kuartalin e parë Shtator – Dhjetor 2012 janë paguar 245,601.80);
2) gjatë vitit 2013 shumën prej 1,228,009 për pesë kuartale (secili nga 245,601.80); dhe
3) gjatë vitit 2014 shumën prej 491,203.60 për dy kuartale (secila nga 245,601.80)

Fillmisht kostoja fikse paguhet nga llogaria e tarifës administrative së Agjencisë dhe më pastaj mjetet i kthehen tarifës administrative nga secila llogari e NSh-së në likuidim pas përcaktimit të numrit të kërkesave të kreditorëve dhe shumës së shitjeve për secilën ndërmarrje. Për të gjitha pagesat e realizuara nga llogaria e tarifës administrative, mjetet e kthyera në tarifën administrative nga llogaritë e NSh-ve në likuidim janë gjithsej EUR 285,250.

2.8.2 Kostoja variabile

Nga Marsi i vitit 2013, ofruesi i shërbimeve profesionale "Deloitte" e kontraktuar nga Agjencia ka shqyrtuar vlefshmërinë e kërkesave të kreditorëve dhe për të cilat deri në datën raportuese më 30 Shtator 2014 ka faturuar për 65,156 vendime (pranim/refuzim të kërkesave të kreditorëve) për të gjtha llojet e kërkesave të kreditorëve (sipas ligjit të AKP-së me nr. 04/L-034, neni 40). Shuma e paguar për shqyrtimin e këtyre kërkesave është gjithsej EUR 5,430,121.46 dhe atë:

1) Neni 40.1.5, kërkesa për pronësi të aseteve shumën prej EUR 131,799për 551 vendime të marrra;
2) Neni 40.1.6.1 kërkesa për paga të pa paguara shumën prej EUR 3,336,458për 42,133 vendime të marra;
3) Neni 40.1.6.2 kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës shumën prej EUR 1,210,651për 15,286 vendime të marra;
4) Neni 40.1.7 kërkesa të pasiguruara shumën prej EUR 478,764 për 6,047 vendime të marra; dhe
5) Neni 40.1.8 kërkesa e pronarëve apo aksionarëve shumën prej EUR 272,449 për 1,139 vendime të marra.

Për periudhën raportuese Janar - Shtator janë paguar gjithsej EUR 2,649,004 dhe atë:

1) Neni 40.1.5, kërkesa për pronësi të aseteve shumën prej EUR 78,696.80 për 329 vendime të marrra;

2) Neni 40.1.6.1 kërkesa për paga të pa paguara shumën prej EUR 1,682,920.80 për 21,255 vendime të marra;

3) Neni 40.1.6.2 kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës shumën prej EUR 455,004 për 5,745 vendime të marra;

4) Neni 40.1.7 kërkesa të pasiguruara shumën prej EUR 226,670.40 për 2,864 vendime të marra; dhe

5) Neni 40.1.8 kërkesa e pronarëve apo aksionarëve shumën prej EUR 205,712 për 860 vendime të marra.

Vlerat e shënuara më sipër paraqesin vlerat e 80% e faturuar dhe paguar të shumave për vendimet sipas kontratës.

Sipas kontratës, së pari faturohet dhe paguhet vetëm 80% e shumës së kontraktuar dhe pjesa prej 20% paguhet pasi që të ketë kaluar afati kohor për ankesë në Dhomës e Posaçme të Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës. Për ato ankesa të cilat janë dorëzuar kërkesa brenda afatit kohor, 20% paguhet pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesës nga DhPGjSK.

Shënimi 13: Sqarimet në shënimet shpjeguese lidhur me tabelat e pasqyrave financiare:

SQARIME NË SHËNIMET SHPJEGUESE LIDHUR ME TABELAT E PASQYRAVE FINANCIARE

Tabela nr.	Përshkrimi i raportit	Faqe
	Deklarata për Prezentimin e Pasqyrave Financiare Paraqet deklaratën e zyrtarëve të autorizuar të Agjenciare për nënshkrimin e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim. Kjo deklaratë është e bazuar në "Rregulloren e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në mirëbesim. Deklarata është e ngjashme me deklaratën që dorëzohet për pasqyrat financiare të buxhetit vjetor të Agjencisë dhe i përmbushë standardet e përcaktuara nga Ministria e Financave për deklaratën për prezentimin e pasqyrave financiare.	
	Raporti i aktiviteteve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit Paraqet raportin e punës së të gjitha njësive organizative të Agjencisë gjatë periudhës raportuese dhe është raport informues për punën e Agjencisë për vitin përkatës.	1-63
Tabela 1.	**Pasqyra e gjendjes së llogarive bankare në BQK sipas llojit të fondeve në mirëbesim:** Paraqet:	1

Tabela nr.	Përshkrimi i raportit	Faqe
	a) gjendjen e llogarive bankare të fondeve në mirëbesim për llogaritë rrjedhëse dhe për depozitat kohore për periudhën raportuese; b) gjendjen e llogarive të fondeve në mirëbesim prej vitit 2008 e deri në vitin e parafundit raportues.	
Tabela 2.	**Pasqyra përmbledhëse e rrjedhës së parasë për transaksionet me palët e treta dhe transaksionet e brendshme për periudhën 2003- Shtator 2014:** Paraqet: a) Pasqyrën përmbledhëse të rrjedhës së parasë për transaksionet me palët e treta (shitjet, depozitat e ofertuesve, qiratë e inkasuara etj); dhe b) Pasqyrën përmbledhëse të rrjedhës së parasë për transaksionet e brendshme (transferet nga një llogari në mirëbesim në llogaritë tjera në mirëbesim, për shembull transferet e 75% të shitjes nga llogaritë e privatizimit në llogaritë e likuidimit; transferet e një pjese të parave për 20%-in e punëtorëve që mbahen në mirëbesim derisa të shqyrtohen ankesat nga Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme; etj).	2
Tabela 3.	**Detajet e Pasqyrës së Rrjedhës së Parasë së Gatshme për periudhën Korrik 2003 – Shtator 2014 për transaksionet me palët e treta** Paraqet detajet e rrjedhës së parasë sipas kodeve të planit kontabël për secilën kategori të llogarive në mirëbesim.	3-8
Tabela 4.	**Pasqyra përmbledhëse e rrjedhës së parasë për transaksionet me palët e treta dhe transaksionet e brendshme për periudhën Janar – Shtator 2014** Paraqet: a) Pasqyrën përmbledhëse të rrjedhës së parasë për transaksionet me palët e treta (shitjet, depozitat e ofertuesve, qiratë e inkasuara etj); dhe b) Pasqyrën përmbledhëse të rrjedhës së parasë për transaksionet e brendshme (transferet nga një llogari në mirëbesim në llogaritë tjera në mirëbesim, për shembull transferet e 75% të shitjes nga llogaritë e privatizimit në llogaritë e likuidimit; transferet e një pjese të parave për 20%-in e punëtorëve që mbahen në mirëbesim derisa të shqyrtohen ankesat nga Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme; etj).	9
Tabela 5.	**Detajet e Pasqyrës së Rrjedhës së Parasë së Gatshme për periudhën Janar – Shtator 2014 për transaksionet me palët e treta** Paraqet detajet e rrjedhës së parasë sipas kodeve të planit kontabël për secilën kategori të llogarive në mirëbesim.	10-12
Tabela 6.	**Përmbledhje e hyrjeve dhe daljeve nga privatizimi (shitja e Ndërmarrjeve të Reja):** Paraqet: a) raportin e hyrjeve në llogaritë e privatizimit; b) raportin se si duhet të ndahen paratë nga privatizimi i ndërmarrjeve të reja: 75% për fondet e likuidimit, 20% për punëtorët dhe 5% për tarifën	13

Tabela nr.	Përshkrimi i raportit	Faqe
	administrative të Agjencisë; c) daljet aktuale nga llogaritë e privatizimit d) shumat aktuale në depozitime kohore; e) gjendjen aktuale të llogarive të privatizimit f) përmbledhjen e të ardhurave të privatizimit për nga kontratat e nënshkruara dhe shumat për të cilat ende kontratat nuk janë të nënshkruara. g) Shumat e kthyera në Ministrinë e Financave për pagesën e gjysmës së kapitalit themeltar të Ndërmarrjeve të Reja të themeluara e të shitura nga Agjencia.	
Tabela 7.	**Raporti i shitjeve sipas regjioneve:** Paraqet raportin e të ardhurave nga shitjet e Ndërmarrjeve të Reja dhe shitjete e aseteve në likuidim për secilin rajon të Kosovës (Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë).	14
Tabela 8.	**Përmbledhje dhe detajet e hyrjeve dhe daljeve në likuidim (sipas regjioneve)** Paraqet përmbledhjet dhe detajet e hyrjeve dhe daljeve për llogaritë e likuidimit. Paraqiten këto nëntabela: a) Raporti i të ardhurave; b) Raporti i pagesave dhe shpërndarjeve sipas llojit të shpenzimeve; c) Raporti i pagesave dhe shpërndarjeve sipas llojit të kreditorëve; d) Analizat e hollësishme për të ardhurat e likuidimit (të gjitha kodet); e) Analizat e hollësishme për shpenzimet dhe shpërndarjet e likuidimit (të gjitha kodet); f) Raporti i depozitimeve kohore nga llogaritë e likuidimit.	15-18
Tabela 9.	**Përmbledhje e pagesave për 20%-in e punëtorëve të Ndërmarrjeve Shoqërore:** Paraqet: a) raportin e pagesave të 20%-it për punëtorët e NSH-ve sipas llojit të të ardhurave (privatizimit, likuidimit, fondeve tjera në mirëbesim të NSH-ve; b) shumat të cilat mbahen në mirëbesim për punëtorët deri në shqyrtimin e ankesave nga Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme të Kosovës.	19
Tabela 10.	**Raporti i interesit të fituar në llogaritë bankare dhe numri i llogarive bankare:** Paraqet: a) interesin e gjeneruar për llojet e ndryshme të llogarive; dh b) numrin e llogarive të hapura, të mbyllura dhe aktive.	20
Tabela 11.	**Numri i transaksioneve për vitet e ndryshme fiskale** Paraqet numrin e transaksioneve për vitet 2003 e deri në periudhën e fundit raportuese.	21-22
Tabela 12.	**Pasqyra financiare e llogarive të privatizimit:** *Tabelat 13 deri 27 paraqesin informatat për detajet sipas planit kontabël, por për kategori të ndryshme të fondeve në mirëbesim.*	23

Tabela nr.	Përshkrimi i raportit	Faqe
	Tabelat e pasqyrave financiare të llojeve të ndryshme të fondeve në mirëbesim paraqesin: a) Gjendjen akumuluese të hyrjeve dhe daljeve për 3 vitet e fundit; b) Gjendjen e hyrjeve dhe daljeve brenda 2 viteve përkatëse të fundit. c) Gjendjen e depozitave kohore; d) Gjendjen në llogaritë bankare për vitet përkatëse.	
Tabela 13.	Pasqyra financiare e llogarive të likuidimit	25
Tabela 14.	Pasqyra financiare e llogarive të parave në mirëbesim të NSH-ve	28
Tabela 15.	Pasqyra financiare e llogarive të komercializimit	30
Tabela 16.	Pasqyra financiare e llogarive të parave në mirëbesim për 20%-in e punëtorëve	31
Tabela 17.	Pasqyra financiare e llogarisë së depozitave (ofertuesit) të privatizimit	32
Tabela 18.	Pasqyra financiare e llogarisë së tarifave (ofertuesit) të privatizimit	34
Tabela 19.	Pasqyra financiare e llogarisë së depozitave (ofertuesit) të likuidimit	36
Tabela 20.	Pasqyra financiare e llogarisë së tarifave (ofertuesit) të likuidimit	38
Tabela 21.	Pasqyra financiare e llogarisë së ankesave në likuidim	40
Tabela 22.	Pasqyra financiare e llogarisë së Kapitalit Themeltar të Agjencisë	41
Tabela 23.	Pasqyra financiare e llogarisë së Fondit Rezervë të Agjencisë	42
Tabela 24.	Pasqyra financiare e llogarisë së donatorit	44
Tabela 25.	Pasqyra financiare e llogarisë së tarifës administrative të Agjencisë	45
Tabela 26.	Pasqyra financiare e llogarive të depozitimeve kohore	46
Tabela 27.	**Raporti i detyrimeve** Paraqet informata për detyrimet e njohura të Agjencisë që pritet të paguhen nga fondet në mirëbesim. Informatat që paraqiten janë: ndërmarrja, data e faturës, numri i faturës, qëllimi i faturës, shuma e detyrimit, arsyeja e mospagesës dhe muaji se kur pritet të bëhen pagesat.	47-67
Tabela 28.	**Raporti i detyrimeve kontigjente** Paraqet informata për detyrimet kontigjente të njohura të Agjencisë, për të cilat mundësia e pagesës është e pritshme nga fondet në mirëbesim, varëisht nga faktorët e jashtëm që mund të kenë ndikim (për shembull rastet gjyqësore). Informatat që paraqiten janë: ndërmarrja, natyra e detyrimeve kontigjente, shuma e detyrimit, arsyeja për detyrime, vlera potenciale në 3 vitet e fundit dhe kategoria e mundësisë së ndodhjes së pagesës.	68

Tabela nr.	Përshkrimi i raportit	Faqe
Tabela 29.	**Raporti – Përmbledhja e llogarive të arkëtueshme** Paraqet përmbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe atë sipas: a) Raporti sipas aktivitetit; dhe b) Raporti sipas njësisë organizative të Agjencisë.	69

Shënimi 14: Tabela e përmbajtjes së raporteve me detajet e pasqyrave financiare:

